

---

**POLITIKA SHETËRORE  
PËR DIASPORËN  
2019**

---







**POLITIKA SHETËRORE  
PËR DIASPORËN**





## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b>	4
<b>STRUKTURA SHETËRORE</b>	5
<b>NËNKOMISIONI PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN</b>	10
V.K.M Nr. 98/2017 "" Për ngritjen e nënkomisionit "Për diasporën dhe migracionin", në përbërje të komisionit të përhershëm parlamentar për politikën e jashtme ""	11
<b>KOMITETI SHETËROR PËR DIASPORËN</b>	12
<b>STRUKTURA E KOMITETIT</b>	
V.K.M Nr. 690, datë 22.11.2017 "Për përbërjen dhe detyrat e sekretariatit teknik të komitetit shtetëror për diasporën"	13
URDHËR Nr. 231, datë 07.12.2017 "Për përbërjen dhe detyrat e sekretariatit teknik të komitetit shtetëror për diasporën"	15
URDHËR Nr. 45, datë 12.2.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Informimin e Diasporës"	17
URDHËR Nr. 43, datë 12.2.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Sigurimeve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vendit"	18
URDHËR Nr.44, datë 12.02.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare"	19
URDHËR Nr.47, datë 18.2.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Programet/Donatorët të Cilët Ofrojnë Bursa Studimi për Jashtë Vendit"	20
URDHËR Nr.78, datë 17.4.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Njohjes së Lejeve të Drejtimit të Automjeteve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vendit"	21
URDHËR Nr. 92, datë 17. 05. 2019 "Për Ngritjen e Grupit të Punës dhe Caktimin e Personit Përgjegjës për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve që Vuajnë Heqjen e Lirisë Jashtë Vendit, të Drejtave të Migrantëve Nëpërmjet Informimit mbi Mundësitë e Ndryshme për të Apeluar Ndaj Shkeljeve të të Drejtave të Tyre, në Strukturat e Vendeve Pritëse si dhenë ato Ndërkombëtare"	22
URDHËR Nr.112, datë 30.8.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Realizimin e Programit "JAM SHQIPTAR" të Gjuhës dhe Kulturës Shqipe"	24
<b>MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN</b>	25
V.K.M Nr. 510, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjës së shtetërore të Ministrit të Shtetit për Diasporën"	26
URDHËR Nr.124, datë 18.9.2019 "Për ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"	28



<b>LIGJ Nr. 16/2018</b>	<b>31</b>
<b>PËR DIASPORËN</b>	
V.K.M Nr. 339, datë 06. 06. 2018 <i>"Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit Ambasador i Kombit"</i>	43
V.K.M Nr. 340, datë 06.06.2018 <i>"Për përcaktimin e rregullave të hollësishtme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës"</i>	45
V.K.M Nr. 469, datë 26.07.2018 <i>"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën"</i>	48
V.K.M Nr. 470, datë 26.07.2018 <i>"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporën"</i>	52
V.K.M Nr. 690, datë 14.11.2018 <i>"Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën"</i>	55
URDHËR IPËRBASHKËT Nr. 682, datë 15.10.2018 <i>"Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve nënligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës dhe të certifikatës së nxënësve në diasporë"</i>	57
V.K.M Nr. 11, datë 9.1.2019 <i>"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare"</i>	58
URDHËR Nr. 50, datë 27.2.2019 <i>"Për dhënien e çmimit "Ambasador i Kombit"</i>	59
V.K.M Nr. 104, datë 28.02.2019 <i>"Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë"</i>	60
V.K.M Nr. 443, datë 26.06.2019 <i>"Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë"</i>	62
V.K.M Nr. 24, datë 16.1.2019 <i>"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit"</i>	65
URDHËR Nr. 76, datë 15. 04. 2019 <i>"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën"</i>	69
V.K.M Nr. 492, datë 10.7.2019 <i>"Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020"</i>	70
V.K.M Nr. 723, datë 11.11.2019 <i>"Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 492, datë 10.07.2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020"</i>	73
V.K.M Nr. 195, datë 05.04.2019 <i>"Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës"</i>	77
V.K.M Nr. 320, datë 15.05.2019 <i>"Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës"</i>	79
VENDIM Nr. 67, dt. 13.2.2019, <i>"Për miratimin e rregullave dhe procedurave të hollësishtme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"</i>	81
URDHËR Nr. 96, datë 16.7.2018, <i>"Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Samitit të Diasporës"</i>	84



<b>LIGJ Nr. 115/2017</b>	
<b>PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS</b>	<b>86</b>
V.K.M Nr. 114, datë 23.02.2018 <i>"Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës"</i>	<b>94</b>
URDHËR Nr. 1, datë 25.9.2018 <i>"Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës"</i>	<b>96</b>
URDHËR Nr. 53, datë 16.03.2018 <i>"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë kombëtare të diasporës"</i> .	<b>97</b>
<b>LIGJ Nr. 32/2018</b>	<b>98</b>
<b>PËR FONDIN SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS</b>	
V.K.M Nr. 594, datë 09.10.2018 <i>"Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"</i>	<b>107</b>
V.K.M Nr. 611, datë 17.10.2018 <i>"Për financimin e projektit "diaspora për zhvillim" dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"</i>	<b>108</b>
V.K.M Nr. 67 datë 13.2.2019 <i>"Për miratimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"</i> .	<b>110</b>
V.K.M Nr. 321, datë 15.05.2019 <i>"Për financimin e projektit "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritit evropian të Shqipërisë" dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"</i> .	<b>113</b>
V.K.M Nr. 514, datë 19.7.2019 <i>"Për financimin e projektit "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës në Shqipëri", dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"</i> .	<b>115</b>
V.K.M Nr. 746, datë 20.11.2019 <i>"Për disa ndryshime në Vendimin Nr.294, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave," Për krijimin e Këshillit të Investimeve", të ndryshuar"</i> .	<b>117</b>
<b>V.K.M Nr. 259 datë 09.05.2018</b>	<b>118</b>
<b>PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018-2024 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT</b>	
URDHËR Nr. 96, datë 16.07.2018 <i>"Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Samitit të Diasporës "</i>	<b>120</b>
URDHËR Nr. 98, datë 16.07.2018 <i>"Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën 2018-2024"</i>	<b>122</b>
URDHËR Nr. 135, datë 13.09.2018 <i>"Për ngritjen e grupit ndërinstitucion al të punës për zbatimin e masës 64 të planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën"</i>	<b>124</b>
URDHËR Nr. 136, datë 13.09.2018 <i>"Për ngritjen e grupit ndërinstitucion al të punës për zbatimin e masës 51 të planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën"</i>	<b>126</b>



URDHËR Nr. 137, datë 13.09.2018 "Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën 2018-2024"	128
URDHËR Nr. 138, datë 13.09.2018 "Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën 2018-2024"	130
V.K.M Nr.601, datë 4.9.2019 "Për Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët"	132
<b>LIGJ Nr. 38/2019</b>	<b>136</b>
<b>PËR DISASHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE</b>	
<b>V.K.M Nr. 400, datë 19.6.2019</b>	<b>138</b>
<b>PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2019-2022.</b>	
<b>REZOLUTË datë 23.07.2018</b>	<b>139</b>
<b>PËR REFORMËN E POLITIKËS SHTETËRORE PËR DIASPORËN</b>	
<b>MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME</b>	<b>144</b>
Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e diasporës.	145
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për qendrat kulturore në diasporë.	149
Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës.	153
Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës në Shqipëri dhe Universitë Degli Studi E-campus në Itali për bashkëpunimin në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit.	156
Memorandum mirëkuptimi midis Ministrisë së Shtetit për Diasporën të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar.	164
Memorandum mirëkuptimi mes Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën.	167
Memorandum mirëkuptimi midis Ministrit të Shtetit për Diasporën të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Germin, për bashkëpunimin në fushën e diasporës.	171





Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Institutit Kulinar “Neraxhi” për promovimin e kulinarisë shqiptare në diasporë.	174
Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe “OC International” sh.p.k për promovimin e kulturës dhe identitetit kombëtar.	176
Memorandum bashkëpunimi për programin “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë të Shtetit për Diasporën.	179
Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Universiteti i Tiranës për bashkëpunimin në ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar në Diasporë.	186
Marrëveshje bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambliit Popullor të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në Diasporë.	191
Marrëveshje ndërmjet Fondacioni “Magna Grecia” dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.	195
Marrëveshje bashkëpunimi midis Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit Universitar për Biznes dhe Teknologji, Kosovë.	202
Marrëveshje ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Institutit “Alb-Shkenca” për bashkëpunimin në fushën e kërkim-zhvillimit dhe të bashkëveprimimit me Diasporën shkencore shqiptare.	209
Memorandum bashkëpunimi midis Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe Fondacioni për Politikën Diplomatike dhe Kërkimin Shkencor (DRPF), Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) për pjesëmarrjen e tyre në kërkimin shkencor arsimor & zhvillimin, advokimin, trajnimin në kuadrin e universitetit mandate.	213

**STRATEGJIA KOMBËTARE E DIASPORËS 2018 – 2024 DHE PLANI I VEPRIMIT** 218

Kushtet Aktuale
Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjik
Objektivat Specifik dhe Masat
Kostimi dhe Buxhetimi
Monitorimi dhe Zbatimi
Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Diasporës
Grupi i Punës



## HYRJE

Historia e Shqipërisë ka filluar të dëgjojë një “variant” tjetër të saj, e cila është ajo e diasporës shqiptare.

Botimi “Politika Shtetërore për Diasporën 2019” është botim vjetor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Ai vlerëson ecurinë gjatë vitit 2019 të politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për diasporën shqiptare. Ky botim është pasardhës i botimit “Politika Shtetërore për Diasporën 2018”

Materialet e përfshira në këtë botim shërbejnë për informimin e publikut brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e veprimtarisë së strukturave shtetërore, politikat dhe legjislacionin e ri për Diasporën shqiptare.

Politika shtetërore për diasporën mbështetet nga një kornizë e re ligjore e cila është në zhvillim. Ajo mbështetet nga dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.259, Datë 09.05.2018.

Organizimi i Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare ishte një ngjarje e rëndësishme për vitin 2019. Ai shërbeu si një vlerësim për dokumentet e politikës shtetërore të miratuara për interesat e diasporës.

Në funksion të politikës shtetërore për diasporën gjatë vitit 2019 ka vazhduar implementimi praktik me krijimin e agjencive përgjegjëse si Qendra e Botimeve për Diasporën, Dhoma e Biznesit të Diasporës, Këshilli Koordinues i Diasporës, të cilat zhvillojnë punën e tyre krahas Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.


Në 1 janar 2020 do të fillojë nga funksionimi edhe Qendra e Botimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Fokusi i politikave shtetërore për diasporën është mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendlindjes në shtetet pritëse dhe angazhimi i diasporës në Shqipëri. Ai synon të realizojë forcimin e rolit të diasporës shqiptare në jetën sociale dhe politike me rritjen e kontributit dhe ndikimit të saj në zhvillimin e vendit.

Diaspora shqiptare, si çdo e vërtetë, është bijë e kohës dhe progresit. Ky botim është një provë e saj që ka ndodhur dhe po vjen.



## STRUKTURA SHETËRORE





**NËNKOMISIONI  
PËR DIASPORËN  
DHE MIGRACIONIN**



**VENDIM**  
**Nr. 98/2017**

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT**  
**“PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË**  
**PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR POLITIKËN E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I.** Ngrihet nënkomisioni “Për diasporën dhe migracionin”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme.
- II.** Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë çështje të diasporës dhe fenomenit migrator të Shqipërisë.
- III.** Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:
  1. Adnor Shameti, kryetar (PS);
  2. Tritan Shehu, zëvendëskryetar (PD);
  3. Elona Hoxha, anëtare (PS);
  4. Eglantina Gjermeni, anëtare (PS);
  5. Klajda Gjoshja, anëtare (LSI).
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 5.10.2017



**KOMITETI SHTETËROR  
PËR DIASPORËN**



**VENDIM**  
**Nr. 690, datë 22.11.2017**

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR  
DIASPORËN**

Nëmbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, këtu e në vijim “Komiteti”, si organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës.
2. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij këta anëtarë:
  - a) Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - b) Ministrin e Brendshëm;
  - c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
  - ç) Ministrin e Drejtësisë;
  - d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - dh) Ministrin e Kulturës;
  - e) Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit;
  - ë) Ministrin e Shtetit për Diasporën;
  - f) Guvernerin e Bankës së Shqipërisë;
  - g) Kryetarin e Akademisë së Shkencave;
  - gj) Drejtorin e INSTAT-it.
3. Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:
  - a) Përgatitjen e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në fushën e diasporës;
  - b) Propozimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për çështje që lidhen me përmirësimin e pozitës së anëtarëve të diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku jetojnë;
  - c) Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjisla cionit në fushën e zhvillimit të komuniteteve të diasporës;
  - ç) Koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
  - d) Mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën.



4. Komiteti mbledhet jomë pak se një herë në tre muaj dhe sa herë është e nevojshme, me kërkesë të Kryeministrit.
5. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të grupeve parlamentare, të organeve të qeverisjes qendrore e vendore apo të institucioneve të tjera, pjesëmarrja e të cilëve çmohet e vlefshme për përmbushjen e misionit.
6. Veprimtaria e Komitetit mbështetet nga sekretariati teknik. Përbërja dhe detyrat e sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.
7. Urdhri nr. 115, datë 11.5.2006, i Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërminstor të Migracionit”, shfuqizohet.
8. Ngarkohen anëtarët e Komitetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**

**MINISTRI I SHTETIT**  
**PËR DIASPORËN**  
**PANDELI MAJKO**





**URDHËR**

**Nr. 231, datë 7.12.2017**

**PËR PËRBËRJEN DHE DETYRAT E SEKRETARIATIT TEKNIK TË KOMITETIT  
SHTETËROR PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 6, të vendimit nr. 690, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën",

URDHËROJ:

1. Sekretariati Teknik i Komitetit Shtetëror për Diasporën të kryesohet nga përfaqësuesi iministrit të Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të ketë anëtarë, përfaqësues nga:
  - Ministri i Shtetit për Diasporën;
  - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - Ministria e Brendshme;
  - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
  - Ministria e Drejtësisë;
  - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - Ministria e Kulturës.
2. Detyrat kryesore të Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën janë, si më poshtë vijon:
  - Të përgatitë takimet e Komitetit;
  - Të raportojë periodikisht pranë Komitetit për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme të tij;
  - Të bashkërendojë punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna nga Komiteti;
  - Të mbajë procesverbalet dhe të hartojë vendimet e marra nga Komiteti;
  - Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga kryetari i Komitetit.
3. Sekretariati Teknik të mbledhet rregullisht, me njoftimin e kryetarit.
4. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij urdhri, që brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të tij, t'i dërgojnë ministrit të Shtetit për Diasporën emrat e përfaqësuesve të tyre në sekretariat.



5. Ngarkohen anëtarët e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**  
**Nr.45, datë 12.2.2019**

**PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR INFORMIMIN  
E DIASPORËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e drejtorit të Programimit dhe Zhvillimit, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), z. Fatjon Hallkaj, koordinator shtetëror për informimin e diasporës shqiptare.
2. Koordinatori shtetëror vepron në zbatim të masës 51, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendim nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave. Ai vlerëson dhe koordinon punën për informacionin që publikohet nga institucionet e administratës shtetërore për interesat e komunitetit shqiptar jashtë vendit.
3. Për këtë proces koordinatori shtetëror të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr.43, datë 12.2.2019**

**PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR MARRËVESHJET  
SHTETËRORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE PËR SHTETASIT SHQIPTARË  
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Etjen Xhafaj, si koordinatör shtetëror për ndjekjen e procesit të inicimit, negocimit dhe finalizimit të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, në zbatim të masës 23, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme autorizohet të zhvillojë bisedimet për iniciimin dhe negocimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.
3. Për këtë proces koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin ekëtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr.44, datë 12.02.2019**

**PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN  
E PROGRAMIT VJETOR TË AKTIVITETEVE PËR  
DIASPORËN SHQIPTARE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e zëvendësministrit të Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi, si koordinator shtetëror për ndjekjen dhe organizimin e programit vjetor të aktiviteteve shtetërore në interes të diasporës shqiptare dhe “Ditët e Shqipërisë”, për zbatimin e masës 45, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjës dhe autorizohet të koordinojë e organizojë aktivitete në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar.
3. Për këtë proces koordinatorishtetëror të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr.47, datë 18.2.2019**

**PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHETËTOR PËR PROGRAMET/  
DONATORËT TË CILËT OFROJNË BURSA STUDIMI PËR JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e zëvendësministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino, si koordinator shtetëror për ndjekjen e programeve dhe donatorëve të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, në zbatim të masës 64, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë është përgjegjës dhe autorizohet të koordinojë punën ndërinstitucionale për ndjekjen dhe realizimin e masës 64, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
3. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**  
**Nr.78, datë 17.4.2019**

**PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR MARRËVESHJE  
SHTETËRORE NË FUSHËN E NJOHJES SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË  
AUTOMJETEVE PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 28, të Ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit nr. 510, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Diasporën” dhe të vendimit nr.504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli si koordinator shtetëror për ndjekjen e procesit të negocimit të marrëveshjeve dypalëshe shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.
2. Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjës për koordinimin ndërinstitucional për negociimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.
3. Për këtë proces raportohet me shkrim çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 92 , datë 17. 05. 2019**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS DHE CAKTIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËS  
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE QË VUAJNË HEQJEN  
E LIRISË JASHTË VENDIT , TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NËPËRMJET  
INFORMIMIT MBI MUNDËSITË E NDRYSHME PËR TË APELUAR NDAJ  
SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË TYRE, NË STRUKTURAT E VENDEVE PRITËSE  
SI DHE NË ATO NDËRKOMBËTARE**

Nëmbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për zbatimin e masës 24, dhe 44 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi i punës do të kryesohet nga zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka si person përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve, nëpërmjet informimit mbi mundësitë endryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare dhe në përbërje të ketë:
  - a) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
  - b) një përfaqësues të caktuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - c) një përfaqësues të caktuar nga ministri i Shtetit për Diasporën;
3. Grupi i punës është përgjegjës në koordinimin e punëve ndërinstitucionale për mbledhjen e informacionit të plotë, për ndjekjen dhe trajtimin sipas legjislacionit në vendet pritëse, të shtetasve shqiptarë të cilët vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit.
4. Zëvendësministri i Drejtësisë, me qëllim përmbushjen e kësaj detyre bashkëpunon me ministrin e përgjegjës për politikën e jashtme, Avokatin e Popullit apo organizma të shoqërisë civile, me qëllim informimin mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve





pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.

5. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, grupi i punës raporton, me shkrim çdo 3 muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
6. Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij urdhri caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin e punës brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
7. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr.112, datë 30.8.2019**

**PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR REALIZIMIN  
E PROGRAMIT “JAM SHQIPTAR” TË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin zëvendësministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lorena Haxhiu, si Koordinator Shtetëror për ndjekjen, organizimin dhe raportimin e punës për realizimin e Programit “Jam Shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe në bazë të memorandumit të nënshkruar për këtë qëllim ndërmjet institucioneve përgjegjëse në zbatimin e masës 28, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin Nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë autorizohet të koordinojë punën ndërinstitucionale për ndjekjen dhe realizimin e Programit “Jam Shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN**



**VENDIM**

**Nr. 510, datë 13.9.2017**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN**

Nëmbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Misioni i ministrit të Shtetit për Diasporën është të përfaqësojë e nxisë politikat e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.
3. Ministri i Shtetit për Diasporën e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:
  - a) Organizimin, hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore për shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë dhe në shtetet ku ata banojnë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - b) Nxitjen dhe ndihmën për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës dhe shqiptarëve jashtë kufijve me përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet ku ata banojnë;
  - c) Promovimin dhe ndihmën në rritjen e zhvillimin e vlerave e të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë;
  - d) Bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare për shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shqiptarëve jashtë kufijve shtetërorë;
  - e) Ndihmën në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, si dhe ndërmarrjen e iniciativave të promovimit të gjuhës, kulturës, traditave dhe çdo vlerë kombëtare, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Kulturës;
  - dh) Koordinimin e procesit për të garantuar regjistrimin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së diasporës në votime, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë;



- f) Organizimin dhe drejtimin e krijimit të Agjencisë Shtetërore të Diasporës;
  - ë) Koordinimin e organizimit të Samitit Kombëtar të Diasporës, si dhe të konferencave të tjera kombëtare e ndërkombëtare për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet diasporës dhe Shqipërisë;
  - g) Bashkëpunimin me ministritë përgjegjëse për të inkurajuar investimet e huaja në Shqipëri.
4. Ministri i Shtetit për Diasporën përfaqëson dhe mbrohet interesat e shtetit brenda fushave të përgjegjësisë, sipas pikës 3, të këtij vendimi.
5. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**  
**Nr.124, datë 18.09.2019**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN  
E PAKETËS LIGJORE PËR GARANTIMIN E TË DREJTËS SË VOTËS PËR  
SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të shkronjës “f”, të pikës 3, të vendimit nr.510, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij të ketë anëtarë, përfaqësues nga institucionet, simë poshtë vijon:
  - a) Ministria e Brendshme;
  - b) Ministria e Drejtësisë;
  - c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
  - d) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - e) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; dh) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
  - f) Instituti i Statistikave.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të bashkëpunojë me Komisionin e Reformës Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë. Ai koordinon punën me Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe u përgjigjet në emër të Kryeministrit kërkesave të punës bashkëpunuese, të cilat lidhen me realizimin e qëllimit të këtij urdhri.
4. Metodologjia e hartimit të paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bazohet



në rekomandimet e Bashkimit Evropian për këtë qëllim, si dhe në praktikat dhe modelet më të mira të vendeve anëtare të tij.

5. Në hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, grupi ndërinstitucional i punës mund të kryejë konsultime e të marrë mbështetje nga përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.
6. Paketa me ndryshime ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të hartohet e të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda muajit dhjetor 2019.
7. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre pranë ministrit të Shtetit për Diasporën.
8. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës.
9. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe të gjitha institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**LIGJ Nr. 16/2018  
PËR DIASPORËN**





**LIGJ**  
**Nr. 16/2018**

**PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti**

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave, për:

- a) Kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
- b) Mënyrën e mbajtjes, të forcimit dhe realizimit të lidhjeve të diasporës me vendin e originës;
- c) Krijimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;
- ç) Dhënien e çmimeve kombëtare në fushën e marrëdhënieve ndërmjet vendit të originës dhe diasporës;
- d) Ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet shtetërore në vendin e originës.

Neni 2

**Përkuftizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Kombëtare e Diasporës”, në vijim “Agjencia”, është organi shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën.
2. “Diaspora” përfshin:



- a) Komunitetet e hershme shqiptare në botë;
  - b) Çdo person, icili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj;
  - c) Çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë.
3. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë shtetërore për marrëdhëniet me diasporën.
  4. “Vend i origjinës” është Republika e Shqipërisë.
  5. “QKD” është qendër kulturore për diasporën, themeluar në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Shqipërisë.
  6. “Këshilli Koordinues i Diasporës” (“Këshilli”) është organi përfaqësues dhe koordinues i marrëdhënieve me diasporën.
  7. “Organizata e diasporës” është organizim vullnetar ipjesëtarëve të diasporës.

## KREU II

### ORGANET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE PËR MARRËDHËNIET ME DIASPORËN

#### Neni 3

#### **Organet shtetërore përgjegjëse për diasporën**

Organet shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën, janë:

1. Këshilli i Ministrave;
2. Komiteti Shtetëror për Diasporën;
3. Ministri përgjegjës për diasporën;
4. Këshilli Koordinativ për Diasporën;
5. Agjencia Kombëtare e Diasporës;
6. Qendrat kulturore për diasporën;
7. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës;
8. Qendra e Botimeve për Diasporën;
9. Autoritete të tjera shtetërore, në përputhje me fushën e tyre të veprimtarisë.

#### Neni 4

#### **Këshilli i Ministrave**

Këshilli i Ministrave përcakton:

- a) Politikat e vendit të origjinës për diasporën, për t'u zbatuar nga organet shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;



- b) Mënyrën dhe politikat për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 5

### **Ministri përgjegjës për diasporën**

Ministri përgjegjës për diasporën ushtron këto kompetenca:

- a) I propozon Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve rregulluese dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme për realizimin e politikës shtetërore për marrëdhëniet me diasporën;
- b) Mbikëqyr dhe koordinon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Marrëdhëniet me Diasporën;
- c) Mban dhe monitoron marrëdhëniet me diasporën;
- d) Krijon dhe përditëson në mënyrë sistematike të dhëna për organizimin e saj në forume;
- e) Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse, sipas fushave të veprimtarisë, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në vendet ku jeton diaspora;
- f) I propozon Kryeministrit dhënien e çmimeve për kontribute të veçanta në ruajtjen e forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, si dhe për kontribute të veçanta në promovimin e Shqipërisë në botë;
- g) Krijon marrëdhënie dhe promovon aktivitete përafuese e lidhëse me ambasadat përkatëse në shtete ku jeton diaspora;
- g) Ushtron kompetenca të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 6

### **Qendrat kulturore për diasporën**

1. QKD-të krijohen me qëllim ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë.
2. QKD-të ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për diasporën e Republikës së Shqipërisë dhe hapen në marrëveshje me këto vende.
3. Kreu i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën. Kreu i QKD-së gëzon status diplomatik, për periudhën e ushtrimit të detyrës, dhe pajiset me pasaportë diplomatike.
4. QKD-ja është në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar në atë vend dhe ushtron funksionet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe detyrime të tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi.



5. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e QKD-së rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës. Rregullat e hollësishme për rekrutimin e punonjësve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.
6. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit dhe nivelet e pagave të QKD-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit.
8. Agjencia Kombëtare e Diasporës bashkëpunon dhe koordinon veprimtaritë me QKD-të.

#### Neni 7

### **Përgjegjësitë e QKD-së**

1. QKD-ja ka përgjegjësi:
  - a) Të promovojë Shqipërinë;
  - b) Të nxitë dhe të zhvillojë njohuri për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë;
  - c) Të nxitë bashkëpunimin shkencor, teknik, teknologjik, sportiv e ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës;
  - d) Të ofrojë informacione për investimet në Shqipëri, lehtësitë fiskale, organizimet kulturore e arsimore, takime me bashkatdhetarët dhe me institucione shtetërore në Shqipëri;
  - e) Të mbështetë dhe të organizojë veprimtaritë kulturore, edukative e sportive;
  - f) Të kryejë detyra të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Kreu i QKD-së merr udhëzime nga ministri përgjegjës për diasporën, nëpërmjet kreut të misionit diplomatik të vendit ku është akredituar dhe i informon ata në mënyrë të rregullt për aktivitetin e tij.

#### Neni 8

### **Financimi i QKD-së**

Mjetet për veprimtari të QKD-së sigurohen nga:

- a) Buxheti i shtetit;
- b) Të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.



**KREU III**  
**MBAJTJA, FORCIMI DHE REALIZIMI I LIDHJEVE NDËRMJET VENDIT TË**  
**ORIGINËS DHE DIASPORËS**

Neni 9

**Lidhjet ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës**

Mbajtja, forcimi dhe realizimi i marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës realizohen nëpërmjet:

- a) Përmirësimit të pozitës së pjesëtarëve të diasporës dhe mbrojtjes së të drejtave e interesave të tyre nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dy a shumëpalëshe, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare;
- b) Përdorimit e mësimit të gjuhës shqipe, si dhe ruajtjes së identitetit kulturor, etnik, gjuhësor;
- c) Promovimit të bashkëpunimit ekonomik, lehtësimit fiskal ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- ç) Sigurimit të kushteve për funksionimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;
- d) Dhënies së çmimeve kombëtare për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj.

Neni 10

**Përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe**

1. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës, ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës shqipe.
2. Ministri përgjegjës, së bashku me ministrinë përgjegjëse për arsimin, sipas programit arsimor, ndihmon dhe përkrah zhvillimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe në vendet ku ka një numër të madh pjesëtarësh të diasporës, shtrirje më kompakte apo interes të veçantë shtetëror.
3. Ministri përgjegjës për diasporën dhe ministri përgjegjës për arsimin nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe me institucionet shtetërore homologe të vendeve ku jetojnë pjesëtarë të diasporës për organizimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe dhe njohurive të tjera kulturore për Republikën e Shqipërisë.
4. Organizimi i procesit mësimor dhe përzgjedhja e arsimtarëve në vendet përkatëse, ku jeton dhe vepron diaspora, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën dhe ministrit përgjegjës për



- arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në fuqi.
5. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ndihmon në shpërndarjen e librave të përshtatur për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe e të njohurive të tjera kulturore për Republikën e Shqipërisë në vendet ku jeton dhe vepron diaspora.
  6. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, përgatit dhe zbaton programe për mësimin e gjuhës shqipe në distancë, nëpërmjet internetit (programe telefoni ose tabletë) dhe rrjeteve e kanaleve elektronike të komunikimit masiv, mësimin e historisë së Shqipërisë dhe njohurive të tjera kulturore për të, organizon seminare trajnuese për mësuesit, promovon dhe merr masa të ndryshme për inkurajimin e mësimin plotësues për pjesëtarët e diasporës.

#### Neni 11

### **Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë**

1. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kulturën, përkrah aktivitetet kulturore të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.
2. Në Muzeun Historik Kombëtar themelohet një pavijon i veçantë për diasporën.
3. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kulturën, mbështetin komunitetet shqiptare në shtetet e ndryshme ku ata jetojnë dhe ndihmojnë, nxisin e zhvillojnë marrëdhënie ndërkulturore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve përkatëse, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore.
4. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kulturën, ndihmon të rinjtë në promovimin, ruajtjen, kultivimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe të trashëgimisë kulturore në interes të kujtesës historike për vendin e origjinës, nëpërmjet thirrjeve publike të posaçme për bashkëpunime konkrete dhe nxjerrjen e kalendarëve të eventeve të mundshme të bashkëpunimit ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.



Neni 12

**Bashkëpunimi në fushën e sportit**

Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për sportin, përkrah aktivitetet sportive të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, të trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.

Neni 13

**Informimi**

1. Radiotelevizioni Shqiptar siguron një kanal transmetimi me program radioteleviziv për diasporën. Shpenzimet për prodhimin e programeve të dedikuara për diasporën dhe transmetimin përballohen nga buxheti i shtetit.
2. Biblioteka Kombëtare, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe kulturën, mundëson aksesin në fondin e librave on-line, pa pagesë, për edukimin dhe letërsinë, dedikuar interesave të diasporës.
3. Këshilli i Ministrave nxit dhe inkurajon aktivitetet mediatike të pjesëtarëve të diasporës së Shqipërisë, bazuar në efikasitetin e veprimtarisë së tyre.

Neni 14

**Ekonomia dhe shkenca**

1. Ministri përgjegjës për diasporën i kushton vëmendje të veçantë fuqizimit të lidhjeve ekonomike, bashkëpunimit në fushën e shkencës e të zhvillimit të teknologjive të reja ndërmjet diasporës dhe institucioneve të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik dhe masave të ndryshme të politikës ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
2. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore, përkrah bashkëpunimin me figurat e shquara të shkencës, pjesëtarë të diasporës, në projektet kërkimore institucionale.

Neni 15

**Çmimi vjetor i diasporës**

1. Për pjesëtarët e suksesshëm të diasporës akordohet çmimi "Ambasador i kombit".
2. Kriteret dhe mënyra e ndarjes së çmimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 16

**Burimet ftnciare**

Fondet për ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të vendit të originës e diasporës sigurohen nga:

- a) Buxheti i shtetit;
- b) Të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

**KREU IV**

**ORGANIZIMI I DIASPORËS**

Neni 17

**Organizata e diasporës**

1. Organizata e diasporës është një organizim vullnetar, jofitimprurës i diasporës, që vepron në përputhje me rregullat e vendit të huaj ku jeton diaspora.
2. Organizata e diasporës ka si qëllim promovimin e Shqipërisë dhe përkrahjen e interesave shtetërorë të saj, ruajtjen e nxitjen e marrëdhënieve kulturore, arsimore, shkencore, humanitare dhe sportive me vendin e originës.

Neni 18

**Këshilli Koordinues i Diasporës**

1. Këshilli Koordinues i Diasporës (Këshilli) përfaqëson dhe koordinon marrëdhëniet me diasporën.
2. Këshilli ka këto kompetenca:
  - a) Identifikon problemet e diasporës, i propozon ministrit përgjegjës për diasporën veprime për zgjidhjen e tyre, përcakton linja orientuese për hartimin e strategjisë për diasporën;
  - b) Miraton rregulla procedurale për përmbushjen e veprimtarisë së tij dhe procedurën e vendimmarrjes.
3. Përgjegjësitë profesionale, të përdorimit të fondeve dhe ato administrative, për Këshillin do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.
4. Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e Sekretariatit Teknik.





Neni 19

**Përbërja e Këshillit**

1. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të diasporës.
2. Në aktivitetet e Këshillit marrin pjesë Kryeministri, ministrat përgjegjës për diasporën, punët e jashtme, punët e brendshme, për financat dhe ekonominë, arsimin, kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe përfaqësues të qendrave kulturore të diasporës.
3. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe ministrin e shtetit përgjegjës për diasporën, merr drejtimin embledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 20

**Kriteret për zgjedhjen në Këshill**

1. Përfaqësuesit e diasporës, të cilët do të jenë anëtarë në Këshill, duhet të përmbushin këto cilësi:
  - a) Të kenë integritet të lartë dhe reputacion në komunitetin ku ata jetojnë;
  - b) Të kenë aftësi për të përmbushur detyrat për mbajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës;
  - c) Përfaqësuesit e diasporës zgjidhen sipas këtij rendi;
  - d) Tre përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
  - e) Dy përfaqësues nga diaspora e Kanadasë;
  - f) Gjashtë përfaqësues nga diaspora e Evropës;
  - g) Një përfaqësues nga diaspora e Turqisë;
  - h) Një përfaqësues nga diaspora e Australisë;
  - i) Dy përfaqësues nga Britania e Madhe.
2. Rregullat e hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Vendi i origjinës nuk ushtron influencë në procedurat dhe kushtet e zgjedhjes së përfaqësuesve në Këshill.
4. Vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve i njoftohet ministrit përgjegjës për diasporën të paktën 30 ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen e Këshillit.



Neni 21

**Mbledhja e Këshillit**

1. Këshilli mblihdhet, si rregull, Ditën Kombëtare të Diasporës.
2. Këshilli mund të mblihdhet në sesion të jashtëzakonshëm, me kërkesën e, të paktën, 1/3 së të përfaqësuarve ose me kërkesë të ministrit përgjegjës për diasporën, me një program të përcaktuar paraprakisht.
3. Këshilli, sipas nevojës, mund të krijojë grupe pune për të trajtuar çështje teknike, menatyrëekonomike, statutore, kulturore, shkencore esportive. Numri i anëtarëve dhe mënyra e organizmit e funksionimit të grupeve të punës përcaktohet me vendim të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 22

**Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës**

1. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjitë e caktuara prioritare për diasporën, si edhe brenda vendit, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe orientimit të prirjeve filantropike dhe investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.
2. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës shërben si mekanizëm i njohur nga ligji për orientimin e prirjeve filantropike/donacioneve dhe investimeve të anëtarëve të diasporës në përpjekjet për zhvillimin social-ekonomik e kulturor në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.
3. Rregullat për veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës miratohen me ligj të veçantë

**KREU V**

**DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 23

**Qendra e Botimeve për Diasporën**

1. Botimi i teksteve të veçanta, të cilat i shërbejnë diasporës, realizohet nëpërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën që financohet nga buxheti i shtetit dhe organizohet efunksionon në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën.



2. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

### **Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë**

Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, krijohet një nënkomision “Për diasporën dhe migracionin”, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25

### **Dita e diasporës**

Data 18 dhjetor caktohet si Dita Kombëtare e Diasporës.

Neni 26

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Këshilli Koordinues për Diasporën, Qendrat Kulturore për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën kanë logot e tyre. Modeli i logove është sipas formatit të anekseve bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 27

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 4; 6, pikat 5 e 6; 10, pika 4; 15, pika 2; 20, pika 3; dhe 23, pika 2, të këtij ligji.



Neni 28  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 5.4.2018





**VENDIM**

**Nr. 339, datë 6. 6. 2018**

**PËR KRITERET DHE MËNYRËN E NDARJES SË ÇMIMIT “AMBASADOR I KOMBIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të mënyrës së ndarjes të çmimit “Ambasador i Kombit”.
2. Ndarja e çmimit “Ambasador i Kombit” udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës, mirënjohjes publike. Kriteret, që duhet të plotësojnë pjesëtarët e suksesshëm të diasporës për marrjen e çmimit, janë:
  - a) Integriteti dhe reputacioni në komunitetin ku ai/ajo jeton;
  - b) Përfaqësimi i suksesshëm në diasporë, në:
    - veprimtari humanitare;
    - arsim, shkencë, teknologji;
    - kulturë apo sport;
    - biznes.
  - c) Kontributi i veçantë për Republikën e Shqipërisë apo diasporën.
3. Ambasadorët e Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme, i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën përfaqësuesit më të suksesshëm të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për dhënien e çmimit “Ambasador i Kombit”.
4. Propozimet duhet të shoqërohen me biografinë dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së subjektit të propozuar.
5. Ministri përgjegjës për diasporën vlerëson propozimet e ardhura, së bashku me rekomandimet për dhënien e çmimit, dhe ia propozon ato, zyrtarisht, Kryeministrit.



6. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet nga Kryeministri.
7. Çmimi “Ambasador i Kombit” i dorëzohet personalisht personit që merr çmimin, por, në raste të veçanta, mund t’i dorëzohet edhe familjarëve apo përfaqësuesve të tij.
8. Çmimi “Ambasador i Kombit” nuk ka vlerë monetare.
9. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet në formën e një certificate.
10. Forma e certificate “Ambasador i Kombit” është sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
11. Përfundimisht, për raste të veçanta, propozimi për çmimin “Ambasador i Kombit” mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me këtë vendim, dhe, në këtë rast, nuk do të zbatohet parashikimi i pikës 3.
12. Ngarkohen ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 340, datë 6.6.2018**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E ZGJEDHJES SË PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin erregullave tëhollësishme për kushtet dhe mënyrën ezgjedhjes së 15 përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës.
2. Përfaqësuesit e diasporës, kandidatë për anëtarë në Këshillin Koordinues të Diasporës, përveç kriterëve tëparashikuara në ligjin nr.16/2018, "Për diasporën", duhet të përmbushin edhe këto kriterë:
  - a) Të jenë persona të spikatur në fushat e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës, sportit etj., apo të suksesshëm në fushën e biznesit;
  - b) Të jenë persona të njohur në fushën e filantropisë dhe të kenë kontribuar në çështje që lidhen me diasporën apo vendin e originës;
  - c) Të jenë pjesë aktive e forumeve organizative të diasporës në vendet pritëse.
3. Për procedurën e propozimit e të zgjedhjes duhet të zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
4. Numri ikandidaturave duhet të jetë jo më pak se dyfishi inumrit të përfaqësimit, duke iu referuar rendit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 20, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën".
5. Ambasadorët ejashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën kandidatët për Këshillin Koordinues të Diasporës.



6. Ambasadorët bashkëpunojnë me organizatat e diasporës, të njohura e të regjistruara sipas legjislacionit të vendit pritës, për gjetjen e kandidaturave.
7. Për raste të veçanta ose në mungesë të kandidaturave të propozuara, propozimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës (jo më shumë se 3 propozime) mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën.
8. Propozimet duhet të shoqërohen me jetëshkrime e dokumente, kualifikime dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së përfaqësuesit të propozuar.
9. Në vijim të propozimeve të ardhura, ministri përgjegjës për diasporën përzgjedh 15 kandidatët për anëtarë të Këshillit Koordinues të Diasporës, dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Ministrave.
10. Tëpaktën 30 për qind e anëtarësisë duhet të jetë e përfaqësuar nga gjinia femërore.
11. Përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Diasporës zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë.
12. Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës lirohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
  - a) Jep dorëheqjen, me kërkesë individuale;
  - b) Ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit;
  - c) Lirohet për shkaqe të tjera.
13. Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet, kur:
  - a) Neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e këshillit drejtues;
  - b) Nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji nr. 16/2018, “Për diasporën”, dhe nga ky vendim;
  - c) Nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhje për më shumë se 2 herë radhazi;
  - d) Bëhet i paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore;
  - e) Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, vepron në kundërshtim me interesat e Këshillit Koordinues të Diasporës.





14. Ministri përgjegjës për diasporën, jo më vonë se 30 ditë pune para mbledhjes së ardhshme të Këshillit Koordinues të Diasporës, i propozon Këshillit të Ministrave kandidatët e rinj, për të zëvendësuar anëtarin e liruar apo të shkarkuar. Mandati i zëvendësuesit llogaritet i plotë, nga dita e emërimit të tij.
15. Përjashtimisht për zgjedhjet e para, propozimet duhet të dorëzohen para fundit të muajit gusht 2018.
16. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 469, datë 26.7.2018**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË  
BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën (në vijim, "QBD"), si person juridik publik buxhetor, meseli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën.
2. QBD-ja është përgjegjëse, për:
  - a) Botimin, në përputhje me ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", të teksteve që do t'i shërbejnë diasporës;
  - b) Redaktimin përfundimtar të teksteve që do të botohen;
  - c) Nxitjen e aksesit on-line të teksteve të veçanta për diasporën;
  - ç) Nxitjen e krijimit të formateve të posaçme për e-book;
  - d) Bashkërendimin e punës me operatorin ekonomik, i cili bën shpërndarjen e teksteve;
  - e) Koordinimin me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për botimet për diasporën.
3. Shtypja e teksteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi realizohet nga vetë QBD-ja dhe shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit.
4. QBD-ja të përdorë programet e teksteve mësimore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe botime të tjera me miratimin e ministrit përgjegjës për diasporën.
5. QBD-ja, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin dhe pas miratimit të ministrit përgjegjës për diasporën, boton edhe tekste të tjera nga ato të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi.



6. QBD-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e qendrës dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për diasporën. Ai emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën.
7. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës së QBD-së të emërohen e të lirohen nga drejtori i QBD-së. Marrëdhënia e punës për drejtorin dhe punonjësit e QBD-së të rregullohet me Kodin e Punës.
8. Pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ këshillimor evendimmarrës për çështjet e botimeve për diasporën.
9. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili ka përfaqësues nga:
  - Ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
  - Ministria përgjegjëse për arsimin;
  - Ministria përgjegjëse për diasporën.
  - Akademia e Shkencave e Shqipërisë;
  - Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.
10. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka këto kompetenca:
  - a) Mbledh dhe shqyrton kërkesat vjetore për botime për diasporën dhe shqyrton kërkesat e herëpashershme, të cilat mund të mos jenë parashikuar në kërkesat vjetore;
  - b) Miraton programet e botimeve të QBD-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;
  - c) Planifikon shpërndarjen e teksteve të botuara nga qendra;
  - ç) Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislativitetit në fuqi;
  - d) Ipropozon ministrit përgjegjës për diasporën botimin e teksteve të tjera;
  - e) Ipropozon ministrit përgjegjës për diasporën çmimet e shitjeve të teksteve, të cilat vendosen duke respektuar dispozitat e ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, të ndryshuar, dhe kategoritë që përfitojnë falas kopje të teksteve të botuara nga QBD-ja, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky këshill ka dhe kompetenca të tjera, në përputhje me ligjin, të ngarkuara nga ministri përgjegjës për diasporën ose drejtori i qendrës.



11. Mandati i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
12. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën duhet të jenë drejtues të nivelit të lartë të institucioneve të përfaqësuar, të cilët emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën, me propozim të titullarit të institucionit përkatës. Ministri përgjegjës për diasporën cakton njërin nga anëtarët si kryetar të këtij këshilli.
13. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën shkarkohen para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, kur:
  - a) Lirohet ose shkarkohet nga funksioni drejtues që ushtronte në institucionin që përfaqëson;
  - b) Me propozim të titullarit të institucionit të përfaqësuar, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave që ai kryen në atë institucion;
  - c) Neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.
14. Ministri përgjegjës për diasporën, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të mandatit 4-vjeçar ose menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon institucionit të përfaqësuar në Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën paraqitjen e emrit të kandidatit për anëtar të këtij këshilli.
15. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve të Diasporës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
16. Struktura dhe organika e QBD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
17. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QBD-së miratohen nga ministri përgjegjës për diasporën pas propozimit të drejtorit të saj.
18. QBD-ja është institucion buxhetor që financohet nga buxheti i shtetit.
19. Çmimet e shitjes së teksteve të botuara nga QBD-ja dhe kategoritë që mund t'i përfitojnë falas ato përcaktohen me vendim Këshillit të Ministrave, me



bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për diasporën dhe të ministrit përgjegjës për financën.

20. QBD-ja ka stemën dhe logon e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë”, “Ministri i Shtetit për Diasporën”, “Qendra e Botimeve për Diasporën”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë. Logoja e QBD-së të vendoset në çdo botim, në përputhje me nenin 26, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”.
21. Vula e QBD-së ka formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
22. Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ristrukturohet në Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD). Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
23. Vendimi nr. 843, datë 2.11.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)”, indryshuar, shfuqizohet.
24. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 470, datë 26.7.2018**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRAVE  
KULTURORE PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5 e 6, të nenit 6, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të vendimit nr. 58, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Qendrat Kulturore në Diasporë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrave Kulturore për Diasporën (QKD), si persona juridikë, publikë, në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar në vendin pritës.
2. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin nr. 16/2018, "Për diasporën", dhe i raportojnë, mbikëqyren e koordinohen nga Agjencia Kombëtare për Diasporën (AKD).
3. QKD-të kanë si mision ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë.
4. QKD-të kryejnë këto funksione administrative:
  - a) Promovojnë Shqipërinë në ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë;
  - b) Nxisin dhe zhvillojnë njohuri për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë;
  - c) Nxisin bashkëpunimin shkencor, teknik, teknologjik, sportiv e ekonomik, artistik dhe kulturor, ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës;
  - d) Mbështesin dhe organizojnë rininë dhe grup-moshat e ndryshme të diasporës me aktivitete kulturore, edukative, sportive etj.;
  - e) Bashkëpunojnë me institucione të tjera për të zhvilluar aktivitetin e saj brenda dhe jashtë vendit;
  - f) Kryejnë detyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.



5. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për mbartjen e trashëgimisë kulturore, të identitetit etj., në diasporë, dhe hapen me marrëveshje dypalëshe me shtetet e këtyre vendeve.
6. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën.
7. QKD-të financohen nga buxheti i miratuar për përfaqësinë diplomatike.
8. Misionet diplomatike ku do të ushtrojnë aktivitetin e tyre QKD-të, funksionet që do të kryejnë, raportet me kreun e misionit, si edhe çështje të tjera të veprimtarisë së tyre, rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për diasporën.
9. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QKD-së miratohet me urdhër të kreut të misionit diplomatik, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për diasporën.
10. QKD-ja drejtohet nga titullari, i cili administron dhe drejton veprimtarinë e përditshme e saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Për veprimtarinë e tij administrative ai përgjigjet para kreut të misionit diplomatik dhe ministrit përgjegjës për diasporën. Për çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike, titullari i QKD-së duhet të marrë mendimin e kreut të misionit.
11. Titullari i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën, në përputhje me pikën 2, të nenit 31, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm, të Republikës së Shqipërisë”.
12. Titullari ushtron të gjitha kompetencat për drejtimin e veprimtarisë së institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me funksionet e objektivat e QKD-së, si më poshtë:
  - a) Drejton dhe përfaqëson QKD-në;
  - b) I raporton kreut të misionit diplomatik, ministrit përgjegjës për diasporën dhe drejtorit ekzekutiv të AKD-së;
  - c) Bashkërendon punën ndërmjet strukturave të qendrës dhe cakton detyra dhe objektiva përkatës për t'u realizuar nga këto struktura;
  - ç) Propozon programin vjetor të veprimtarive të QKD-së, të cilin ia paraqet për miratim kreut të misionit diplomatik dhe për dijeni ministrit përgjegjës për diasporën e drejtorit ekzekutiv të AKD-së;



- d) Kontrollon mbarëvajtjen e aktivitetit të QKD-ve, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar dhe realizimin sa më të plotë të funksioneve të saj, si dhe merr masat e nevojshme për koordinimin sa më mirë të punës ndërmjet strukturave të QKD-së;
- dh) Informon rregullisht dhe përgjigjet te kreu i misionit diplomatik, ministri përgjegjës për diasporën dhe drejtori ekzekutiv i AKD-së për mbarëvajtjen e aktivitetit të QKD-së dhe për realizimin e funksioneve të saj.
13. Titullarët e QKD-ve, të emëruar në misionet diplomatike, pajisen me pasaportë diplomatike dhe gëzojnë të njëjtin status me diplomatët gjatë periudhës që janë të emëruar në këto misione. Ata marrin gradë diplomatike, në varësi të strukturës së misionit diplomatik dhe trajtohen financiarisht me pagën, shtesat mbi pagë dhe kompensimin për koston e jetesës sipas gradës së emërimit në misionin diplomatik në vendin ku shërbejnë.
14. Anëtarët e familjes së titullarëve pajisen me pasaporta diplomatike dhe gëzojnë të njëjtin trajtim me familjet e anëtarëve të diplomatëve, sipas ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm, të Republikës së Shqipërisë", dhe të akteve nënligjore në fuqi.
15. Nëpunësit e QKD-ve do të punojnë me kohë të plotë, por nuk do të jenë të akredituar në shtetin pritës. Ata emërohen nga ministri përgjegjës për diasporën, me propozim të kreut të misionit diplomatik.
16. Vulat e QKD-ve kanë formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare".
17. Stema e QKD-ve përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet "Republika e Shqipërisë", "Ambasada përkatëse", "Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme", si dhe "Qendra Kulturore për Diasporën", në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.
18. Ngarkohen ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën, Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Qendrat Kulturore për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**





**VENDIM**

**Nr. 690, datë 14.11.2018**

**PËR PRODHIMIN, TRANSMETIMIN DHE FINANCIMIN E EMISIONEVE TË  
POSAÇME TELEVIZIVE, ARSIMORE DHE KULTURORE, TË DEDIKUARA PËR  
DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të nenit 116, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audio-vizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Prodhimin, transmetimin dhe financimin nga buxheti i shtetit të emisioneve të posaçme televizive, për mësimin e gjuhës shqipe dhe për kulturën shqiptare, të dedikuara për diasporën, si pjesë të programit “RTSH3”, të Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH).
2. Emisioni i posaçëm televiziv për mësimin e gjuhës shqipe prodhohet e transmetohet nga Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH) dhe financohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Emisioni i posaçëm televiziv për kulturën shqiptare, si prodhim i pavarur i Ministrisë së Kulturës, transmetohet nga Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH), me financimin e buxhetit të miratuar për ministrinë.
4. Përmbajtja e programeve të emisionit të posaçëm televiziv për mësimin e gjuhës shqipe do t’u kushtohet interesave të arsimit për komunitetet shqiptare jashtë vendit, sipas kurrikulës së përbashkët të realizuar për këtë qëllim, në bazë të marrëveshjes me qeverinë e Republikës së Kosovës.
5. Platforma e programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar të përgatitet nga një grup pune ndërinstitucional, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me përfaqësues të ministrive përgjegjëse për arsimin, kulturën dhe diasporën.



6. Transmetimet e programeve të miratuara do të inkurajojnë mësimdhënien online dhe, pas transmetimit periodik në “RTSH 3”, do të vihen në dispozicion të publikut të interesuar pa pagesë.
7. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Kulturës, për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme, sipas pikave 1, 2 e 3, të këtij vendimi, të lidhin marrëveshjet përkatëse me Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH).
8. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe ministri i Shtetit për Diasporën, brenda fushës së tyre të përgjegjesisë, në bashkëpunim me Radiotelevizionin Shqiptar, të marrin masat e nevojshme për realizimin e emisioneve të posaçme dhe transmetimin e tyre, duke filluar nga viti i ri mësimor 2019–2020.
9. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe ministri përgjegjës për diasporën të mbështesin Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH) për zbatimin e marrëveshjes me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) për realizimin, brenda vitit 2019, të programit të përbashkët televiziv mbi bazën e interesave të diasporës shqiptare.
10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË**

Nr. 10700 prot.  
Tiranë, më 15.10.2018

**MINISTRIA E SHTETIT  
PËR DIASPORËN**

Nr. 4791 prot.  
Tiranë, më 16.10.2018

**URDHËR I PËRBASHKËT  
Nr. 682, datë 15.10.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E PROJEKTAKTEVE  
NËNLIGJORE PËR REGJISTRIN SHTETËROR TË MËSUESVE TË DIASPORËS  
DHE TË CERTIFIKATËS SË NXËNËSVE NË DIASPORË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 12, pika 5, të ligjit nr. 48/2018, datë 2.8.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve nënligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës dhe të certifikatës së nxënësve në diasporë, me përbërjen e mëposhtme:
  - a. Besnik Rama kryetar, MASR
  - b. Anila Ferizaj anëtar, MASR
  - c. Dorina Rapti anëtar, IZHA
  - d. Ilda Sadikaj anëtar, MASR
  - e. Altea Tahiraj anëtar, MASR
  - f. Florian Nurce anëtar, MASR
  - g. Dritan Delija anëtar, MSHD
  - h. Erta Skora anëtar, MSHD

**MINISTËR  
LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR  
PANDELI MAJKO**



**VENDIM**

**Nr. 11, datë 9.1.2019**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**VENDOSI:**

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2019, në zërin

“Shërbime qeveritare”, i shtohet fondi prej 66 972 800 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, brenda datës 31 janar 2019, për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, që do të zhvillohet në datat 28 shkurt - 2 mars 2019 në Tiranë dhe Lezhë.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

Ministria e Kulturës, brenda fushës së përgjegjësisë së vet, të bashkërendojë me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare për organizimin e aktiviteteve social-kulturore dhe vendosjen në përdorim të monumenteve të kulturës, sipas rastit.

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**  
**Nr. 50, datë 27.2.2019**

**PËR DHËNIEN E ÇMIMIT “AMBASADOR I KOMBIT”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, dhe të pikave 5 e 6, të vendimit nr.339, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit “Ambasador i Kombit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Dhënie e çmimit “Ambasadori Kombit”, personave sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 104, datë 28.02.2019**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR  
TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE DHE  
DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR NXËNËSIT NË DIASPORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe tëneneve 11 dhe 49 të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Ministria përgjegjëse për arsimin krijon regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
2. Regjistri përmban listën e mësuesve të cilët kanë të drejtë të japin mësim për programin e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
3. Pasqyrimi në regjistrin shtetëror i të dhënave të mësuesve në diasporë bëhet pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre, në rrugë elektronike apo postare, në ministrinë përgjegjëse për arsimin.
4. Në regjistrin shtetëror të mësuesve në diasporë përfshihen mësuesit që:
  - a) janë të diplomuar në fushën e mësuesisë në institucionet e arsimit të lartë. Përparësi kanë mësuesit e diplomuar në degët: gjuhë shqipe dhe letërsi, parashkollor, arsim fillor, histori, gjeografi, etnologji, muzikë dhe arte të kulturës shqiptare.
  - b) janë të licencuar si mësues sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës apo vendeve ku zhvillohet programi i mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.
  - c) anë të pranuar si mësues të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në vendet respektive.
5. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton rregullat për aplikimin, procedurat, afatet dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin mësuesit e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.



6. Regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë përmban të dhënat sipas modelit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Mësuesit që bëhen pjesë e regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, pajisen me certifikatë regjistrimi, sipas modelit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë administrohet, përditësohet dhe ruhet nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.
9. Ministria përgjegjëse për arsimin përgatit certifikatën për nxënësit që përfundojnë programin e mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, sipas marrëveshjes “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, datë 23.03.2015.
10. Certifikata e nxënësit duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) numrin e regjistrimit,
  - b) të dhënat e nxënësit,
  - c) vlerësimin e arritjeve.
11. Forma dhe përmbajta e certifikatës së nxënësit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin.
12. Kërkesa për sasinë e certifikatave të nxënësve iparaqitet ministrisë përgjegjëse për arsimin nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
13. Certifikatat për nxënësit, certifikatat e regjistrimit për mësuesit, si dhe regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë prodhohen nga Qendra e Botimeve për Diasporën, sipas porosisë së ministrisë përgjegjëse për arsimin. Certifikatat për nxënësit shpërndahen nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministri i Shtetit për Diasporën.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 443, datë 26.06.2019**

**PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR DHE PËRZGJEDHJEN E  
ARSIMTARËVE NË DIASPORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr. 16/2018, datë 05.04.2018 “Për diasporën”, me propozimin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Objekti i këtij vendimi është të nxisë dhe të përkrahë organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në vendet pritëse të diasporës shqiptare. Procesi mësimor në vendet pritëse të diasporës shqiptare është mësimi igjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare.
2. Procesi mësimor dhe përzgjedhja e arsimtarëve në diasporë mbështetet nga ministria përgjegjëse për arsimin në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe shtetërore dhe në përputhje me legjislacionin e vendit pritës të diasporës shqiptare. Ky proces realizohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën dhe ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.
3. Kanë të drejtë të ndjekin mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në vendet pritëse të diasporës shqiptare:
  - a) fëmijët e moshës deri në 18 vjeç me kombësi shqiptare.
  - b) çdo person me origjinë shqiptare që jeton në vendin pritës, pavarësisht statusit të tij, me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm, azilkërkues, të strehuar të përkohshëm apo persona pa shtetësi.
4. Mësimi zhvillohet në përputhje me kurrikulën e përbashkët të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, sipas marrëveshjes midis ministrisë së arsimit dhe sportit të Republikës së Shqipërisë, ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë si dhe ministrisë së diasporës të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatës” datë 23.3.2015”, ose sipas programeve dhe planeve të miratuara nga ministrinë përgjegjëse për arsimin në vendet pritëse.





5. Ministrinë përgjegjëse të arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës bashkëpunojnë për hartimin e dokumenteve të përbashkëta për organizimin e procesit mësimor, duke parashikuar mënyrën e formimit të grupeve të nxënësve, rezultatet e të nxënësve sipas niveleve, tematikat dhe temat mësimore orientuese, planin mësimor, kohëzgjatjen e orëve mësimore, mënyrën e vlerësimit e nxënësve dhe aspekte të tjera që kanë të bëjnë me fushën e të nxënësve.
6. Ministria përgjegjëse për diasporën, nëpërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, mbështet dhe inkurajon procesin mësimor të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me tekste shkollore, materiale plotësuese dhe zhvillim profesional të mësuesve.
7. Kërkesa për tekste shkollore, materiale plotësuese dhe sasia e tyre mbledhet nga përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në vendet pritëse të diasporës shqiptare. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme idërgon këto kërkesa, të përcaktuara sipas vendeve dhe grupmoshave të fëmijëve, brenda muajit maj të çdo viti në Qendrën e Botimeve për Diasporën, ministrit të Shtetit për Diasporën dhe për dijeni ministrisë përgjegjëse për arsimin. Qendra e Botimeve për Diasporën dërgon në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme sasinë e teksteve dhe materialeve plotësuese, brenda muajit gusht të çdo viti, për t'i shpërndarë sipas kërkesave në vendet pritëse të diasporës shqiptare.
8. Qendra e Botimeve të Diasporës pranon kërkesa për tektë shkollore edhe nga mësuesit që janë bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, konfirmuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Qendra e Botimeve të Diasporës lidh me këta mësues kontrata të furnizimit me tekste shkollore për fëmijët në diasporë.
9. Qendra e Botimeve të Diasporës përgatit informacion vjetor për sasinë dhe mënyrën e shpërndarjes së teksteve shkollore në diasporën shqiptare, të cilin e dërgon pranë ministrive përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

Pikat 6.5 dhe 6.6 të Vendimit nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", indryshuar, shfuqizohen.



10. Deri në miratimin e teksteve të përbashkëta për arsimin në diasporë nga Komisioni i Përbashkët në zbatim të Marrëveshjes “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe nga Ministria e Diasporës së Republikës së Kosovës, kërkesat për tekste shkollore, materiale plotësuese dhe sasia e tyre në përputhje me pikën 7 të këtij vendimi do të dërgohen drejtpërdrejtë pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën, e cila ngarkohet me sigurimin dhe shpërndarjen e tyre brenda muajit shtator.
11. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministri i Shtetit për Diasporën, Qendra e Botimeve të Diasporës dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe meporosi**

**ZËVENDESKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHTETIT**

**PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**

**MINISTRIA E ARSIMIT,**

**SPORTIT DHE RINISË**

**BESA SHAHINI**



**VENDIM**

**Nr. 24, datë 16.1.2019**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS  
KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT**

Nëmbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit (në vazhdim QKLL).
2. QKLL-ja krijohet dhe funksionon si person juridik publik, buxhetor, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për librin, me seli në Tiranë.
3. Qëllimi i QKLL-së është pëmbushja e detyrave zhvillimore dhe shërbimeve të drejtpërdrejta në fushën e librit, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Misioni i QKLL-së është ndjekja dhe zbatimi i projekteve në fushën e librit, sipas programit qeverisës të ministrisë përgjegjëse për librin, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror.
5. Të ardhurat e QKLL-së përbëhen nga:
  - a) buxheti i shtetit;
  - b) të ardhura të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QKLL-së**

6. QKLL-ja kryen çdo funksion që lidhet me mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e krijimtarisë letrare e të përkthimit, si dhe kontribuon në zhvillimin e politikave në fushën e librit, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



- a) QKLL-ja siguron kushtet për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e librit e të leximit në zhvillimin e individit dhe të shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit.
- b) QKLL-ja realizon funksionet e parashikuara në interes të publikut, me qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e fushës së librit dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.
- c) Qëllimi i funksionimit të QKLL-së, sipas përcaktimeve të mësipërme, nuk përfshin tekstet shkollore.

### III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QKLL-së

1. QKLL-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:
  - a) Harton programet dhe financon projektet në fushën e librit;
  - b) Mbështet botimet e librave dhe të revistave në fushën e letërsisë e të shkencave shoqërore edhe në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara;
  - c) Krijon kushtet nxitëse për krijuesit në fushën e letërsisë, duke siguruar mbështetje financiare dhe organizon konkurse për dhënien e çmimëve kombëtare letrare;
  - d) Nxit e promovon librin dhe autorët e përkthyesit shqiptarë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - e) Realizon dhe promovon, në forma të ndryshme:
    - I. bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e librit;
    - II. përkthime të veprave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaja;
    - III. prezantime të letërsisë shqipe në nivel ndërkombëtar.
  - f) Krijon kushtet për zhvillimin e kulturës së leximit në të gjitha grup-moshat, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - g) Promovon zhvillimin e rrjetit libror në të gjithë territorin e vendit dhe krijon kushtet për një qasje të shtuar drejt politikave të librit, për lexuesit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën;
  - h) Bashkëpunon me institucione ndërkombëtare, që veprojnë në fushën e librit;
  - i) Monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e programeve etë projekteve që mbështet;
  - j) Bashkëpunon me organet shtetërore për zbatimin e politikave publike dhe akteve të tjera rregulluese në fushën e librit, sidhe me organizata që kanë në fokus zhvillimin dhe përhapjen e kulturës së librit;
  - k) Siguron fonde të jashtme dhe burime të tjera të financimit në fushën e librit, sipas legjislativitetit në fuqi;



- l) Nxjerr akte administrative dhe realizon detyra të tjera, me natyrë trajnuese e promovuese, në përputhje me qëllimin e QKLL-së;
  - m) I propozon ministrisë përgjegjëse për librin ndryshime në legjislacionin në fuqi në fushën e librit.
2. QKLL-ja, nëpërmjet buxhetit të saj të miratuar për çdo vit kalendarik, financon projekte të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre fushën e librit.
  3. Financimi i projekteve dhe organizimi i veprimtarive të QKLL-së, sipas rastit, realizohet në përputhje me shkronjat “a” ose “b”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar.
  4. Realizimi i projekteve të QKLL-së miratohet me urdhër të titullarit, pas propozimit nga kolegji i QKLL-së.
  5. Kolegji është një organizëm kolegial pranë QKLL-së.
  6. Kolegji, i ngritur sipas përcaktimeve të këtij kreu, vlerëson dhe përzgjedh projektet nga pikëpamja e përmbajtjes dhe asaj financiare, duke i paraqitur titullarit propozimet për miratim.
  7. Kolegji ka në përbërje jo më pak se 3 anëtarë, të përzgjedhur nga personalitete në fushën e letrave. Anëtarët e kolegjit përcaktohen me urdhër të titullarit të QKLL-së.
  8. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të kolegjit përcaktohen në statutin e QKLL-së.
  9. Kompetencat dhe mënyra e funksionimit të kolegjit të QKLL-së miratohen nga titullari i institucionit.
  10. Kriteret dhe procedurat në lidhje me projektpropozimet për mbështetje financiare, të parashikuara sipas këtij kreu, përcaktohen me urdhër të titullarit të QKLL-së.
  11. Struktura dhe organika e QKLL-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për librin, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.



12. Marrëdhënia e punës së punonjësve të QKLL-së rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
13. 12.QKLL-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga titullari, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e qendrës dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për librin. Ai emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për librin.
14. Procedura e ndjekur për emërimin, lirimin ose shkarkimin e titullarit të QKLL-së bëhet sipas vendimit nr. 173, datë 7.3.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.
15. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QKLL-së miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për librin, me propozimin e titullarit të QKLL-së.
16. Stema e QKLL-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Fletorja Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
17. Vula e QKLL-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Trajtimi financiar dhe mbështetja logjistike e QKLL-së realizohen nga Ministria e Kulturës.
2. Ngarkohet ministri i Kulturës që, brenda 15 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të propozojë Kryeministrit strukturën dhe organikën e QKLL-së.
3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 76, datë 15. 04. 2019**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË QENDRËS SË  
BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

1. Struktura e Qendrës së Botimeve për Diasporën të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Qendrës së Botimeve për Diasporën të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Qendrës së Botimeve për Diasporën të jetë, gjithsej, 15 veta.
4. Urdhri nr.94, datë 21.2.2014, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 492 , datë 10.7.2019**

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS  
TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN PËR  
VITIN SHKOLLOR 2019 - 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit 16/2018, “Për diasporën”, të ligjit nr.9616 datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019” , dhe të pikës 19 të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Qendra e Botimeve për Diasporën me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, boton dhe siguron falas, për vitin shkollor 2019-2020, tekstet shkollore dhe ato plotësuese sipas listës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit sipas përcaktimeve në vendimin nr.443 datë 26.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.
3. Tekstet shkollore dhe ato plotësuese të botuara, të siguruar, nga Qendra e Botimeve për Diasporën duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni si dhe me pullën hologramë, të certifikimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Qendra e Botimeve për Diasporën siguron pullën me hologramë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kundrejt pagesës.
4. Çmimet e teksteve shkollore dhe ato plotësuese për mësimdhënien në diasporën shqiptare vendosen në kopertinat e tyre përkatëse, në përputhje me listën 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti imiruar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.





6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN  
PANDELI MAJKO**

**MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
ANIJA DENAJ**



## Lista nr. 1

**LISTA E TEKSTEVE SHKOLLORE PËR DIASPORËN  
PËR VITIN SHKOLLOR 2019 - 2020**

Nr.	Titulli	Tirazhi	Çmimi për copë / lekë
1	Abetare ( <i>Shkronjë pas Shkronje</i> )	3215 copë	507 lekë
2	Fletore pune Abetareje	2775 copë	243 lekë
3	Gjuhë shqipe 2	1510 copë	453 lekë
4	Fletore pune 2	330 copë	250 lekë
5	Gjuhë shqipe 3	945 copë	394 lekë
6	Fletore pune 3	330 copë	300 lekë
7	Gjuhë shqipe 4	310 copë	460 lekë
8	Fletore pune 4	200 copë	300 lekë
9	Gjuhë shqipe 5	185 copë	530 lekë
10	Fletore pune 5	150 copë	250 lekë
11	Gjuhë shqipe 6	85 copë	539 lekë
12	Fletore pune 6	50 copë	250 lekë
13	Histori e Shqipërisë 9	220 copë	297 lekë
14	Gjeografi e Shqipërisë 9	220 copë	284 lekë
15	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1 / Seteshkollore për fillestarë	120 copë	346 lekë
16	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2 / Seteshkollore për më të rritur	150 copë	346 lekë
17	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3 / Seteshkollore për më të rritur	150 copë	346 lekë
18	Matematika 1	24 copë	530 lekë
19	Matematika 2	24 copë	291 lekë
	<b>TOTALI</b>	<b>10 993 copë</b>	<b>4.231.499 lekë</b>



**VENDIM**

**Nr. 723, datë 11.11.2019**

**PËR “DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 492, DATË 10. 07. 2019 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN PËR VITIN SHKOLLOR 2019 - 2020”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit 16/2018, “Për diasporën”, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të pikës 19, të Vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 492, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave bëhen ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“1. Qendra e Botimeve për Diasporën, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, boton dhe siguron falas, për vitin shkollor 2019-2020, tekstet shkollore sipas listës nr. 1, tekstet shkollore shtesë sipas listës nr. 2 dhe literaturën plotësuese, sipas listës nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.
2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore dhe ato të literaturës plotësuese, të botuara apo të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit sipas përcaktimeve të vendimit nr.443 datë 26.06.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.
3. Në pikën 4, pas fjalëve “...me listën 1,...” shtohen “... me listën nr 2 dhe listën nr 3,...”.



4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për sigurimin e teksteve shkollore dhe plotësuese të listës , sipas listave nr.1, nr.2 e nr.3, si dhe shpërndarjen e teksteve shkollore shtesë dhe plotësuese të listave nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.
5. Paslistës nr.1, bashkëlidhur vendimit, shtohen listat nr.2 dhe nr.3 qëi bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN  
PANDELI MAJKO**

**MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
ANIJA DENAJ**



Lista nr. 2

**LISTA E TEKSTE SHKOLLORE SHITESË PËR DIASPORËN, PËR VITIN  
SHKOLLOR 2019-2020**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli</b>	<b>Tirazhi</b>	<b>Çmimi për copë / lekë</b>
1	Abetare	81 copë	507
2	Fletore pune Abetare	81 copë	243
3	Gjuha shqipe 2	51 copë	453
4	Gjuha shqipe 3	51 copë	394
5	Gjuha shqipe 4	45 copë	460
6	Gjuha shqipe 5	37 copë	530
7	Gjuha shqipe 6	36 copë	539
8	Gjuha shqipe 7	36 copë	450
9	Gjuha shqipe 8	40 copë	410
10	Gjuha shqipe 9	40 copë	492
11	Gjuha shqipe 11	26 copë	350
12	Gjuha shqipe 12	26 copë	570
13	Të mësojmë gjuhën amtare 1	79 copë	346
14	Të mësojmë gjuhën amtare 2	58 copë	346
15	Të mësojmë gjuhën amtare 3	50 copë	346
	<b>TOTALI</b>	<b>737 copë</b>	<b>304 563 lekë</b>

\* Në vlerën totale është përfshirë edhe TVSH-ja (për librin 6%).



## Lista nr. 3

**LISTA E LITERATURËS PLOTËSUESE PËR MËSIMDHËNIEN NË DIASPORË,  
PËR VITIN SHKOLLOR 2019-2020**

Nr.	Titulli	Tirazhi	Çmimi për copë / lekë
1	LUAJ ME SHKRONJAT (Kuti kartoni që ka fisha me shkronja e figura dhe me CD) Shtëpia Botuese ALBAS	500 copë	954 lekë
2	SHKRONJAT (shkruaj, fshi, mëso) me laps magjik Shtëpia Botuese AEDITIONS	500 copë	500 lekë
3	NJË HAP DREJT SHKOLLËS (Paketë për fëmijë 5-6 vjeç) Shtëpia Botuese ALBAS	500 copë	2200 lekë
4	ÇUFOJA DHE BUBI KAÇURREL Shtëpia Botuese ÇABEJ	500 copë	750 lekë
5	TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE (lidhje speciale) Shtëpia Botuese KUTELI '04	500 copë	2000 lekë
6	NJË ELEFANTELEGANT (Përrallë me pengesa) Shtëpia Botuese BOTART	500 copë	400 lekë
7	50 PËRRALLAT MË TË BUKURA Shtëpia Botuese AEDITIONS	500 copë	1500 lekë
8	DI TË LUAJ DHE TË QESH (150 GJËEGJËZA) Shtëpia Botuese EXTRA	500 copë	300 lekë
9	FABULAT E EZOPIT (lidhje speciale) Shtëpia Botuese PEGI	500 copë	500 lekë
10	PRINCESHA ARGJIRO Shtëpia Botuese ONUFRI	500 copë	500 lekë
11	Malli për Mëmëdhenë Shtëpia Botuese MEDIAPRINT	500 copë	2500 lekë

\*Në vlerën totale është përfshirë edhe TVSH-ja (për librin 6%).



**VENDIM**

**Nr. 195 , datë 05. 04. 2019**

**PËR MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1 të nenit 19, dhe nenit 20, të ligjit nr. 16/2018, datë 05.04.2018 “Për diasporën”, dhe të pikës 9, të vendimit nr. 340, datë 6.6.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përbërjen e Këshillit Koordinues të Diasporës nga anëtarët e përzgjedhur sipas rendit të mëposhtëm:
  - Z. Mark Gjonaj – përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
  - Z. Visar Tasimi - përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
  - Znj. Esmeralda Mosko - përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
  - Znj. Adriana Fishta Bejko - përfaqësues nga diaspora e Kanadasë;
  - Z. Ardian Radovicka - përfaqësues nga diaspora e Kanadasë;
  - Z. Lazim Destani - përfaqësues nga diaspora e Gjermanisë;
  - Z. Sokrat Sinaj - përfaqësues nga diaspora e Zvicrës;
  - Z. Ardian Lekaj - përfaqësues nga diaspora e Hollandës;
  - Z. Rosario Peta - përfaqësues nga diaspora e Italisë;
  - Znj. Anila Hyka Smorgrav - përfaqësues nga diaspora e Francës;
  - Z. Gazmend Kapllani - përfaqësues nga diaspora e Greqisë;
  - Z. Namik Shabi - përfaqësues nga diaspora e Turqisë;
  - Z. Bashkim Bekiri - përfaqësues nga diaspora e Australisë;
  - Znj. Brikena Muharremi – përfaqësues nga Britania e Madhe;
  - Z. Endri Hatillari – përfaqësues nga Britania e Madhe.
2. Mbledhja e parë e Këshillit Koordinues të Diasporës do të mbahet në Ditën Kombëtare të Diasporës, më 18 dhjetor 2019.



3. Ngarkohen ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**





**VENDIM**

**Nr.320, datë. 15. 05. 2019**

**PËR STATUSIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, gjatë kohëzgjatjes së mandatit dhe ushtrimit të aktiviteteve të tyre, gëzojnë status të veçantë në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
2. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, në funksion të përmbushjes së detyrave për mbrojtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, kanë të drejtë:
  - a) të kërkojnë informacion me interes në fushën e përgjegjësisë që mbulojnë nga institucionet shtetërore përgjegjëse;
  - b) të propozojnë akte administrative pranë institucioneve shtetërore që lidhen me interesat e komuniteteve shqiptare në diasporë;
  - c) të marrin pjesë në seanca dëgjimore në Komitetin Shtetëror të Diasporës ose komisionet e Kuvendit të Shqipërisë për çështje që kanë të bëjnë me interesat e diasporës shqiptare;
  - d) të pajisen me një adresë zyrtare nga domain-i @diaspora.gov.al.
3. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës gëzojnë të drejtën e trajtimit me prioritet të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë nga ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Shqipërisë si dhe nga drejtuesit e misioneve diplomatike në vendet përkatëse, sa herë që është e domosdoshme për mbarëvajtjen e punës.
4. Përgjegjësitë profesionale të përdorimit të fondeve dhe ato administrative, për Këshillin, do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.
5. Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës shqiptare.



6. Shpenzimet për udhëtimin, akomodimin dhe dietat për realizimin e mbledhjeve zyrtare të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës mbulohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare për Diasporën, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe meporosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHETIT**

**PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**



**VENDIM**

**Nr. 67 dt. 13.2.2019**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME  
PËR ADMINISTRIMIN E LLOGARIVE, KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E TË  
ARDHURAVE, TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të Nenit 7 dhe Nenit 17 të ligjit Nr. 32/2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
2. FSHZHD administron llogaritë në përputhje me legjislacionin financiar të kontabilitetit dhe raportimit financiar të parashikuar për institucionet publike.
3. Për financimet nga donatorë të huaj do të zbatohen standardet e raportimit sipas parashikimeve në marrëveshjen e financimit.
4. Burimet e financimit të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës janë përcaktuar në pikën 1, neni 7 të ligjit nr.32/2018, "Për Fondin Shqiptar për zhvillimin e Diasporës"
5. Të ardhurat e FSHZHD-së janë të përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve të zbatuara nga FSHZHD-ja; fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave; individë e institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e veta dhe shërbimet e ofruara; kontributet materiale nga programet dy e shumëpalëshe, si dhe nga persona fizikë dhe organizata të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë aktivitetet filantropik si dhe burime të tjera, të lejuara e të njohura nga legjislacioni në fuqi.
6. FSHZHD mban Kontabilitetin në përputhje me specifikat e institucionit, i cili të mundësojë:



- a) lehtësimin e auditimit dhe raportimin e projekteve / programeve;
  - b) identifikimin e grupeve dhe nëngrupeve të kostos për të gjitha shpenzimet, me qëllim krahasimin fizik dhe monitorime të tjera;
  - c) paraqitjen e shpenzimeve, sipas kategorive të kostos, si mirëmbajtje, mallra, shërbime këshillimi, trajnime, kosto operative, etj;
  - d) paraqitjen e burimeve financiare sa herë që kërkohet;
  - e) regjistrimin e aktiveve, pasiveve dhe fondeve të akumuluarra të projektit në grupe të caktuara.
7. FSHZHD ka planin e vet të llogarive të emërtuar dhe kodifikuar sipas legjislacionit në fuqi, në funksion të regjistrimit të transaksioneve sipas llojit, kategorisë, burimit të financimit dhe destinacionit të përdorimit të fondeve të krijuara;
  8. Pasqyrimi në kontabilitet, illogarive bankare, bëhet në monedhën bazë dhe në kundra vleftën në Lekë ose Euro.
  9. Rimbushja e llogarive bëhet nga donatori nëpërmjet kërkesës për tërheqje fondesh.
  10. Llogaritë bankare, e përfituara sipas pikës 1/b, të nenit 7 të ligjit 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, “për fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave”, çelen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për fondet buxhetore.
  11. Llogaritë bankare, për të gjitha të ardhurat e tjera të krijuara sipas pikës 1 të nenit 7 të ligjit 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, çelen ngavetë FSHZHD, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligj.
  12. FSHZHD në përputhje me marrëveshjen e financimit, çel llogari bankare të veçantë, “Diaspora për Diasporën”.
  13. Fondet ekësaj llogarie do të përfitoohen nga donacione të anëtarëve të diasporës, për shpenzime me karakter ekonomik, social-kulturor, shkencor e shëndetësor,
  14. Të ardhurat e krijuara nga këto financime, do të administrohen nga FSHZHD, në përputhje me marrëveshjen e financimit, si dhe rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.



15. Përdorimi i të ardhurave përcaktohet në varësi të burimit të krijimit të tyre, si më poshtë: a) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, gërma “a”, dhe “c”, të Ligjit Nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, përdoren sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse.
  - a) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, gërma “b”, e Ligjit Nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, përdoren nëpërmjet sistemit të thesarit sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin buxhetor e financiar.
  - b) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, pikat “ç”, dhe pika “dh”, depozitohen llogarinë bankare të Fondit.
16. Shpenzimet për auditimin e jashtëm nga shoqëri apo ekspertë të pavarur, të kërkuar nga Donatorët sipas përcaktimeve në marrëveshjen e financimit, do të mbulohet nga vetë Donatori.

Ngarkohet Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 96, datë 16.7.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E SAMITIT TË  
DIASPORËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të vendimit nr.494 datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për Krijimin e komisionit shtetëror për organizimin e veprimtarive në kudër të "Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e Grupit të Punës, për Organizimin e Samitit II të Diasporës, që do të mbahet në Tiranë, në muajin nëntor 2018.
2. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë anëtarë:
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme;
  - Drejtorin e kabinetit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
  - Drejtorin e kabinetit të ministrit të Shtetit për Diasporën;
  - Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
  - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
  - Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit;
  - Komandantin e Gardës së Republikës.
3. Me ftesë të kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës mund të marrin pjesë në takime edhe ekspertë të tjerë nga brenda apo jashtë vendit, sipas nevojave që lidhen me fushën e veprimit të këtij urdhri.



4. Detyrat kryesore të grupit ndërinstitucional të punës të jenë hartimi i programeve, organizimi, drejtimi, bashkërendimi i punës, realizimi i veprimtarive, si edhe hartimi i projektakteve të nevojshme për organizimin e veprimtarisë dhe të efekteve financiare.
5. Projektaktet t'i përcillen Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të "Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit –Skënderbeut", për t'i propozuar në Këshillin e Ministrave.
6. Ngarkohen përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**LIGJ Nr. 115/2017**  
**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË**  
**KOMBËTARE TË DIASPORËS**





**LIGJ**  
**Nr. 115/2017**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti**

Ky ligj përcakton krijimin, misionin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Neni 2

**Misioni**

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet:

- a) Përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet;
- b) Ofritit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare;
- c) Nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- d) Bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

Neni 3

**Përkuftzime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



1. “Agjencia Kombëtare e Diasporës”, në vijim “Agjencia”, është organi shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën.
2. “Diaspora”, përfshin:
  - a) Komunitetet e hershme shqiptare në botë;
  - b) Çdo person i lindur në Shqipëri, që banon në mënyrë të përhershme jashtë kufijve të saj;
  - c) Çdo person, me origjinë shqiptare, i lindur dhe që banon në mënyrë të përhershme jashtë kufijve të Shqipërisë.
3. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë shtetërore për marrëdhëniet me diasporën.
4. “Vend i origjinës” është Republika e Shqipërisë.

#### Neni 4

### **Parimet e veprimtarisë**

Agjencia organizohet dhe funksionon në bazë të parimit të ligshmërisë, kushtetutshmërisë, të bashkëpunimit dhe të gjithëpërfshirjes.

## KREU II

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË

#### Neni 5

### **Organizimi i Agjencisë**

1. Agjencia është person juridik publik, në formën e agjencisë autonome, me seli në Tiranë, në kuptimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
2. Veprimtaria e Agjencisë është nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për diasporën.
3. Organet drejtuese të Agjencisë janë Këshilli Drejtues dhe drejtori ekzekutiv.
4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për diasporën.
5. Marrëdhëniet e punës për drejtorin ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas Kodit të Punës.



Neni 6

**Detyrat e Agjencisë**

Agjencia kryen këto detyra:

1. Merr masa për krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Zbaton politika dhe projekte që lidhen me diasporën.
3. Përgatit raporte periodike për veprimtarinë e Agjencisë, të cilat ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për diasporën.
4. Përgatit dhe koordinon punën për hartimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe ndjek zbatimin e saj.
5. Mban lidhjet ndërmjet diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës.
6. Përgjigjet për funksionimin dhe menaxhimin financiar të Agjencisë.
7. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë.
8. Ndihmon në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës.
9. Informon diasporën mbi proceset politike në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë.
10. Administron asetet që ka në dispozicion.

Neni 7

**Këshilli Drejtues**

1. Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Agjencisë.
2. Këshilli Drejtues është organ kolegjal, ipërbërë nga shtatë anëtarë, nga të cilët:
  - a) Një përfaqësues nga ministri përgjegjës për diasporën;
  - b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
  - c) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme;
  - d) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;
  - e) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
  - f) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturën;
  - g) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin.
3. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues është 4 vjet.



4. Ministri përgjegjës për diasporën emëron kryetar të Këshillit Drejtues njërin prej anëtarëve të tij.
5. Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregulla të hollësishme për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues.

#### Neni 8

### **Kompetencat e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues ka këto kompetenca:

- a) Miraton programet e zhvillimit të Agjencisë, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;
- b) Miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave të brendshme e të stafit administrativ e mbështetës;
- c) Ushtron kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- d) Propozon strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë;
- e) Miraton buxhetin, planin e veprimit, planin financiar, raportin vjetor dhe raporte të tjera të Agjencisë;
- f) Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

#### Neni 9

### **Drejtori ekzekutiv**

Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori ekzekutiv emërohet në detyrë nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil.

Drejtori ekzekutiv raporton në Këshillin Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë.

#### Neni 10

### **Burimet dhe mënyrat e financimit të Agjencisë**

1. Burimet financiare të Agjencisë, janë:
  - a) Të ardhura pjesërisht nga buxheti i shtetit;
  - b) Të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.
2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji dhe veprimtarisë përkatëse, Agjencia mund të ftojë subjekte të tjera, vendëse ose të huaja, për bashkëfinancim projektësh,



të cilat do të kontribuojnë në mbajtjen dhe forcimin e lidhjes ndërmjet vendit të originës dhe diasporës, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kriteret, procedura për akordimin e fondeve për bashkëfinancim të projekteve dhe mënyra e raportimit për zbatimin e tyre janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

### KREU III

#### KOMPETENCAT PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET VENDIT TË ORIGJINËS DHE DIASPORËS

##### Neni 11

#### **Politikat e vendit të originës për diasporën**

Këshilli i Ministrave përcakton politikat e vendit të originës për diasporën, për t'u zbatuar nga ministri përgjegjës, Agjencia dhe autoritete të tjera shtetërore, në përputhje me fushën e tyre të veprimtarisë.

##### Neni 12

#### **Ministri përgjegjës për diasporën**

Ministri përgjegjës për diasporën mbikëqyr veprimtarinë e Agjencisë, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

##### Neni 13

#### **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

1. Autoritetet shtetërore bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë për të pëmbushur detyrat e tyre në fushën e marrëdhënieve ndërmjet vendit të originës dhe diasporës.
2. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet raportimeve të përbashkëta dhe koordinimit të aktiviteteve, sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.



#### KREU IV DISPOZITA TË TJERA

##### Neni 14

##### **Strategjia Kombëtare për Diasporën**

1. Strategjia Kombëtare për Diasporën ka për qëllim ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, si dhe identifikon gjendjen aktuale të këtyre marrëdhënieve dhe veprimet që duhen ndërmarë për zhvillimin e tyre.
2. Strategjia miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës për të rishikuar në mënyrë periodike dokumentin e strategjisë.

##### Neni 15

##### **Vula dhe logoja e Agjencisë**

Agjencia ka vulën dhe logon e saj. Modeli i logos është sipas formatit të aneksit bashkëlidhur këtij ligji.

##### Neni 16

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 5, nenit 11, nenit 13, pika 2, dhe nenit 14, pika 2, të këtij ligji.
2. Ngarkohet Kryeministri për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 5, të këtij ligji.
3. Aktet nënligjore të parashikuara në këtë nen nxirren brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.



Neni 17  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
GRAMOZ RUÇI**

Miratuar në datën 18.12.2017



**AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS**



**VENDIM**

**Nr. 114, datë 23.2.2018**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR EMËRIMIN, SHKARKIMIN DHE SHPËRBLIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën, me propozim të ministrit përkatës, sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 2, të nenit 7, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.
2. Ministri përgjegjës për diasporën emëron kryetar të Këshillit Drejtues njërin nga anëtarët e tij.
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë drejtues të nivelit të lartë në ministri apo anëtarë të kabinetit të ministrit.
4. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Drejtues shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar:
  - a) Kur lirohet ose shkarkohet nga funksioni drejtues që ushtron në ministrinë që përfaqëson;
  - b) Me propozim të ministrit përkatës, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave, që ai kryen në ministri;
  - c) Kur neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Këshillit Drejtues.
5. Ministri përgjegjës për diasporën, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të mandatit 4-vjeçar ose menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon ministrisë së përfaqësuar në Këshillin Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës paraqitjen e emrit të kandidatatit për anëtar të këtij Këshilli.





6. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës shpërblehen sipas vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.
7. Ministrat përkatës dërgojnë propozimet për anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, brenda një afati 10-ditor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
8. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 1, datë 25.9.2018**

**PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES  
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të pikave 1 dhe 2, të vendimit nr. 114/2018, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin in shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”,

**URDHËROJ:**

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues, si më poshtë:
  - z. Etjen Xhafa, përfaqësues i Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme;
  - znj. Rovena Voda, përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme;
  - znj. Besa Shahini, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit;
  - z. Hajrulla Çeku, përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
  - znj. Esmeralda Hasani, përfaqësuese e ministrit të Shtetit për Diasporën;
  - znj. Suzana Stefa, përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
  - znj. Mimoza Hysa Çuliqi, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës.
2. Z. Etjen Xhafa, përfaqësues i Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, emërohet kryetar.
3. Ngarkohen kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR  
PANDELI MAJKO**



**URDHËR**

**Nr. 53, datë 16.03.2018**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË  
KOMBËTARE TË DIASPORËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

1. Struktura e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës të jetë, gjithsej, 15 veta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**LIGJ Nr. 32/2018**  
**PËR FONDIN SHQIPTAR PËR**  
**ZHVILLIMIN E DIASPORËS**



**LIGJ**  
**Nr. 32/2018**

**PËR FONDIN SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenëve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Objekti**

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Neni 2  
**Misioni**

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

Neni 3  
**Përkuftzime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Donacione" është ofrimi i fondeve, financimeve ose bazës materiale përmes një kontrate ose marrëveshjeje për të mbështetur përbushjen e misionit të projekteve të realizuara nga FSHZHD-ja.



- b) "Donator" janë të gjitha institucionet bankare dhe institucionet financiare jobankare, kombëtare dhe ndërkombëtare, publike apo private, që financojnë projekte zhvillimi për t'u zbatuar nga FSHZHD-ja.
- c) "Filantropi" është dhënia e kontributit për promovimin e mirëqenies, të zhvillimit social-ekonomik të diasporës.
- d) "FSHZHD" është Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
- e) "Manuali i procedurave" është manuali i procedurave drejtuese, administrative, financiare dhe teknike të FSHZHD-së.
- f) "Projekt" janë projektet ose programet e zhvillimit, që zbatohen nga FSHZHD-ja, të financuara nga donatorë të ndryshëm dhe/ose nga shteti.
- g) "Statuti" është akti që parashikon rregullimin e hollësishëm të organizimit, funksionimit dhe të veprimtarisë së FSHZHD-së.

#### Neni 4

#### **Statusi juridik**

1. FSHZHD-ja është person juridik publik.
2. FSHZHD-ja menaxhon projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave ose donatorët, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshje përkatëse.
3. Selia e FSHZHD-së përcaktohet në statutin e tij.

#### Neni 5

#### **Objektivat e veprimtarisë**

1. FSHZHD-ja shërben si mekanizëm i njohur nga ligji për nxitjen e prirjeve filantropike/ donacioneve dhe investimeve të anëtarëve të diasporës në përpjekjet për zhvillimin social-ekonomik e kulturor në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.
2. Në përmbushjen e misionit të saj, FSHZHD-ja udhëhiqet nga këta objektiva:
  - a) Mbështetjen e anëtarëve të diasporës për të mundësuar kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore, shëndetësore;
  - b) Forcimin e bashkëpunimit me organizata të tjera jofitimprurëse dhe organizata filantropike, të angazhuara në mënyrë aktive në zhvillimin social-ekonomik e kulturor.



Neni 6

**Kompetencat**

1. FSHZHD-ja ka për objekt të veprimtarisë hartimin, menaxhimin, financimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të lidhura me misionin e saj.
2. Kompetencat e FSHZHD-së, janë:
  - a) Menaxhimi i projekteve të financuara nga Këshilli i Ministrave dhe/ose donatorë të ndryshëm, që kanë si qëllim nxitjen dhe ndërmjetësimin e filantropisë;
  - b) Ndërmjetësimi idhënies dhe i mbështetjes financiare, nëpërmjet filantropisë, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike ekulturne në Shqipëri, si dhe në diasporë;
  - c) Kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve për nxitjen e filantropisë drejt projekteve me impakt zhvillimor në Republikën e Shqipërisë dhe pranë diasporës.
3. FSHZHD-ja bashkëpunon për ushtrimin e veprimtarisë së tij me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, që veprojnë në fusha apo sektorë të lidhur me zhvillimin e investimeve në Shqipëri dhe në diasporë.
4. FSHZHD-ja asiston krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dhoma e Biznesit të Diasporës ka logon e saj. Modeli i logos është sipas formatit të shtojcës bashkëlidhur këtij ligji.
5. FSHZHD-ja mund të kontraktojë me Këshillin e Ministrave, sipas marrëveshjeve përkatëse, për menaxhimin e projekteve të financuara prej tij dhe/ose nga donatorët, në përputhje me objektin e veprimtarisë së Fondit.

KREU II

**KAPITALI DHE BURIMET E FINANÇIMIT**

Neni 7

**Kapitali dhe burimet e financimit**

1. Të ardhurat në buxhetin e FSHZHD-së krijohen nga:
  - a) Fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve të zbatuara nga FSHZHD-ja;
  - b) Fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave, sipas parashikimeve të këtij ligji;



- c) Individë e institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse;
  - ç) Të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e veta dhe shërbimet e ofruara;
  - d) Kontributet materiale nga programet dy- e shumëpalëshe, si dhe nga persona fizikë dhe organizata të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë aktivitet filantropik;
- dh) Burime të tjera, të lejuara e të njohura nga legjislacioni në fuqi.
2. FSHZHD-ja i përdor të ardhurat e krijuara për financimin e veprimtarisë së tij, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar.
  3. FSHZHD-ja zbaton të gjitha rregullat e legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Rregullat dhe procedurat e hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### KREU III

#### STRUKTURA, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I FSHZHD-së

##### Neni 8

#### **Organet drejtuese**

Organet drejtuese të FSHZHD-së, janë:

- a) Këshilli Drejtues;
- b) Drejtori ekzekutiv.

##### Neni 9

#### **Përbërja e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i FSHZHD-së dhe përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:
  - a) 6 anëtarë, të cilët zgjidhen nga institucionet e administratës publike, sipas fushave përkatëse, në kuadër të projekteve që ka në zbatim FSHZHD-ja;
  - b) 1 anëtar, përfaqësues i diasporës, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës.
2. Kryetar i Këshillit Drejtues të FSHZHD-së zgjidhet njëri prej anëtarëve të Këshillit Drejtues.
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të FSHZHD-së emërohen e shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën.





4. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Drejtues është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
5. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues, për aq sa është e mundur, zbatohet legjislacioni në fuqi për barazinë gjinore.

Neni 10

**Detyrat e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli Drejtues ka këto detyra:
  - a) Miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë, si ato financiare, organizative dhe administrative të FSHZHD-së;
  - b) Miraton statutin dhe manualin e procedurave të FSHZHD-së me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve;
  - c) Miraton marrëveshjet e zbatimit dhe/ose të financimit të projekteve, si dhe aktivitetet e shërbimit, të cilat do të gjenerojnë të ardhura;
  - d) Emëron dhe shkarkon drejtorin ekzekutiv, në mbështetje të nenit 11 të këtij ligji;
  - e) Mbikëqyr administrimin dhe veprimtarinë e FSHZHD-së;
  - f) dh) Miraton strukturën organizative të FSHZHD-së;
  - g) Miraton kushtet dhe kriteret bazë të marrëdhënies të punësimit në FSHZHD dhe kategoritë e nivelin e pagave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për nivelin e pagave;
  - h) Miraton bilanci vjetor, raportet vjetore dhe raportet periodike të veprimtarisë së FSHZHD-së;
  - i) Miraton buxhetin vjetor të FSHZHD-së;
  - j) Analizon e miraton raportet e kontrolleve dhe të auditit, të kryera për veprimtarinë e FSHZHD-së;
  - k) Miraton rregulloren për funksionimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret për vendimmarrjen, kuorumin e nevojshëm etj.;
  - l) Merr vendime për çështje që lidhen me veprimtarinë e FSHZHD-së dhe miraton dokumentet e nevojshme për ecurinë e kësaj veprimtarie;
  - m) Raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse.
2. Këshilli Drejtues ka edhe një sekretar, i cili zgjidhet ndërmjet punonjësve të administratës së FSHZHD-së.
3. Mënyra dhe procedurat më të hollësishme të ushtrimit të kompetencave të Këshillit Drejtues përcaktohen në statutin, manualin e procedurave dhe në rregulloren e funksionimit të tij.



Neni 11

**Drejtori ekzekutiv**

1. Drejtori ekzekutiv:
  - a) Është autoriteti më i lartë ekzekutiv i FSHZH-së;
  - b) Përgjigjet përpara Këshillit Drejtues;
  - c) Emërohet me një shumicë prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues të FSHZH-së.
2. Drejtor ekzekutiv zgjidhet personi, që:
  - a) Është shtetas shqiptar;
  - b) Ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare;
  - c) Ka një përvojë pune jo më pak se 3 vjet në menaxhimin e projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm;
  - d) Zotëron një ose më shumë gjuhë të huaja.
3. Drejtori ekzekutiv zgjidhet për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rizgjedhje jo më shumë se një herë.
4. Drejtori ekzekutiv shkarkohet nga detyra përpara mbarimit të afatit, me një shumicë prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues të FSHZH-së, vetëm në rast se:
  - a) Dënohet nga gjykata, me vendim të formës së prerë, për një vepër penale;
  - b) Është në pamundësi fizike ose mendore për të ushtruar funksionet e ngarkuara, për një periudhë mbi gjashtë muaj;
  - c) Shkel rëndë rregullat e etikës së punës, të cilat përcaktohen nga Këshilli Drejtues në manualin e procedurave të FSHZH-së;
  - c) Nuk përmbush detyrat e caktuara, sipas nenit 12 të këtij ligji;
  - d) Jep dorëheqjen.

Neni 12

**Kompetencat e drejtorit ekzekutiv**

1. Drejtori ekzekutiv ushtron këto kompetenca:
  - a) Përfaqëson FSHZH-në në marrëdhënie me të tretët brenda dhe jashtë vendit;
  - b) Drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të FSHZH-së, ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe udhëzimet që rrjedhin nga statuti;
  - c) Administron burimet financiare të FSHZH-së, në përputhje me këtë ligj dhe statutin;
  - d) Nënshkruan marrëveshje me donatorë të ndryshëm;
  - e) Zgjedh dhe emëron personelin, në përputhje me Kodin e Punës;



- f) Kërkon thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme të Këshillit Drejtues;
  - g) Kryen të gjitha detyrat e tjera, që ingarkon ky ligj, statuti dhe manuali i procedurave të FSHZHD-së.
2. Mënyra dhe procedurat e ushtrimit të kompetencave të drejtorit ekzekutiv përcaktohen në statut dhe në manualin e procedurave të FSHZHD-së.

#### Neni 13

#### **Administrata e FSHZHD-së**

1. Veprimtaria e FSHZHD-së mbështetet nga një administratë, e cila funksionon në përputhje me statutin dhe manualin e procedurave të FSHZHD-së.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të kësaj administrate rregullohen sipas Kodit të Punës.

#### Neni 14

#### **Raportimi**

1. FSHZHD-ja raporton, për veprimtarinë vjetore e periodike të institucionit, pranë ministrisë përgjegjëse.
2. FSHZHD-ja raporton për fondet e mbledhura dhe mënyrën e shpenzimit të tyre pranë Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë, me kërkesë të tij.

#### Neni 15

#### **Konflikti i interesit**

Gjatë veprimtarisë së tyre, punonjësit e FSHZHD-së të zbatojnë rregullat për të parandaluar e shmangur konfliktin e interesave, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

### KREU IV

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 16

#### **Dispozita kalimtare**

1. Këshilli Drejtues dhe drejtori ekzekutiv i FSHZHD-së emërohen jo më vonë se 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.



2. Statuti dhe manuali i procedurave miratohen nga Këshilli Drejtues i FSHZHD-së jo më vonë se 3 muaj nga data e krijimit të këtij Këshilli.

Neni 17

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 7, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.6.2018

**KRYETARI  
GRAMOZ RUÇI**





**VENDIM**

**Nr. 594, datë 9.10.2018**

**PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES  
TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, si më poshtë vijon:
  - z. Elton Haxhi, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
  - znj. Teuta Vodo, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për drejtësinë;
  - z. Andris Stastoli, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
  - znj. Besa Shahini, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
  - z. Hajrulla Çeku, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin;
  - znj. Mimoza Hysa Çuliqi, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturën.
2. Emërimin e z. Elton Haxhi, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 611, datë 17.10.2018**

**PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “DIASPORA PËR ZHVILLIM” DHE ZBATIMIN  
E TIJ NGA FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Financimin nga buxheti i shtetit të projektit “Diaspora për zhvillim”, me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, me fond total prej 100 590 600 (njëqind milionë e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekësh, sipas projektit bashkëlidhur.
2. Fondi prej 100 590 600 (njëqind milionë e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekësh ndahet, si më poshtë vijon:
  - a) Për pjesën e mbetur të vitit 2018, të vihet në dispozicioni fondi prej 4 078 811 (katër milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë) lekësh;
  - b) Për vitin 2019, të vihet në dispozicioni fondi prej 44 901 844 (dyzet e katër milionë e nëntëqind e një mijë e tetëqind e dyzet e katër) lekësh;
  - c) Për vitin 2020, të vihet në dispozicioni fondi prej 32 367 559 (tridhjetë e dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh;
  - d) Për vitin 2021, të vihet në dispozicioni fondi prej 19 242 386 (nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh. Shuma e parashikuar në projekt për vitin 2018, prej 4 078 811 (katër milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga pakësimet e fondeve buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2018 dhe të papërdorura, për Agjencinë Kombëtare të Diasporës.
3. Për vitin 2019, të parashikohet si zë i veçantë në buxhetin e shtetit, për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, projekti “Diaspora për zhvillim”, me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, me vlerë prej 96 511 789 (nëntëdhjetë e



gjashtë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Ky projekt do të zbatohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
5. Fondi total, prej 100 590 600 (njëqind milionë e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekësh, të transferohet në formë granti, me përfitues Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në llogari bankare, në bankë të nivelit të dytë.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**VENDIM**  
**Nr. 67 dt. 13.2.2019**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME PËR  
ADMINISTRIMIN E LLOGARIVE, KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E TË  
ARDHURAVE, TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të Nenit 7 dhe Nenit 17 të ligjit Nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
2. FSHZHD administron llogaritë në përputhje me legjislacionin financiar të kontabilitetit dhe raportimit financiar të parashikuar për institucionet publike.
3. Për financimet nga donatorë të huaj do të zbatohen standardet e raportimit sipas parashikimeve në marrëveshjen e financimit.
4. Burimet e financimit të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës janë përcaktuar në pikën 1, neni 7 të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për zhvillimin e Diasporës”
5. Të ardhurat e FSHZHD-së janë të përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve të zbatuara nga FSHZHD-ja; fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave; individë e institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e veta dhe shërbimet e ofruara; kontributet materiale nga programet dy e shumëpalëshe, si dhe nga persona fizikë dhe organizata të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë aktivitet filantropik si dhe burime të tjera, të lejuara e të njohura nga legjislacioni në fuqi.
6. FSHZHD mban Kontabilitetin në përputhje me specifikat e institucionit, i cili të mundësojë:





- a) lehtësimin e auditimit dhe raportimin e projekteve / programeve;
  - b) identifikimin e grupeve dhe nëngrupeve të kostos për të gjitha shpenzimet, me qëllim krahasimin fizik dhe monitorim të tjera;
  - c) paraqitjen e shpenzimeve, sipas kategorive të kostos, si mirëmbajtje, mallra, shërbime këshillimi, trajnime, kosto operative, etj;
  - d) paraqitjen e burimeve financiare sa herë që kërkohet;
  - e) regjistrimin e aktiveve, pasiveve dhe fondeve të akumuluarra të projektit në grupe të caktuara.
1. FSHZHD ka planin e vet të llogarive të emërtuar dhe kodifikuar sipas legjislacionit në fuqi, në funksion të regjistrimit të transaksioneve sipas llojit, kategorisë, burimit të financimit dhe destinacionit të përdorimit të fondeve të krijuara;
  2. Pasqyrimi në kontabilitet, illogarive bankare, bëhet në monedhën bazë dhe në kundra vleftën në Lekë ose Euro.
  3. Rimbushja e llogarive bëhet nga donatori nëpërmjet kërkesës për tërheqje fondesh.
  4. Llogaritë bankare, e përfituara sipas pikës 1/b, të nenit 7 të ligjit 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, “për fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave”, çelen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për fondet buxhetore.
  5. Llogaritë bankare, për të gjitha të ardhurat e tjera të krijuara sipas pikës 1 të nenit 7 të ligjit 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, çelen nga vetë FSHZHD, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligj.
  6. FSHZHD në përputhje me marrëveshjen e financimit, çel llogari bankare të veçantë, “Diaspora për Diasporën”.
  7. Fondet ekësaj llogarie do të përfitohen nga donacione të anëtarëve të diasporës, për shpenzime me karakter ekonomik, social-kulturor, shkencor e shëndetësor,
  8. Të ardhurat e krijuara nga këto financime, do të administrohen nga FSHZHD, në përputhje me marrëveshjen e financimit, si dhe rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.



9. Përdorimi i të ardhurave përcaktohet në varësi të burimit të krijimit të tyre, si më poshtë:
  - a) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, gërma “a”, dhe “c”, të ligjit Nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, përdoren sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse.
  - b) të ardhurat ekrijuara sipas nenit 7, gërma “b”, eligjit Nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, përdoren nëpërmjet sistemit të thesarit sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin buxhetore financiar.
  - c) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, pikat “ç”, dhe pika “dh”, depozitohen llogarinë bankare të Fondit.
10. Shpenzimet për auditimin e jashtëm nga shoqëri apo ekspertë të pavarur, të kërkuar nga Donatorët sipas përcaktimeve në marrëveshjen e financimit, do të mbulohej nga vetë Donatori.

Ngarkohet Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**VENDIM**

**Nr. 321, datë 15. 05. 2019**

**PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “DIASPORA SHKENCORE SI NJË FAKTOR  
NDRYSHIMI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË SHQIPËRISË” DHE  
ZBATIMIN E TIJ NGA FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, tënenit 13, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë” , me kohëzgjatje 30 (tridhjetë) muaj, me fond total prej 40, 984,477 (dyzet milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për vitin 2019 për kryerjen e studimit të projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë”, Fondit
3. Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës i shtohet fondi prej 4,214,895 (Katër milion e dyqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.
4. Fondi i parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019.
5. Fondet për vitet 2020 dhe 2021 për projektin bashkëlidhur këtij vendimi, parashikohen në planin buxhetor afatmesëm të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitet 2020-2022.
6. Projekti “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë” , bashkëlidhur këtij vendimi , do të zbatohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.



7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë , ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe meporosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHETIT**

**PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**



**VENDIM**

**Nr. 514, datë 19.7.2019**

**PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PËR DHOMËN E BIZNESIT TË DIASPORËS  
- KRIJIMI DHE Nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, DHE  
ZBATIMIN E TIJ NGA FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të neneve 6, pika 4 dhe 7, pika 1 shkronja “b”, të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, mepropozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Financimin e projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, me kohëzgjatje 28 (njëzetë e tetë) muaj, me fond prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh, sipas projektit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për vitin 2019, me qëllim krijimin dhe organizimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si mekanizëm për mbrojtjen dhe nxitjen e bizneseve të diasporës shqiptare, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës i shtohet fondi prej 3 (tre milionë) lekësh i cili përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit
3. Fondet shtesë për projektin bashkëlidhur këtij vendimi do të sigurohen nga donatorë si dhe nga të ardhurat e përfituara nga aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga Dhoma e Biznesit të Diasporës.
4. Projekti “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, bashkëlidhur këtij vendimi, do të zbatohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.



5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**

**MINISTRI I SHTETIT**  
**PËR DIASPORËN**  
**PANDELI MAJKO**



**VENDIM**  
**Nr. 746 datë 20.11.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 08.04.2015 TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar në 24 shkurt 2014, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Nënndarja “i”, e shkronjës “a”, të pikës 5, ndryshohet, si mëposhtë vijon:  
“i. institucione shtetërore, 4 anëtarë:
  - ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
  - Banka e Shqipërisë;
  - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
  - Fondi Shqiptar Për Zhvillimin e Diasporës.
2. Nënndarja “iii”, e shkronjës “a”, të pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“iii. Dhoma të Tregtisë dhe Industrisë, 3 anëtarë:
  - Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
  - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë;
  - Dhoma e Biznesit të Diasporës.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**  
**Në mungesë dhe meporosi**  
**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHTETIT**  
**PËR DIASPORËN**  
**PANDELI MAJKO**

**V.K.M Nr. 259, datë 09.05.2018**  
**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË**  
**KOMBËTARE PËR DIASPORËN**  
**2018-2024 DHE TË PLANIT TË**  
**VEPRIMIT**





**VENDIM**  
**Nr. 259, datë 9.5.2018**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018-2024**  
**DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të Planit të Veprimit të saj, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe të gjitha institucionet e përmendura në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**  
**Nr. 96, datë 16.7.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E SAMITIT TË  
DIASPORËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të vendimit nr.494 datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për Krijimin e komisionit shtetëror për organizimin e veprimtarive në kudër të "Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e Grupit të Punës, për Organizimin e Samitit II të Diasporës, që do të mbahet në Tiranë, në muajin nëntor 2018.
2. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë anëtarë:
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
  - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme;
  - Drejtorin e kabinetit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
  - Drejtorin e kabinetit të ministrit të Shtetit për Diasporën;
  - Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
  - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
  - Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit;
  - Komandantin e Gardës së Republikës.
3. Me ftesë të kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës mund të marrin pjesë në takime edhe ekspertë të tjerë nga brenda apo jashtë vendit, sipas nevojave që lidhen me fushën e veprimit të këtij urdhri.



4. Detyrat kryesore të grupit ndërinstitucional të punës të jenë hartimi i programeve, organizimi, drejtimi, bashkërendimi i punës, realizimi i veprimtarive, si edhe hartimi i projektakteve të nevojshme për organizimin e veprimtarisë dhe të efekteve financiare.
5. Projektaktet t'i përcillen Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të "Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit –Skënderbeut", për t'i propozuar në Këshillin e Ministrave.
6. Ngarkohen përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 98, datë 16.7.2018**

**PËR PËRCAKTIMIN E GRUPIT TË KOORDINATORËVE PËR ZBATIMIN PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018–2024**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe Planit të Veprimit”,

**URDHËROJ:**

1. Përcaktimin e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024, të miratuar me VKM-në nr. 259, datë 9.5.2018, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe Planit të Veprimit”.
2. Grupi i Koordinatorëve të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën.
3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit të përfaqësohen në nivel zëvendësministri, si edhe nga 2 (dy) përfaqësues të tjerë, specialistë të fushës dhe të jenë, si më poshtë vijon:
  - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
  - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - Ministria e Kulturës;
  - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
  - Ministria e Brendshëm;
  - Ministria e Drejtësisë;
  - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të përfaqësohet nga drejtori i Kabinetit. Akademia e Shkencave, INSTAT-i, si edhe Agjencia Kombëtare për Diasporën do të përfaqësohen nga titullarët e vet.

4. Koordinatorët janë përgjegjës për bashkërendimin e punës për zbatimin e masave të Planit të Veprimit në institucionin të cilin përfaqësojnë.



5. Grupi i Koordinatorëve ka për detyrë:
  - a) Ndjekjen dhe zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024.
  - b) Përcaktimin e detajimin e kostove dhe të indikatorëve për të gjitha masat e parashikuara në Planin e Veprimit.
6. Koordinatorët të mbledhen jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë është e nevojshme, me njoftim të kryetarit.
7. Në mbledhjet e grupit të koordinatorëve mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të strukturave të tjera, si: organizata jofitimprurëse, organizmat ndërkombëtarë, universitetet dhe personalitete të fushës.
8. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij urdhri, që brenda 5 (pesë) ditësh nga hyrja në fuqi etij, të caktojnë përfaqësuesit e tyre.
9. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT-i, Akademia e Shkencave, Agjencia Kombëtare për Diasporën, për ndjekjen e zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 135, datë 13.9.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN  
E MASËS 64 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR  
DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të Planit të Veprimit",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 64 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
  - ministri përgjegjës për diasporën: kryetar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për financat: anëtar;
  - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën: anëtar.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të kryejë vlerësimin për numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit, për fushat ku ata specializohen dhe të konsiderojë përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri për studentët të cilët marrin bursa studimi për jashtë vendit, si dhe organizimin e informacionit e të mundësive për punësimin e tyre në vendlindje.
4. Grupi ndërinstitucional i punës të mbledhet çdo 3 (tre) muaj dhe të raportojë me shkrim në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën.



5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 136, datë 13.9.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN  
E MASËS 51 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR  
DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të Planit të Veprimit",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 51 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
  - ministri përgjegjës për diasporën: kryetar;
  - ministri përgjegjës për punët e jashtme: anëtar;
  - ministri përgjegjës për financat: anëtar;
  - ministri përgjegjës për arsimin: anëtar;
  - ministri përgjegjës për kulturën: anëtar;
  - ministri përgjegjës për turizmin: anëtar;
  - ministri përgjegjës për punët e brendshme: anëtar;
  - ministri përgjegjës për drejtësinë: anëtar;
  - ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale: anëtar;
  - ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural: anëtar;
  - ministri përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes: anëtar;
  - titullari i Akademisë së Shkencave: anëtar;
  - titullari i INSTAT-it: anëtar;
  - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën: anëtar;
  - titullari i AKSHI-t: anëtar.
3. Titullari i AKSH-it, titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, si edhe anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës të realizojnë takime periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin e faqeve të informacionit të institucioneve.





4. Ngarkohet titullari i AKSH-it që, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të përcaktojë koordinatorët për çdo institucion përgjegjës.
5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Akademia e Shkencave, INSTAT-i, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 137, datë 13.9.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN  
E MASËS 15 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR  
DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të Planit të Veprimit",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 15 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
  - Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it: kryetar;
  - përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për diasporën: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin: anëtar;
  - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën: anëtar.
3. Instituti i Statistikave, në përputhje me masën 15 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë urdhër, të hartojë raportin vjetor statistikor për diasporën shqiptare, ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën.
4. Struktura e raportit vjetor të INSTAT-it për diasporën shqiptare të realizohet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Diasporën.



5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**URDHËR**

**Nr. 138, datë 13.9.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN E MASAVE 2 DHE 45 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të Planit të Veprimit",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masave 2 dhe 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
  - ministri përgjegjës për diasporën: kryetar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për kulturën: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për turizmin: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për financat: anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën: anëtar;
  - përfaqësues i ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes: anëtar;
  - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën: anëtar.
3. Ministri përgjegjës për diasporën të përcaktojë Programin Kombëtar Vjetor për aktivitetet e përbashkëta në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, si dhe të aktiviteteve periodike për turizmin shqiptar dhe mundësitë lidhur me investime në Shqipëri.
4. Programi vjetor për aktivitetet e përbashkëta për diasporën (aktivitetet që përfshijnë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) të propozohet dhe miratohet në Komitetin Shtetëror për Diasporën.



5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**



**VENDIM**  
**Nr. 601, datë 4.9.2019**

**PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR  
ARBËRESHËT**

Nëmbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 13, të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, në vijim “QSPA”, si person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën.
2. Misioni i QSPA-së është kryerja e studimeve të specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh.
3. Burimet e financimit të QSPA-së janë:
  - a) buxheti i shtetit;
  - b) donacionet;
  - c) të ardhura të tjera, të ligjshme

**II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS SË STUDIMEVE DHE  
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT**

1. QSPA-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e qendrës dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për diasporën. Ai emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën.
2. Marrëdhëniet e punës së titullarit, nëpunësve dhe punonjësve të QSPA-së rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.



3. QSPA-ja kryen detyrat dhe funksionet, si më poshtë vijon:
  - a) Kryen studime për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh
  - b) Boton studimet në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - c) Promovon ruajtjen e gjuhës dhe të identitetit kulturor të komunitetit arbëresh;
  - d) Organizon aktivitete, seminare dhe konferenca shkencore me fokus komunitetin arbëresh.
  
4. Pranë QSPA-së funksionon Këshilli Koordinues, si organ këshillimor, për:
  - a) projektet e studimeve e të publikimeve të QSPA-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën si dhe me programet kërkimore-shkencore;
  - b) përcaktimin e planit të aktiviteteve dhe çdo lloj organizimi tjetër, me specialistë të fushës, që ofrojnë ekspertizë të specializuar në zbatim të fushës së përgjegjësisë së QSPA-së.
  
5. Këshilli Koordinues i QSPA-së është organ kolegjial, i përbërë nga anëtarë, icili ka përfaqësues nga:
  - a) Akademia e Shkencave;
  - b) Akademia e Studimeve Albanologjike;
  - c) Ministria përgjegjëse për politikën e jashtme;
  - d) Ministria përgjegjëse për kulturën;
  - e) Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës;
  - f) Agjencia Kombëtare e Diasporës;
  - g) Tre përfaqësues të komunitetit Arbëresh, njëri prej të cilëve nga komuna e Zarës, në Kroaci.
  
6. Mandati i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Studimeve të QSPA-së është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
  
7. Anëtarët e Këshillit Koordinues të QSPA-së duhet të jenë drejtues të nivelit të lartë të institucioneve të përfaqësuara, të cilët emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën, me propozim të titullarit të institucionit përkatës. Përfaqësuesit e komuniteteve të arbëreshëve jashtë vendit propozohen nga ambasadorët e akredituar në vendet që kanë komunitete të arbëreshëve. Ministri përgjegjës për diasporën cakton njërin nga anëtarët si kryetar të këtij këshilli.



8. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Koordinues të QSPA-së shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar:
  - a) kur lirohet ose shkarkohet nga funksioni drejtues, që ushtronte në institucionin që përfaqëson;
  - b) me propozim të titullarit të institucionit të përfaqësuar, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave që ai kryen në atë institucion;
  - c) kur neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen erregullt në mbledhjet e Këshillit Koordinues.
9. Ministri përgjegjës për diasporën, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të mandatit 4-vjeçar ose menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon institucionit të përfaqësuar në Këshillin e Koordinimit paraqitjen e emrit të kandidatit për anëtar të këtij këshilli.
10. Struktura dhe organika e QSPA-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
11. Rregullorja e brendshme e punës e QSPA-së miratohen nga ministri përgjegjës për diasporën, pas propozimit të drejtorit të saj.
12. QSPA-ja ka stemën dhe logon e saj zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë”, “Ministri Shtetit për Diasporën”, “Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë. Logoja e QSPA-së, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi, vendoset në çdo publikim dhe studim të këtij institucioni.
13. Vula e QSPA-së ka formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme,





Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (Universiteti i Tiranës) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në “Fletoren Zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2020.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**



**LIGJ**  
**Nr. 38/2019**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015**  
**“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 29 shtohet neni 29/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 29/1

**Funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- a) krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;
- c) dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare;
- d) dhënien e ndihmës e të informacionit për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve;



- e) koordinimin e bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.”

Neni 2

Në nenin 44, fjalët “31 mars” zëvendësohen me fjalët “31 maj”.

Neni 3

Në nenin 54 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:  
“e) miraton tjetërsimin e pronave të tretëve”.
2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “e/1 me këtë përmbajtje:  
“e/1) miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private”.

Neni 4

Në nenin 55 pika 3, pas referencës në shkronjën “d” shtohet referenca në shkronjën “e/1”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
GRAMOZ RUÇI**

Miratuar në datën 20.6.2019



**VENDIM**

**Nr.400, datë 19.6.2019**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN DHE TË  
PLANIT TË VEPRIMIT 2019-2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm,  
Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të planit të veprimit 2019-2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen të gjitha ministratë e linjës dhe institucionet qendrore, për të cilat në Strategji dhe në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe meporosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**SANDËR LLESHAJ**

**REZOLUTË**

**“PËR REFORMËN E POLITIKËS  
SHTETËRORE PËR DIASPORËN”**

**Datë 23.07.2019**



## REZOLUTË PËR REFORMËN E POLITIKËS SHQIPTARE PËR DIASPORËN

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar hapat e hedhur në ndërtimin e strukturave të politikës shtetërore për diasporën;
- Duke vlerësuar reformën legislative kushtuar komuniteteve shqiptare jashtë vendit dhe konkretisht miratimin brenda një periudhe të shkurtër të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe ligjit nr. 32/2018, “Për Fondin e Zhvillimit të Diasporës”;
- Duke konsideruar veprimtarinë shtetërore në këtë fushë si të një rëndësie të veçantë, e cila lidh përgjegjësitë e shtetit shqiptar me statusin ligjor të shtetasve dhe bashkëkombësve tanë jashtë vendit;
- Duke vlerësuar bashkëpunimin me shtetin e Kosovës dhe vendeve të tjera fqinje, në këtë drejtim të rëndësishëm dhe strategjik për të ardhmen, si pjesë e procesit të integritimit evropian të rajonit;
- Duke i konsideruar të rëndësishme propozimet e Nënkomisionit për Diasporën në lidhje me:
  - Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 nga Këshilli i Ministrave si një dokument kyç për veprimin dhe aplikimin e politikave të reja të institucioneve shtetërore në këtë fushë të veprimtarisë shtetërore.
  - Nisjen sa më shpejt të funksionimit të institucioneve të krijuara nga legjislacioni i ri i miratuar për këtë qëllim.
  - Bashkëpunimin institucional, në mënyrë të veçantë, me shtetin e Kosovës për të përcaktuar një politikë të qëndrueshme dhe afatgjatë në funksion të interesave të komuniteteve shqiptare aty ku ata jetojnë, në vendet pritëse.
  - Punën paraprake të Komisionit të Reformës Zgjedhore, në programin e diskutimit të së cilit një nga çështjet për t’u diskutuar dhe vendosur është dhënia e së drejtës së votës shtetasve shqiptarë, të cilët banojnë jashtë vendit.
  - Vendimin e Këshillit të Ministrave që me rastin e vitit të Gjergj Kastrioti Skënderbeut të organizohet në Tiranë aktiviteti i Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare.

Duke vërejtur dhe vlerësuar, se:

- Në vitin 2017–2018, në kryesinë e Kuvendit janë organizuar disa aktivitete në funksion të interesave të diasporës dhe migracionit. Këto takime publike kanë qenë një rast për ta bërë të ndjeshme edhe më shumë për nivele të ndryshme të politikës dhe administratës garantimin e të drejtave kushtetuese të diasporës dhe migracionit.



- Krijimi i një kanali televiziv “TVSH 3” nga Radio Televizioni Publik i Shqipërisë në zbatim të ligjit “Për diasporën” është një hap i rëndësishëm për forcimin e komunikimit me bashkëkombësit jashtë vendit.
- Fillimi i punës nga Muzeu Kombëtar, në bazë të ligjit të ri “Për diasporën”, për hapësirën brenda tij kushtuar historikut të diasporës shqiptare, është një detyrim ligjor dhe moral ndaj shtresës së shoqërisë shqiptare që e ka ndihmuar vendin nga distanca e mërgimit. Shembujt e kësaj ndihme vlejné edhe sot në kushtet e një shoqërie globale, ku ruajtja e identitetit është detyrë dhe sfidë shtetërore.
- Miratimi nga ministritë përgjegjëse të arsimit të Shqipërisë dhe të Kosovës i “curriculumave” të arsimit në diasporë është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit kulturor e arsimor shqiptar në diasporë. Kjo punë e nisur duhet të përfundojë me realizimin e librave mësimorë të nevojshëm për brezin e ri të shqiptarëve të mërguar.
- Organizimet kulturore në diasporë kanë filluar të kenë një rol të dorës së parë në ruajtjen e identitetit jashtë vendit. Ngritja e qendrave të kulturës në diasporë, sipas legjislacionit të ri dhe në bashkëpunim me shtetin e Kosovës, në funksion të marrëveshjeve bilaterale midis dy shteteve, do të ndihmojnë në krijimin e një programi kulturor të përbashkët për bashkëkombësit dhe brezat e rinj në diasporë.
- Ministria për Evropën dhe Politikën e Jashtme ka ndërmarrë veprime të rëndësishme në fushën e shërbimeve konsullore për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Shërbimet on-line kanë lehtësuar dhe shkurtuar procedurat burokratike në shërbimet konsullore. Kjo ministri ka firmosur dhe po negocion marrëveshje të rëndësishme për cilësinë e jetës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit, siç janë ato në fushën e sigurimeve.
- Krijimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në zbatim të legjislacionit të ri për diasporën, është hap i rëndësishëm në ruajtjen e identitetit dhe arsimit për shqiptarët e rinj larg vendlindjes. Kjo qendër do të shërbejë si një cilësi e re në fushën e publikimeve dhe shpërndarjes së librit për diasporën.
- Për shtetasit që janë larguar nga vendi ekziston një numër i ulët botimesh on-line, në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim kërkohet një bashkëpunim institucional të ministrive përgjegjëse të arsimit, kulturës dhe diasporës për të gjetur zgjidhjet dhe krijuar rezultatet.
- Marrëdhënia e Shqipërisë me diasporën po ndjen nevojën e bashkëpunimit me inteligjencën dhe fuqinë punëtore të kualifikuar jashtë vendit.
- Përfshirja e diasporës në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë është një sfidë administrative. Fillimi i punës për krijimin e Dhomës së Biznesit për Diasporën është një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur.



Kërkon:

- Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin krijuar me vendimin nr. 98/2017 të Kuvendit të Shqipërisë si tregues i vëmendjes në rritje që Kuvendi, si institucioni më i lartë i vendit, i ka dedikuar kësaj çështjeje, të ketë rol aktiv në ndjekjen e zbatimit të kuadrit ligjor për diasporën dhe të jetë një interlokutor, në emër të Kuvendit, për verifikimin dhe informimin me ecurinë e reformës në fushat të cilat ai mbulon.
- Angazhimin në vazhdimësi nga institucionet dhe agjencitë përgjegjëse të administratës në vlerësimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018–2024.
- Zgjidhjen e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit me mekanizma ligjorë nga Komisioni i Reformës Zgjedhore, duke u bazuar në modelet enjohura perëndimore, në bashkëpunim me OSBE-ODIHR-in.
- Bërjen funksionale në bazë të legjislacionit të miratuar, të organizimit institucional dhe strukturave shtetërore për diasporën, brenda vitit 2018.
- Koordinimin me institucionet përgjegjëse në fushën e diasporës të shtetit të Kosovës për hedhjen e hapave të përbashkët, në një marrëdhënie ku është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi me shtetet e tjera fqinje dhe rajon.
- Krijimi i një programi të veçantë nga ministritë përgjegjëse për arsimin, kulturën dhe diasporën për botimet on-line në fushën e arsimit dhe librit shqip, për të cilin komisionet përgjegjëse në Kuvendin e Shqipërisë të kërkojnë informacion periodik për fazat e realizimit të tij.
- Nxitjen e organeve të vetëqeverisjes vendore për të mundësuar aksesin e diasporës, me qëllim shkurtimin e “distancave” administrative me shtresën popullsisë që nuk jeton brenda vendit.
- Paraqitjen dhe/ose ndërmarrrjen e nismave të nevojshme nga organet kompetente për rishikimin e ligjit “Për shtetësinë” dhe kuadrit ligjor përkatës për t’iu përgjigjur shqetësimeve të shtetasve shqiptarë jashtë vendit dhe fenomenit të “pashetësisë”, të ngritur nga struktura përgjegjëse e OKB-së për këtë çështje, zyra e UNCHR-së në Tiranë.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson si të nevojshme diskutimin dhe vlerësimin periodik të çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën dhe interesat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Ai konsideron se në kushtet e reja sociale dhe procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, dallimet e shtetasve, të cilët jetojnë “jashtë” dhe “brenda” vendit, janë ngushtuar. Ato kërkojnë përgjigje ligjore dhe administrative të duhura.





Diaspora është pasuria kombëtare e Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë është i përkushtuar që kjo të kthehet në një realitet të prekshëm nga qytetarët që kanë votuar apo që do të votojnë nesër për të ardhmen e përbashkët.

Miratuar në datën 23.7.2018



**MARRËVESHJE DHE  
MEMORANDUME**



## MARRËVESHJE

### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E DIASPORËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (këtej e tutje referuar si “Palët”),

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar më tej marrëveshjet dypalëshe ekzistuese mes dy vendeve, në fushën e diasporës.

Të inkurajuar nga vullneti i përbashkët për të promovuar bashkëpunimin mes vendeve të tyre në fushën e diasporës, për: ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor dhe arsimor; përmirësimin e gjendjes së tyre sociale në vendet pritëse; realizimin e të drejtave të tyre politike në atdhe; si dhe përfshirjen e tyre në zhvillimet ekonomike dhe sociale të tij.

Të bindur që bashkëpunimi i tyre në fushën e diasporës është një instrument me vlera dhe përfitime për të dyja shtetet, si edhe për diasporën shqiptare në botë,

kanë rënë dakord si vijon:

#### Neni 1

Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunim në fushën e diasporës mes dy vendeve mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.

Ky bashkëpunim do të përfshijë:

1. Fushën e mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e mërgatës shqiptare; mbështetjen e aktiviteteve dhe projekteve kulturore-artistike për promovimin e kulturës shqiptare dhe forcimin e identitetit kombëtar në vendet pritëse, por edhe të originës;
2. Lidhjen e marrëveshjeve të reja të njohjes së kontributeve shoqërore dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore;
3. Identifikimin dhe hartografin e mërgatës shqiptare, me qëllim realizimin e së drejtës së tyre për të votuar nga vendet ku jetojnë për zgjedhjet parlamentare dhe lokale në atdhe;



4. Realizimin e projekteve dhe iniciativave të cilat synojnë përfshirjen aktive të mërgatës shqiptare në zhvillimin ekonomik dhe social të atdheut.

#### Neni 2

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve në fushën e diasporës.

#### Neni 3

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt në mes institucioneve përgjegjëse të diasporës të vendeve, e cila do të realizohet përmes shkëmbimit të vizitave të drejtuesve dhe ekspertëve në fushat e përmendura, si dhe përmes konferencave apo aktiviteteve të përbashkëta.

Palët bien dakord që të caktojnë pika kontakti, në këtë drejtim.

#### Neni 4

Sipas mundësive, Palët bien dakord që të punojnë së bashku menjë plan të përbashkët veprimi në fushën e diasporës.

#### Neni 5

Palët angazhohen të ngrenë qendra të përbashkëta kulturore për diasporën shqiptare kudo që do të vlerësojnë se është e nevojshme për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar.

#### Neni 6

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt të institucioneve përgjegjëse që përfshijnë koordinimin për arsimimin, regjistrimin, organizimin dhe mbrojtjen e përbashkët e të drejtave të të gjithë shqiptarëve të cilët janë larguar nga vendlindja e tyre.

#### Neni 7

Palët do të mbështesin bashkëpunimin e institucioneve të tyre brenda kornizës së parimeve të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara.



#### Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e palëve, që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkom-bëtare të cilat janë detyruese për palët.

#### Neni 9

Palët janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit, të cilat nuk janë specifikuar në të, por janë në përputhje me objektivat e saj.

#### Neni 10

1. Me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshje, do të krijohet një Komision i përbashkët (këtu e tutje referuar si “Komisioni”), i përbërë nga përfaqësuesit, si më poshtë:
  - a) Një përfaqësues i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, i Republikës së Shqipërisë;
  - b) Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, i Republikës së Shqipërisë;
  - c) Një përfaqësues i institucioneve përgjegjëse për diasporën, i Republikës së Shqipërisë;
  - d) Një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i Republikës së Kosovës;
  - e) Një përfaqësues i Ministrisë së Financave, i Republikës së Kosovës;
  - f) Një përfaqësues i institucioneve përgjegjëse për diasporën, i Republikës së Kosovës.
2. Komisioni do të takohet periodikisht në Tiranë dhe Prishtinë, ndërsa datat e takimit do të dakordohen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Komisioni do të përgatisë programet periodike të bashkëpunimit, të cilat do të përcaktojnë detajet dhe kushtet e bashkëpunimit, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe do të vlerësojnë dhe monitorojnë zbatimin e saj, si dhe do të vendosë për rekomandimet e duhura me qëllim të zbatimit efektiv të saj.

#### Neni 11

Palët bien dakord që sipas rastit, të bashkëpunojnë për realizimin financiar sa më lart të angazhimeve të tyre të përbashkëta, me një frymë konstruktive dhe dialoguese.



Neni 12

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se kanë përbushur procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh dhe automatikisht do të ripërtërihet për një periudhë pasuese prej 5 (pesë) vitesh, vetëm nëse asnjëra nga Palët nuk njofton dëshirën e saj për të përfunduar me shkrim, përmes kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, marrëveshja do të përfundojë 6 (gjash të) muaj nga data kur Pala tjetër ka marrë këtë njoftim.

Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të zbatohen për çdo marrëveshje të programit të këmbimit, ose projekt të iniciuar sipas kësaj Marrëveshjeje që është ende në zhvillim e sipër, deri në përfundimin e tyre, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, nëpërmjet shkëmbimit të notave. Ndryshimi do të hyjë në fuqi, në datën kur njoftohet dhënia e pëlqimit nga Pala tjetër.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Korçë, më 27.11.2017, në dy kopje origjinale secila në gjuhën shqipe.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**

**PËR QEVERINË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**KRYEMINISTRI  
RAMUND HARADINAJ**



---

---

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR QENDRAT KULTURORE NË**  
**DIASPORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të referuara si “Palët”),

Me dëshirën, për të forcuar dhe zgjeruar marrëdhëniet ndërkulturore ndërmjet Palëve dhe komunitetit shqiptar jashtë vendit;

Të motivuar nga dëshira e përbashkët, në promovimin dhe mbrojtjen e identitetit kulturor e historik, si dhe vlerave të përbashkëta në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe fushat e tjera që ndërlidhjen drejt për drejt me komunitetin shqiptar jashtë vendit.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes është të zhvillojë dhe mbështesë bashkëpunimin kulturor dhe ruajtjen e identitetit përmes një rrjeti qendrash kulturore në bashkërendim dhe dakordësi mes palëve.

Neni 2

Palët pajtohen fillimisht të shfrytëzojnë dhe fuqizojnë qendrat ekzistuese që tashmë gjenden në diasporë.

Neni 3

Palët do të rrisin bashkëpunimin mes institucioneve përkatëse kulturore, arsimore dhe shoqatave e individëve në diasporë dhe do të ofrojnë ndihmën e tyre në menaxhimin e qendrave të përbashkëta.

Neni 4

Palët do të ndajnë në masë të barabartë çdo angazhim financiar dhe pronësi në qendrat e kulturës në diasporë.



#### Neni 5

Palët do të përkushtohen për të mbështetur bashkëpunimin mbi veprimtaritë e trashëgiminë e kulturore, aktivitetet muzeore, galerive, folklorit dhe aktiviteteve që ndërlidhen, por nuk kufizohen me këtë fushë të veprimit dhe interesat e komunitetit në diasporë, si dhe shtetet pritëse.

#### Neni 6

Palët në këtë marrëveshje do të mbështesin dhe rrisin bashkëpunimin përmes:

1. Shkëmbimit të përvojave dhe realizimit të politikave zhvillimore në përputhje me legjislacionin e brendshëm të vendeve dhe standardet e aplikueshme ndërkombëtare;
2. Realizimit të projekteve të përbashkëta në të gjitha disiplinat e arsimit dhe kulturës, duke përfshirë seminare dhe trajnime për aktivitete të ndryshme, siç janë: trashëgimia kulturore, artet vizuale, teatri, kinematografi, muzikë, biblioteka etj.;
3. Shkëmbimit të informacionit, ndihma reciproke teknike dhe materiale në fushën e botimit, literaturës dhe aktivitetet e tjera artistiko-gjuhësore;
4. Organizimit të programeve të përbashkëta të bashkëpunimit mes institucioneve të arsimit, kulturës dhe artit (filarmonisë, operës, baletit, teatrit, ansambleve tradicionale të këngëve dhe valleve etj.) dhe shoqatave të tjera muzikore në funksionimin e qendrave të kulturës në diasporë;
5. Koordinim vjetor të bibliotekave, arkivave, galerive, muzeve, institucioneve kulturore dhe të artit, panairëve të librit dhe promovimit të botimeve në kuadrin e veprimtarive në diasporë.
6. Krijimit të rrjeteve të reja dhe fuqizimin e atyre ekzistuese, si: rrjetet e biznesit, profesionistëve, të rinjve dhe studentëve, rrjetet e shoqatave në diasporë, koordinimin e tërheqjes së investimeve, promovimit të dy vendeve për mundësitë e të bërit biznes, regjistrimin e diasporës, si dhe fushat e tjera që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me diasporën shqiptare.
7. Shkëmbim të informacioneve që lidhen me konventat ndërkombëtare në fushën e diasporës dhe që kanë të bëjnë me çështjet e identitetit dhe kulturës, temë e kësaj marrëveshjeje;
8. Ofrim të ndihmës në bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në fushat e mbrojtjes së identitetit dhe kulturës për komunitetet shqiptare në diasporë;
9. Shfaqjeve artistike dhe kulturore, në organizimin e koncerteve, shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve të tjera artistike për diasporën;
10. Realizimit të ekspozitave të veçanta për diasporën në kuadër të bashkëpunimit





të drejtpërdrejtë të institucioneve kulturore; realizimin e programeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e filmit, fotografisë artistike, teknologjive të reja dhe mediave audio-vizuale dhe multimedias për të paraqitur historinë e përbashkët të diasporës;

11. Mbështetjen e kontakteve në fushën e literaturës; mbështetjen e rrjetit të botuesve në diasporë;
12. Nxitjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të bibliotekave dhe arkivave për evidentimin e veprimtarisë së diasporës;
13. Palët do të bien dakord mbi aktivitetet që do të organizojnë për çdo qendër kulturore të diasporës nën përgjegjësinë e tyre;
14. Programimit dhe ndihmës jokomerciale të librave, botimeve periodike dhe lloje të tjera të produkteve tipografike për qendrat kulturore të diasporës;
15. Pjesëmarrjeve të përbashkëta në panairë të librit dhe aktivitete të ndërlidhura që do të organizohen në shtetet pritëse të diasporës;
16. Mundësimin të botimit të përbashkët të literaturës me origjinë nga komunitetet shqiptare të diasporës.

#### Neni 7

1. Palët do të mbështesin dhe lehtësojnë bashkëpunimin në mes të shoqatave të regjistruara dhe formave të tjera të organizimit të diasporës shqiptare.
2. Shoqatat e diasporës do të përfshihen nga palët me aktivitete të tyre sipas fushës së veprimtarisë që ushtrojnë dhe sipas planeve dhe objektivave të paracaktuar me këtë marrëveshje.

#### Neni 8

Në fushën e identitetit dhe kulturës, palët bien dakord, që:

1. Përmes qendrave kulturore, të përmirësojnë veprimtarinë dhe aktet e nevojshme në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të kulturës në vendet ku jetojnë komunitet e diasporës duke i ndarë praktikatat më të mira të kësaj fushe, bazuar në legjislacionin e vendeve pritëse, si dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm vendor dhe ndërkombehtar;
2. Nxisin mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të diasporës në vendet pritëse;
3. Ndërtojnë bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve të palëve dhe agjencive të specializuara për promovim, dhe ruajtjen e identitetit e kulturës dhe identifikimin e objekteve me trashëgimi materiale dhe jomateriale;
4. Promovojnë mbrojtjen dhe respektimin e identitetit dhe kulturës shqiptare.



Neni 9

1. Palët do të nxisin zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale me prodhuesit të filmit, si dhe lehtësimin e realizimit të projekteve për prodhim të përbashkët të filmave me temën e diasporës.
2. Palët do të ftojnë prodhuesit e filmave dhe institucioneve relevante të filmit të organizojnë festivale të filmit në qendrat më të njohura të diasporës.
3. Palët do të bashkëpunojnë në aktivitetet që ndërlidhen me festivalet e filmit për diasporën, organizuar në pajtueshmëri me rregullat dhe specifikat e festivalit.

Neni 10

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje do të bashkë organizojnë dhe koordinojnë të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet në vendet e tyre respektive për temën e diasporës.

Neni 11

Palët bien dakord që bashkërisht të harmonizojnë dhe planifikojnë programin vjetor të përbashkët kombëtar që lidhet me aktivitetet e propozuara njësitë përkatëse të dy institucioneve për diasporën shqiptare.

Neni 12

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.  
Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilave Palët njoftojnë njëra-tjetrën se kanë përbushur procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Secila nga Palët mund të tërhiqet nga kjo marrëveshje, në çdo kohë, duke njoftuar Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, denoncimi do ketë efekt 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së një njoftimi të tillë.

Bërë në Korçë, më 27.11.2017, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**

**PËR QEVERINË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**KRYEMINISTRI  
RAMUND HARADINAJ**



---

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËPUNIMIN, NXTJEN E**  
**BIZNESIT DHE INFORMIMIN E DIASPORËS**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (këtej e tutje referuar si “Palët”), me dëshirën që të bashkëpunojnë në kuadrin e funksioneve, qëllimeve dhe juridiksioneve të tyre;

Duke konsideruar se bashkëpunimi i tyre do të ndihmojë në realizimin e përgjegjësive edhe në funksion të “Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e diasporës”, nënshkruar në Korçë, më 27.11.2018;

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

**Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës.

Neni 2

**Fushat e bashkëpunimit**

1. Palët në bashkëpunim do të nxisin dhe ndihmojnë në krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Diasporës Shqiptare, i cili do të kontribuojë në realizimin e organizimit më të mirë të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse.
2. Palët do të nxisin dhe ndihmojnë krijimin e Dhomës (Odës) së biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë, duke respektuar rregullat e funksionimit të të njëjtit rrjet biznesi në diasporë.
3. Palët do të nxisin fillimin e punës nga televizionet publike respektive Radio-Televizioni i Shqipërisë RTSH dhe Radio-Televizioni i Kosovës, që të realizohet një kanal i përbashkët televiziv kushtuar interesave të komuniteteve shqiptare në diasporë.
4. Palët do të angazhohen që brenda vitit 2019 stacioni televiziv i përbashkët të fillojë transmetimin e programeve të veçanta për mësimin egjuhës dhe të programeve të miratuara nga ministritë përgjegjëse të arsimit, ministritë përgjegjëse të kulturës dhe ministritë përgjegjëse për diasporën shqiptare.



5. Palët bien dakord të ndihmojnë iniciativën e krijimit në Tiranë dhe Prishtinë të Bankës së Diasporës nga rrjetet e biznesit të komuniteteve shqiptare të diasporës shqiptare.

### Neni 3

#### **Format e bashkëpunimit**

Palët do të shkëmbejnë informacionin dhe eksperiencën sipas legjislacioneve rregulluese respektive, për nxitjen e një bashkëpunimi efektiv dhe bien dakord të bashkëpunojnë në çështjet e mëposhtme:

1. Të krijojnë procedura koordinimi dhe informacioni, me anë të të cilave palët ndihmojnë njëra-tjetrën për qëllimet e përbashkëta.
2. Të vlerësojnë një plan-veprimi të përbashkët për bashkëpunimin me strukturat organizative të diasporës në funksion të ndihmës efektive për interesat e komunitetit shqiptar në vendet pritëse.
3. Të organizojnë veprimtari të përbashkëta në funksion të qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.
4. Të organizojë takime të rregullta midis Palëve për të diskutuar realizimin e kësaj Marrëveshjeje, për të shkëmbyer informacion dhe për të adresuar çështje specifike të rregullimit ose probleme që mund të kenë lindur.
5. Të sigurojnë dokumentet përkatëse, duke përfshirë, si më poshtë:
  - Organigramat e Palëve me emrat e stafit përkatës dhe përgjegjësitë e tyre; dhe
  - Listën e përfaqësuesve të autorizuar për të kryer aktivitetet në funksion të kësaj marrëveshjeje.

### Neni 4

#### **Ligi i zbatueshëm**

Aktivitetet ekryera në pajtim me këtë Marrëveshje, në mënyrë të veçantë për ndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen në veprime të përbashkëta duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin rregullues të Palëve.

### Neni 5

#### **Gjuha**

Gjuha zyrtare e kësaj Marrëveshjeje është gjuha shqipe. Shkëmbimet zyrtare të informatave dhe dokumenteve do të bëhen në gjuhën shqipe.



Neni 6

**Ndryshimet**

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet vetëm me shkrim nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi do të hyjë në fuqi në datën kur njoftohet dhënia e pëlqimit nga pala tjetër.

Neni 7

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve.

Neni 8

**Hyrja në fuqi dhe përfundimi**

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim ku Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi.
2. Kjo marrëveshjeje do tëmbetet nëfuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila palë mund të njoftojë palën tjetër, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e marrëveshjes. Përfundimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

Bërë në Pejë, më 26.11.2018, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, të dyja tekstet njëllorj të vlefshme.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**

**PËR QEVERINË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**KRYEMINISTRI  
RAMUND HARADINAJ**



## MARRËVESHJE

### **NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS NË SHQIPËRI DHE UNIVERSITÄ DEGLI STUDI E-CAMPUS NË ITALI PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E KËRKIMIT, MËSIMDHËNIES, ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK DHE INOVACIONIT**

Agjencia Kombëtare e Diasporës në Shqipëri dhe Universitë degli Studi E-Campus në Itali (në vijim referuar si Palët),

Me dëshirën për të bashkëpunuar në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit;

Duke parashtruar si më poshtë:

- a) eCampus, i autorizuar nga Universiteti me D.M. 30.01.2006, mund të themelojë kurse universitare, kurse të studimit në distancë duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe telematikën;
- b) sipas Statutit, Universiteti është një komunitet, detyra e të cilit është të kryejë aktivitete hulumtuese dhe të shpërndajë kulturën dhe aktivitetet e trajnimit nëpërmjet përdorimit të metodologjive të edukimit në distancë, në veçanti në lidhje me aplikimet e mësimi elektronik. Për këtë qëllim organizon kurse të rregullta të studimeve universitare për të gjithë ata që zgjedhin të ndjekin projektin e tyre metodologjik dhe didaktik ose që për çfarëdo arsye - të punës, banimit, shëndetit - nuk mund të marrin pjesë vazhdimisht në leksione dhe aktivitete. Gjithashtu ofron kurse trajnimi fleksibël dhe të përshtatshëm për trajnim të vazhdueshëm dhe të përhershëm për të rriturit;
- c) legjislacioni italian dhe në veçanti dekreti legjislativ 64/17 inkurajon promovimin e sistemit arsimor italian në botë në kontekste multikulturore dhe pluraliste dhe përhapjen dhe promovimin e gjuhës dhe kulturës italiane jashtë vendit.
- d) Universiteti është i interesuar të fillojë bashkëpunime të reja dhe të forcojë ato ekzistuese me organet publike dhe private, kombëtare ose ndërkombëtare që veprojnë në fushën e kërkimit dhe promovimit të trajnimit dhe transmetimit të njohurive shkencore;
- e) Universitetit i njihet mundësia për të ruajtur dhe rritur këto forma të bashkëpunimit me qëllim të pasurimit të aktiviteteve të formimit universitar me kontributin e lartë në kërkimin shkencor dhe shpërndarjen e rezultateve të hulumtimit të kryer;
- f) Agjencia Kombëtare e Diasporës, krijuar me ligjin nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e



bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj; ofrimin të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare; nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës dhe bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

- g) është në interes të të dyja Palëve të vazhdojnë dhe zhvillojnë mëtej, me përdorimin e burimeve të tyre përkatëse dhe brenda rolit dhe kompetencave të secilës, veprimtaritë kërkimore me interes të përbashkët nëpërmjet bashkëpunimit në projekte dhe nisma të përbashkëta.
- h) është në interes të të dy organizmave për të inkurajuar trajnime të nivelit të lartë nëpërmjet ofrimin të aktiviteteve orientuese për kurse universitare dhe pasuniversitare.
- i) mundësia për të vlerësuar, në kontekst të aktiviteteve kërkimore dhe trajnuese, zbatimin e formave të mësimdhënies dhe mobilitetit të studentëve, si dhe të promovojë dhe implementojë çdo bashkëpunim të pranueshëm shkencor, e dobishme për realizimin më të mirë të qëllimeve përkatëse institucionale, gjithashtu me përfshirjen e subjekteve të tjera publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime të inovacionit dhe shfrytëzimit të rezultateve.

Janë dakorduar si vijon:

#### Neni 1

##### **Objekti**

1. Objektet janë një pjesë integrale dhe thelbësore e marrëveshjes në tërësi.
2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të interpretohen në përputhje me qëllimet e nxjerra nga objekti.

#### Neni 2

##### **Parimet e përgjithshme**

1. Në mënyrë që të arrihen më mirë qëllimet e tyre institucionale, palët njohin interesin e përbashkët për të ruajtur dhe zhvilluar format e bashkëpunimit për të kryer kërkime, mësimdhënie dhe zhvillimin teknologjik dhe inovacionit në aktivitete të mësimdhënies dhe trajnimit, si dhe për ofrimin e shërbimeve për të mbështetur aktivitetet kërkimore.
2. Ndërkombëtarizimi i mësimdhënies, hulumtimit dhe trajnimit, duke përfshirë pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe evropiane, është një aset strategjik



në politikat e vendosjes së dy institucioneve. Palët, për këtë arsye, kanë për qëllim për të identifikuar veprimet e përbashkëta në përcaktimin e rrjetit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe organizimin e ngjarjeve institucionale për promovimin e kulturës shkencore dhe teknologjike dhe sipërmarrjen në nivel lokal. Për më tepër, format e bashkëpunimit mund të zbatohen në lidhje me nismat për të krijuar ngjarje institucionale në bashkëpunim me subjektet e tjera të botës kërkimore shkencore apo të biznesit.

3. Palët synojnë të identifikojnë modele të reja dhe strategji për të forcuar lidhjen me territorin, duke përfshirë edhe në aspektin social dhe kulturor, duke eksperimentuar me forma të reja të komunikimit dhe përhapjen e njohurive të teknologjisë së lartë dhe përvojës brenda komunitetit lokal.
4. Palët marrin përsipër të vlerësojnë mundësinë e realizimit të formave të lëvizshmërisë së studentëve, të stafit mësimdhënës dhe hulumtues dhe të aktiviteteve të orientimit universitar.

### Neni 3

#### Qëllimi

1. Palët angazhohen reciprokisht, në përputhje me ligjet e tyre përkatëse dhe me kompetencat e tyre, të bashkëpunojnë me qëllim:
  - a) Identifikimin e prioriteteve për formulimin dhe zhvillimin e projekteve të mësimdhënies dhe orientimit në hyrje, hulumtim, zhvillim, të identifikuara edhe përmes një analize të kujdesshme të kërkesës së shprehur nga komponentët e ndryshëm të realitetit social, ekonomik dhe industrial të Shqipërisë, si dhe në bashkëpunim me universitetet e tjera shqiptare dhe institucionet kërkimore;
  - b) Realizimin e mobilitetit të studentëve, mësimdhënies dhe hulumtimit;
  - c) Planifikimin e kurseve të përbashkëta të trajnimit ose sigurimin e njohjes së aktiviteteve arsimore në përputhje me rregulloret në fuqi në të dy vendet;
  - d) Hartimin, zbatimin dhe aktivizimin e kurseve ndërkombëtare të doktoratës që përfshijnë, për këtë qëllim, universitetet shqiptare;
  - e) Shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit, transferimin teknologjik dhe inovacionin, duke favorizuar ndërveprimet me sistemin industrial dhe territorial;
  - f) Kryerjen e veprimtarive arsimore, kërkimin dhe shpërndarjen e rezultateve të aktiviteteve kërkimore (Misioni i tretë) nga profesorët e universiteteve në institucionet dhe universitetet shqiptare.
2. Këto veprime do të zhvillohen duke favorizuar bashkëpunimet dhe sinergjitë e





përshtatshme me Organet dhe Agjencitë Kombëtare, me sistemin industrial dhe me çdo organ tjetër që tregon interes për të marrë pjesë.

3. Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të qeveriset nga dispozitat e parashikuara:
  - a) në këtë Marrëveshje;
  - b) në Aktet Operative individuale të përshkruara më poshtë;
  - c) në të gjitha dispozitat e zbatueshme.

#### Neni 4

### **Bashkëpunimi për aktivitetet kërkimore, zhvillimore dhe inovative**

1. Palët do të nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë në kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje, palët mund të pajtohen me tema specifike të hulumtimit.
2. Këto forma të bashkëpunimit mund të arrihen përmes përcaktimit të akteve operacionale, të parashikuara më poshtë, duke identifikuar strukturat shkencore të secilit trup të përfshirë në projekt. Secili akt duhet të miratohet nga Palët sipas ligjeve të tyre të brendshme.
3. Aktivitetet bashkëpunuese në kryerjen e partneriteteve të projekteve specifike mund të përfshijnë, si më poshtë:
  - a) përcaktimin e programeve afatmesme të kërkimit dhe zhvillimit e projekteve të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit për pjesëmarrje të përbashkët në Programet e Kornizës Evropiane, përveç formulimit të propozimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
  - b) bashkëpunim në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare në të cilat marrin pjesë palët;
  - c) studimin dhe eksperimentimin e shërbimeve inovative për shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit, transferimin e teknologjisë dhe financimin e fillimit të inovacionit;
  - d) promovimin, krijimin, rritjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja të biznesit dhe produkteve të reja që mbështesin dinamizmin e inovacionit në territoret e përfshira dhe eksperimentojnë me një model inovativ;
  - e) nxitjen e aktiviteteve për përhapjen e kulturës shkencore dhe teknologjike në territor.

#### Neni 5

### **Bashkëpunimi në fushën e arsimit, kulturës dhe trajnimeve të avancuara**

1. Në kontekstin e bashkëpunimit në aktivitetet didaktike dhe të trajnimit, palët deklarojnë disponueshmërinë e tyre për të kryer aktivitete të përbashkëta si më



poshtë, por pa u kufizuar në to:

- a) mbështetje për zhvillimin etezave dhe projekteve për arritjen e diplomave të nivelit master dhe doktoraturës;
- b) kryerjen e ushtrimeve;
- c) organizimi i vizitave arsimore dhe praktikave drejtuar studentëve;
- d) organizimi i konferencave, debateve dhe seminareve;
- e) organizimi i veprimtarive mësimore të orientimit universitar;
- f) bashkëpunimi në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat aderohet palët;
- g) organizimin e ngjarjeve edhe në sinerji me organe të tjera;
- h) të favorizojë aktivitetet e punës praktike të rregulluara me një marrëveshje specifike të përcaktuar në bazë të legjislacionit aktual;
- i) ofrimi i bursave për studentët e shkëlqyer nga diaspora;
- j) reduktimi i tarifave për studentët nga diaspora.

#### Neni 6

### **Komiteti i përbashkët drejtues**

1. Për koordinimin e aktiviteteve bashkëpunuese të përmendura në këtë Marrëveshje, palët bien dakord të vlerësojnë krijimin e një komiteti të përbashkët drejtues, i përbërë nga dy përfaqësues për secilën palë. Komiteti emëron Kryetarin e tij; në rast të një votimi të barabartë, anëtari më i vjetër i votave të hedhura emërohet nga kryesuesi.
2. Komiteti gjithashtu takohet, në mënyrë telematike, me një nga Palët dhe harton një rregullore për funksionimin e tij.
3. Komiteti mbetet në detyrë për kohëzgjatjen e Marrëveshjes dhe riemërohet në rast të rinovimit të Marrëveshjes.
4. Anëtarët e Komitetit nuk shpërblehen për anëtarësinë e tyre. Çdo shpenzim për misionin e anëtarëve do të mbulohet nga Enti i anëtarësisë përkatëse.
5. Komiteti ka këto detyra:
  - a) koordinon aktivitetet bashkëpunuese;
  - b) planifikon ndërhyrjet në baza trevjeçare;
  - c) monitoron nismat e përbashkëta të kryera në bashkëpunim dhe harton raporte të rregullta për progresin e tyre tek organet kompetente të Palëve;
  - d) përcakton individët të cilët do të ndjekin këto aktivitete, trajnime etj.



Neni 7

**Aktet Operative**

Palët bien dakord mbi zbatimin e projekteve kërkimore, aktiviteteve trajnuese, orientimit universitar dhe arsimit të lartë, iniciativave që kanë për qëllim rritjen e rezultateve të kërkimit shkencor dhe të çdo aktiviteti tjetër me interes të përbashkët, nëpërmjet përcaktimit të akteve operative, identifikimit të strukturave të studimeve shkencore të çdo Pale të përfshirë në projekt ose iniciativë të përbashkët. Secili akt duhet të miratohet nga Palët sipas ligjeve të tyre të brendshme.

Neni 8

**Konfidentaliteti dhe Pronësia Intelektuale**

1. Palët detyrohen reciprokisht për kufizimet e fshehtësisë në lidhje me informacionin, të dhënat dhe njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe / ose ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të atij informacioni, të dhënave, lajme dhe vendime për të cilat ligji ose një urdhër administrativ ose gjyqësor imponon një detyrim për të komunikuar dhe / ose për të marrë miratimin e Palës nga e cila vijnë këto të dhëna.
2. Çdo drejtë e pronësisë intelektuale në pronësi të një Pale do të mbetet në pronësi të plotë të saj dhe përdorimi i saj që i lejohet Palëve të tjera sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të nënkuptojë njohjen e ndonjë licence apo të drejte në lidhje me këtë të drejtë, me përjashtim të rasteve kur transferimi i kësaj licence ose të drejte është parashikuar shprehimisht në aktet operative.
3. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale në pronësi të një Pale mund të përdo ret nga Palët e tjera për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje vetëm me pëlqimin e shprehur të Palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë dhe në përputhje me rregullat e treguara nga ajo Palë dhe/ose të përfshira në aktet operative.

Neni 9

**Përpunimi i të dhënave personale**

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale në përputhje me legjislacionin aktual për mbrojtjen e të dhënave personale; të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike vetëm për qëllimet që lidhen me këtë Marrëveshjeje.



Neni 10

**Format e bashkëpunimit**

Palët janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

**Përgjegjësia**

Agjencia Kombëtare e Diasporës nuk është përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë pala tjetër me personat e tretë.

Neni 12

**Kohëzgjatja, procedura e rinovimit dhe e drejta e tërheqjes**

- 1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dyja Palët.
- 2 Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej pesë vitesh nga data e hyrjes në fuqi dhe mund të rinovohet për të njëjtën periudhë në bazë të një marrëveshjeje të shkruar midis palëve.
- 3 Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas gjashtë (6) muajsh nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për tu tërhequr nga lidhja e kësaj marrëveshjeje. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshjeje nuk prodhon efekte mbi marrëdhëniet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshjeje ka qënë në fuqi.

Neni 13

**Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve.



Neni 14

**Regjistrimi**

Kjo Marrëveshje hartohet në tri gjuhë, Anglisht, Shqip dhe Italisht (2 kopje për secilën gjuhë).

**PËR UNIVERSITETIN**

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
TË DIASPORËS**

**REKTORI**

**DREJTORI EKZEKUTIV**



**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI**  
**MIDIS MINISTRISË SË SHTETIT PËR DIASPORËN TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË, MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR**

Duke konsideruar që Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Kryqi i Kuq Shqiptar (këtu më poshtë do të quhen “Palët”) dëshirojnë të bashkëpunojnë në kuadrin e funksioneve, qëllimeve dhe juridiksioneve të tyre.

Duke konsideruar që Palët dëshirojnë që nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë të ndihmojnë në realizimin e përgjegjësive të tyre përkatëse ndaj familjeve që ndahen dhe humbin kontaktet me anëtarët e vet si rrjedhojë emigrimit apo situatave të tjera që kërkojnë ndërhyje humanitare.

Duke konsideruar që Palët dëshirojnë që nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë të nxisin dhe të zgjerojnë bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencën mbi çështjet e gjetjes së vendndodhjes së personave të humbur dhe rivendosjen e kontakteve me të afërmit e tyre, si pasojë e migrimit, konflikteve apo situatave të dhunës, bazuar në konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe protokollet shtesë të tyre të vitit 1977.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

**Angazhimet dhe përgjegjësitë e palëve**

Bazuar në procedurat operationale standarde të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, kur nuk ka mënyra të tjera komunikimi ndërmjet anëtarëve të familjeve të ndara për shkaqe të përmendura më sipër, Palët bien dakord të bashkëpunojnë, brenda fushës së përgjegjësisë së secilës prej tyre, në çështjet e mëposhtme:

1. Kërkimi i personave të humbur do të bëhet nëpërmjet Rrjetit Ndërkombëtar të Kërkimit brenda Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, icili mundëson ndjekjen e rasteve të kërkimit të personave të humbur në vende të botës ku ka prezencë të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe.
2. Kërkesat për kërkim të një personi të humbur mund të bëhen pranë Palëve. Procedurat standarde operationale në gjetjen e vendndodhjes së njerëzve që janë ndarë me të afërmit e tyre, nisin menjëherë pasi familjari depoziton kërkesën pranë Kryqit të Kuq Shqiptar.
3. Kur është e mundur, Palët sigurojnë shërbimin e ribashkimit të familjes për



- individë të pambrojtur kryesisht fëmijë të pashoqëruar, të moshuar ose individë me nevoja speciale, nëpërmjet referimit të rastit edhe te Shërbimi Social.
4. Kur kanalet normale të komunikimit midis familjarëve janë shkëputur (për shembull, personi i humbur gjendet në qendra të vuajtjes së dënimit) dhe nuk ka asnjë mënyrë tjetër komunikimi, personave u ofrohet një shërbim i veçantë të komunikimi. Individit në këtë rast, plotëson një mesazh personal në një formular të veçantë të Kryqit të Kuq (mesazh i Kryqit të Kuq), i cili i dërgohet familjes në mirëbesim.
  5. Palët angazhohen në përcaktimin e shteteve që kanë qenë destinacion i familjarëve të humbur, të cilët kanë migruar apo aktualisht nuk iu dihet vendndodhja për shkaqe të panjohura, në mënyrë që të arrihet në identifikimin e personave që mund të ndodhen edhe në sistemin e burgjeve të vendeve pritëse.
  6. Palët ose autoritete të tjera shtetërore mund të identifikojnë dhe referojnë pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, familjarë shtetas të Shqipërisë, të cilët kanë humbur lidhjet me të afërmit e tyre që kanë migruar, për të filluar procesin e kërkimit.

#### Neni 2

Modalitetet për kërkimin e personave të humbur të gjitha modalitetet për procesin e kërkimit të personave të humbur, specifikohen në një shtojcë të veçantë, bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 3

##### **Kohëzgjatja, ndryshimi dhe përfundimi**

1. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është e papërcaktuar duke filluar nga hyrja e tij në fuqi.
2. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e tij, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të këtij Memorandumi vetëm me pëlqimin e përbashkët, me shkrim.
3. Palët mund t'i japin fund në mënyrë të njëanshme dhe në çdo kohë kësaj marrëveshjeje, për arsye legjitime. Për ta bërë këtë, ato do të duhet të njoftojnë kërkesën e tyre me shkrim të paktën 90 ditë para datës së dëshiruar të shfuqizimit të saj.



Neni 4

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çështjet e diskutueshme nëlidhje meinterpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen memirëkuptim, përmes konsultimeve dhe negociatave ndërmjet Palëve.

Neni 5

**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Palët.

Bërë në Tiranë, më 6 dhjetor 2017, në tri tekste origjinale në anglisht dhe në shqip, të dyja tekstet në mënyrë autentike të barabartë, një kopje e të cilave do t'i dorëzohet secilës nga Palët.

**PËR MINISTRIN E SHTETIT PËR DIASPORËN TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Datë: 6.12.2017**

**PËR MINISTRIN E DREJTËSISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Datë: 6.12.2017**

**PËR KRYQIN E KUQ SHQIPTAR**

**Datë: 6.12.2017**





**MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË**  
Nr. 15824, datë 15.12.2017

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN**  
Nr. 6311, datë 11.12.2017

**BANKA E SHQIPËRISË**  
Nr. 5518, datë 11.12.2017

### **MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Banka e Shqipërisë (më poshtë referuar si "Palë") hyjnë në këtë Marrëveshje Mirëkuptimi me synim vlerësimin dhe rritjen e eficiencës së një prej burimeve kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit, siç është diaspora dhe migracioni jashtë vendit.

Për këtë arsye, Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi sipas përmbajtjes së mëposhtme:

#### **I. QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Qëllimi i këtij Memorandumi është ruajtja e ndërgjegjësimit, lehtësimi i dialogut dhe nxitja e bashkëpunimit të efektshëm midis palëve për çështje që kanë të bëjnë me kontributin e dërgesave në para nga emigrantët shqiptarë në diasporë për zhvillimin e ekonomisë. Gjithashtu, Memorandumi synon të nënvizojë rolin e diasporës në nxitjen e investimeve në ekonominë shqiptare, si dhe në përthithjen e kapitalit njerëzor, kjo në përputhje të plotë edhe me Strategjinë Kombëtare për Diasporën. Në funksion të këtij qëllimi, palët do të koordinojnë politikëbërjen sipas legjislacioneve rregullues e respektive në përmbushjen e pikave, si më poshtë:

1. Identifikimin dhe vlerësimin e efekteve të dërgesave në para të emigrantëve në ekonominë shqiptare dhe analizimin e mëtejshëm të tyre në funksion të hartimit të politikave stimuluese në këtë kuadër.
2. Vlerësimin e masave lehtësuese që ndihmojnë përdorimin gjerësisht të kanaleve dhe instrumenteve formale të dërgesave, si dhe rritjen e mëtejshme të përfshirjes financiare të popullatës.
3. Koordinimin e bashkëveprimit, me qëllim:
  - a) Identifikimin dhe promovimin e politikave, programeve, praktikave dhe përvojave më të mira të institucioneve financiare në lidhje me forcimin e kontributit të emigrantëve, si dhe transparencën dhe mbrojtjen e



- konsumatorëve në fushën e dërgesave në para nga emigrantët;
- b) Nxitjen e masave për ofrimin e produkteve apo shërbimeve financiare me kosto sa më të ulët të ardhjes së dërgesave në para nga emigrantët nëpërmjet rritjes së konkurrencës, përdorimit të zgjidhjeve moderne teknologjike dhe modeleve novatore të biznesit;
  - c) Angazhimin e përbashkët për nisma të reja ligjore, si dhe përmirësime të akteve ligjore ekzistuese, me synim reduktimin e barrierave rregullatore dhe kufizimeve të tjera për transferimet e dërgesave në para të emigrantëve, promovimin e investimeve të diasporës, si dhe lehtësimin e veprimeve të institucioneve financiare në marrëdhënie me diasporën dhe migracionin.
4. Hartimin e rekomandimeve konkrete dhe të realizueshme për të përthithur potencialin e investimeve të diasporës dhe dërgesave në para të emigrantëve.
  5. Mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e informacionit statistikor dhe atij studimor në lidhje me nivelin dhe ndikimin e dërgesave në para të emigrantëve dhe investimeve të diasporës, si dhe prezantimin e rezultateve nga ana e Bankës së Shqipërisë përmes një botimi periodik.
  6. Hartimin e strategjisë kombëtare për zhvillim, që promovojnë modele të suksesshme biznesi dhe që përfshijnë kontributet e diasporës dhe emigrantëve, informimin mbi mundësitë që ofron ekonomia jonë dhe motivimin e tyre për të investuar në sektorë të veçantë të ekonomisë.
  7. Bashkëpunimin me strukturat financiare të shteteve që kanë prezencë të lartë të diasporës dhe migracionit shqiptar, si dhe me komunitetin e biznesit të diasporës dhe migracionit, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe motivimin e projekteve të investimeve që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë.
  8. Shqyrtimin e mundësive për të çliruar potencialin e investimeve nga diaspora, me fokus të veçantë te modelet novatore dhe të qëndrueshme të biznesit, të cilat zgjerojnë tregjet aktuale të dërgesave në para, krijojnë sinergji me tregje dhe produkte të tjera financiare, rrisin qasjen dhe përfshirjen në shërbime dhe produkte financiare dhe promovojnë kanalet e disponueshme për dërgesat në para në komunitetet e migrantëve në vendin e originës.

## II. MODALITETET E BASHKËVEPRIMIT

1. Palët do të ngrënë grupe pune në nivel institucional ose ndërinstitucional kur e gjykojnë të nevojshme dhe do të shkëmbejnë informacion të përbashkët, në përmbushje të qëllimit të këtij Memorandumi;
2. Palët do të bashkëpunojnë me institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare, si:



FMN-në, BB-në, INSTAT-in etj., për vlerësimin dhe/ose asistencën në fushën e dërgesave të parave nga jashtë.

3. Palët do të vendosin një dialog periodik me përfaqësuesit e institucioneve financiare të vendit dhe do të koordinojnë veprimet e tyre duke vlerësuar rast pas rasti nevojat në funksion të përmirësimeve të natyrave të ndryshme të kërkuara edhe prej përfaqësuesve të sipërmarrjes.
4. Palët do të bashkëpunojnë me dhomat e biznesit, organizatat jofitimprurëse, si dhe me institucionet akademike vendëse në funksion të qëllimeve të këtij Memorandumi.
5. Palët do të organizojnë takime të rregullta për të diskutuar ecurinë e angazhimeve të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, si dhe për të adresuar çështje specifike të rregullimit ose probleme që mund të kenë lindur.
6. Palët do të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta me qëllim kremtimin e Ditës Ndërkombëtare të Dërgesave në Para pranë Familjeve.
7. Palët do të sigurojnë listën e përfaqësuesve të autorizuar për secilin institucion për të kryer aktivitete në funksion të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
8. Palët do të mbështesin punën e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), të kryesuar nga Banka e Shqipërisë, si një organ kolegial me karakter këshillimor, i cili synon të bashkëpunojë dhe bashkërendojë veprimet me të gjitha institucionet e përfshira në këtë fushë.

### III. KUADRI LIGJOR DHE KONFIDENCIALITETI

1. Aktivitetet e kryera në pajtim me këtë Memorandum Mirëkuptimi, në mënyrë të veçantë për ndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen në veprime të përbashkëta, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin rregullues të Palëve.
2. Palët bien dakord të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni ose materiali të siguruar nga njëra Palë për Palën tjetër. Ato, në pajtim me këtë Memorandum Mirëkuptimi, nuk do të bëjnë të njohur asnjë informacion ose material të tillë për një Palë të tretë pa autorizimin paraprak të Palës tjetër.

### IV. GJUHA E PËRDORUR

Sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pavarësisht se Palët mund të bien dakord ndryshe, si rregull ato komunikojnë për shkëmbimin e dokumentacionit, në gjuhën shqipe.



## V. NDRYSHIMI DHE PËRFUNDIMI

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe me mirëkuptimin e Palëve.
2. Secila nga Palët mund të largohet nga angazhimet e marra përsipër në këtë Memorandum Mirëkuptimi, me kushtin që të njoftojë Palët etjetera me shkrim 90 ditë përpara largimit.

## VI. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga përbushja e angazhimeve të marra përsipër në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

## VII. HYRJA NË FUQI

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën nënshkrimit nga Palët.
2. Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje Mirëkuptimi në tre ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, në datën e deklaruar në faqen e parë.

**MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË**

**ARBEN AHMETAJ  
MINISTËR**

**MINISTRI I SHTETIT  
DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO  
MINISTËR**

**BANKA E SHQIPËRISË  
GENT SEJKO  
GUVERNATOR**



**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI  
MIDIS MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS GERMIN PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN  
E DIASPORËS**

Ministri i Shtetit i Republikës së Shqipërisë dhe GERMIN (organizatë joqeveritare, e regjistruar në Prishtinë, Republika e Kosovës, me fokus përfshirjen dhe angazhimin e Diasporës në zhvillim), më poshtë të referuara si “Palët”, me synim nxitjen e bashkëpunimit të tyre dypalëshe në fusha të ndryshme për angazhimin e diasporës;

Të bindur që bashkëpunimi në fushën e diasporës është një instrument me vlera për cilësinë e jetës së pjesëtarëve të diasporës që jetojnë jashtë vendit amë:

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton kushtet për bashkëpunimin dhe përgjegjësitë ndërmjet Palëve.
2. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është të krijojë një kornizë bashkëpunuese, të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin midis Palëve, në mënyrë joekskluzive, në fushat me interes të përbashkët në funksion të forcimit të rolit të Diasporës shqiptare për zhvillimin social dhe ekonomik.

Neni 2

**Përgjegjësitë e palëve**

Palët bien dakord, që:

1. Të mbajnë dhe të ruajnë bashkëpunimin i cili respekton pavarësinë profesionale dhe transparencën e veprimtarisë;
2. Të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë për hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta në fushat prioritare, të cilat do të jenë të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mbi tema të caktuara në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Diasporën Shqiptare;
3. Të shkëmbejnë dokumente dhe informacione specifike në lidhje me programet e punës që janë me interes për secilën nga Palët;
4. Të takohen për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët.



Neni 3

**Fushat prioritare të angazhimit**

Palët bien dakord të forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushat e mëposhtme specifike të lidhura me angazhimin e Diasporës:

1. Komiza ligjore dhe institucionale për përfshirjen e diasporës;
2. E drejta e votës për diasporën dhe përfaqësimi në Kuvend;
3. Politika ekonomike dhe investimet për diasporën;
4. Promovimi i shkëmbimit profesional me diasporën shqiptare;
5. Shkëmbimi edukativ dhe kulturor;
6. Promovimi i projekteve të diasporës lokale në qytetet/rajonet epërzgjedhura në vendet respektive;
7. Organizatat joqeveritare dhe filantropia e diasporës shqiptare.

Neni 4

**Shërbime këshilluese**

1. Palët bien dakord që GERMIN të ketë rol këshillues në drejtim të ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky rol nënkupton edhe mbështetje me asistencë teknike, këshilla strategjike dhe lehtësim të dialogut me anëtarët e komunitetit shqiptar që jetojnë jashtë vendit.
2. Palët bien dakord që GERMIN do të ndihmojë personelin e ministrit të Shtetit për Diasporën, me këshilla teknike dhe shërbime të tjera me marrëveshje ndërmjet palëve.
3. Të dyja palët duhet të bashkëpunojnë dhe të angazhohen për të siguruar bashkëpunimin dhe financimin nga palët e treta (d.m.th. nga donatorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, si: IOM, GIZ, SDC etj.).
4. Palët do të japin hapësirë në faqet informuese (ueb faqet dhe rrjetet sociale), të tyre për programet e përbashkëta.

Neni 5

**Fushat e bashkëpunimit**

Palët bien dakord se do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme me interes të përbashkët:

1. Regjistrimi i diasporës: Palët bien dakord që të punojnë së bashku në zhvillimin e një programi të përbashkët për të lehtësuar procesin e regjistrimit të Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Diasporë. Baza e të dhënave aktuale, e cila do



të zhvillohet, do të përfshinte individët, bizneset dhe inkuorporimin e databazës ekzistuese të organizatave joqeveritare. Çdo platformë on-line do të zhvillohet me transparencë dhe shkëmbim të plotë informacioni, icili do të reflektojë edhe shqetësimet e privatësisë që duhet të merren parasysh;

2. Konferenca për diasporën: Palët bien dakord që të sigurojnë bashkëfinancim për konferencën, ecila do të mbledhë pjesëtarët nga komuniteti idiasporës, grupet e interesit, bizneset dhe profesionistët, për të zhvilluar bashkërisht një qasje të bashkërenduar më mirë me institucionet publike të Shqipërisë dhe Kosovës, si mundësi për të forcuar më tej kuadrin ligjor dhe angazhimin me komunitetet e diasporës;
3. Samitii diasporës: Palët do të punojnë në projektimin, planifikimin dhe organizimin e Samitit të Diasporës me qëllim që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës.
4. Shkolla e Diasporës në Shqipëri: Palët do të koordinojnë vlerësimet në planifikimin, mbledhjen e fondeve, implementimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në terren për Shkollën e parë të Diasporës në Shqipëri.
5. Këshilli i Diasporës: Palët do të bashkërendojnë përpjekjet për të formuar një Këshill Shqiptar të Diasporës. Këshilli do të bazohet në praktika të ngjashme të vendeve të tjera, duke iu referuar termave specifikë, si dhe dispozitave të qarta dhe transparente.
6. Programet e tjera: Palët do të bashkëpunojnë në hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta, siç referohen në nenin 2, pika 2.

#### Neni 6

1. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve nëpërmjet konsultimeve periodike.
2. Palët kanë të drejtë të ndryshojnë këtë memorandum pas konsultimeve dhe marrëveshjeve midis palëve.

#### Neni 7

Secila palë ka të drejtë të shkëpusë këtë marrëveshje, në çdo kohë, pas konsultimit paraprak të përbashkët dhe përmes një njoftimi zyrtar me shkrim.

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORË**

**PANDELI MAJKO**

**DREJTORESHË E PROGRAMEVE  
ORGANIZATA GERMIN**

**LIZA GASHI**



**AGJENCIA KOMBËTARE  
PËR DIASPORËN**

Nr.128 prot.

Tiranë, më 20.11.2018

**INSTITUTIKULINAR  
NERANXI**

Nr.132 prot.

Tiranë, më 20.11.2018

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE INSTITUTIT  
KULINAR “NERANXI” PËR PROMOVIMIN E KULINARISË SHQIPTARE NË  
DIASPORË**

Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Instituti Kulinar “Neranxi” (këtej e tutje referuar si “Palët”), të inkurajuar nga dëshira e përbashkët për të nxitur shkëmbimin e kulturave gastronomike në vendet pritëse të diasporës shqiptare;

Duke vlerësuar rëndësinë e kulturës gastronomike shqiptare si pjesë e identitetit kombëtar shqiptar që mund të përfaqësojë në mënyrë dinjitoze vendin;

Duke marrë parasysh politikat e ndjekura për forcimin dhe realizimin e lidhjeve të diasporës me vendin e originës, si dhe përfaqësimin e vendit tonë në aktivitete kulturore ndërkombëtare;

Duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum si më poshtë:

**Neni 1**

Palët me dëshirën për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta për promovimin e kulinarisë shqiptare në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, me qëllim ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar janë dakorduar si vijon:

- a) Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin, në fushën e diasporës mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok;
- b) Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve për promovimin e kulinarisë shqiptare në diasporë;
- c) Palët do të zhvillojnë aktivitetin “Ditët e kulinarisë në diasporë”, me qëllim promovimin e recetave gastronomike shqiptare në diasporë mbi bazën e





programeve vjetore të miratuara nga palët.

- d) Palët do të angazhohen në programe vjetore të përbashkëta kulturore për diasporën kudo që do të vlerësojnë se është e nevojshme.

Neni 2

Shpenzimet financiare të aktiviteteve do të përballohen nga Instituti Kulinar Neranxi.

Neni 3

Agjencia Kombëtare për Diasporën do të marrë përsipër lehtësimin e procedurave ligjore vendëse dhe ofrimin e ndihmës për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve sipas këtij Memorandumi.

Neni 4

Palët kanë rënë dakord që ky memorandum nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit, të cilat nuk janë specifikuar në të, por janë në përputhje me objektivat e saj.

Neni 5

Mosmarrëveshjet e këtij Memorandumi do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.

Neni 6

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Agjencinë Kombëtare për Diasporën dhe dy në Institutin Kulinar Neranxi.

Nënshkruar në, Tiranë, më 20.11.2018 në 4 kopje origjinale secila në gjuhën shqipe i tërë teksti është i njëjtë.

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
PËR DIASPORËN**

**PËR INSTITUTIN  
KULINARNERANXI**



**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**  
**DHE “OC INTERNATIONAL” Sh.p.k PËR PROMOVIMIN E KULTURËS DHE**  
**IDENTITETIT KOMBËTAR**

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe “OC International” Sh.p.k (këtej e tutje referuar si “Palët”),

Të inkurajuar nga dëshira e përbashkët për të nxitur promovimin e kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në përhapjen e trashëgimisë kulturore kombëtare;

Janë dakorduar si vijon:

Neni 1

**Qëllimi**

1. Palët, bazuar në angazhimin e ndërsjelltë, bashkëpunojnë me qëllim:
2. Organizimin e eventeve, koncerteve dhe aktiviteteve kulturore në diasporë;
3. Përhapjen e trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar;
4. Ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës;
5. Ndërmarrjen e nismave të tjera në fushën e diasporës, që konsiderohen të nevojshme nga palët, në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje.

Neni 2

**Parimet e përgjithshme**

1. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë, në përputhje me objektin e veprimtarisë dhe fushën e kompetencave të tyre.
2. Palët vlerësojnë interesin dhe dëshirën e përbashkët për të zhvilluar forma të bashkëpunimit në përputhje me nenin 1 të kësaj marrëveshje.

Neni 3

**Bashkëpunimi për punimet shkencore dhe aktivitetet**

- a) Palët angazhohen për organizimin e aktiviteteve kulturore përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit të cilat përfshijnë:
- b) Organizimin e eventeve, koncerteve apo formave të tjera të aktiviteteve kulturore



në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare, si dhe në Republikën e Shqipërisë;

- c) Promovimin e kulturës dhe identitetit kombëtar shqiptar në diasporë;
- d) Ofrimin e këshillimit të vazhdueshëm artistik dhe jo vetëm, për aktivitetet e parashikuara në programet vjetor të aktiviteteve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës;
- e) Ofrimin e listës së shoqatave shqiptare kulturore, artistike apo dhomave të biznesit që veprojnë në diasporë;
- f) Nxitjen e organizimit të aktiviteteve në vendet ku gjendet diaspora shqiptare;
- g) Forma të tjera bashkëpunimi që nuk përmenden në këtë marrëveshje, por janë në përputhje me qëllimin e saj, pasi palët të kenë shprehur dakordësinë me shkrim.

#### Neni 4

### **Konfidencialiteti dhe pronësia intelektuale**

- a) Palët kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me informacionin, të dhënat dhe njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
- b) Të drejtat e pronësisë intelektuale palët do të vazhdojnë ti gazojnë veçmas, me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe përmes një marrëveshjeje me shkrim.
- c) Të drejtat e pronësisë intelektuale në pronësi të një pale mund të përdoren nga pala tjetër për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshjeje, vetëm me pëlqimin e shprehur me shkrim të palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë dhe në përputhje me rregullat e parashikuara nga ajo palë.

#### Neni 5

### **Përpunimi i të dhënave personale**

- 1. Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 2. Të dhënat personale që njëra palë siguron nga pala tjetër, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, mund t'i përdorë vetëm për sa kohë marrëveshja është në fuqi dhe në përputhje me qëllimin e saj.

#### Neni 6

### **Bashkëpunim me persona të tretë**

Kjo marrëveshje nuk përjashton mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me



subjekte të tjera që nuk janë palë e kësaj marrëveshjeje, me kusht që bashkëpunimet me palët e treta të mos bien ndesh me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

**Përgjegjësia**

Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta.

Neni 8

**Kohëzgjatja, procedura e rinovimit dhe e drejta e tërheqjes**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët.
2. Kjo marrëveshje ka një kohëzgjatje pa afat duke filluar nga data e hyrjes në fuqi.
3. Palët mund të tërhiqen nga kjo marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas gjashtë (6) muajsh nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për t'u tërhequr nga kjo marrëveshje. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshje, nuk përjashton përgjegjësinë e palëve për marrëdhëniet dhe detyrimet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshje ka qenë në fuqi.

Neni 9

**Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Neni 10

**Gjuha e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në 2 kopje .

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
PËR DIASPORËN**

**DREJTORI EKZEKUTIV  
DRITAN DELIJA**

**PËR "OC INTERNATIONAL"  
HPK**

**ADMINISTRATORI  
OLEN ÇEZARI**



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
PËR PROGRAMIN “JAM SHQIPTAR” TË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE  
NDËRMJET MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, MINISTRISË SË  
TURIZMIT DHE MJEDISIT, MINISTRISË SË KULTURËS DHE MINISTRIT TË  
SHTETIT PËR DIASPORËN**

PREAMBUL

Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Kulturës, të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen Palë:

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të diasporës;

Me dëshirën për të nxitur brezat e rinj në angazhimin me projekte të veçanta të programeve edukative dhe kulturore që promovojnë traditat, historinë dhe kulturën shqiptare;

Duke konsideruar vizitat e rregullta dhe periodike në vendlindje si një nga mënyrat e njohjes së vendit të originës dhe mekanizëm për të mbajtur gjallë interesin e brezit të ri të shqiptarëve në diasporë;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e këtij memorandumi për të përbushur angazhimet në kuadër të politikës shtetërore për diasporën shqiptare;

Kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandumi.

Neni 1

**Qëllimi dhe synimi**

1. Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i Programit “JAM SHQIPTAR” nëpërmjet nxitjes e organizimit të veprimtarive kulturore, gjuhësore dhe turistike për formimin kulturor, gjuhësor, njohjen me vendet turistike dhe historinë e Shqipërisë të pjesëmarrësve shqiptarë në diasporë për të përmirësuar dhe garantuar ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor si dhe trashëgiminë e këtyre vlerave brez pas brezi.
2. Nëpërmjet këtij memorandumi synohet:
  - a) lehtësimi i procedurave administrative për krijimin e Programit “JAM SHQIPTAR” si një strukturë e përbashkët kursesh të gjuhës dhe kulturës shqipe të certifikuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;



- b) sigurimin e stafit pedagogjik të përgatitur dhe të gatshëm për realizimin konkret të mësimin në kurset e gjuhës dhe kulturës shqipe;
- c) njohja e pjesëmarrësve të programit me vendlindjen apo vendin e origjinës si dhe promovimi i natyrës dhe i turizmit shqiptar duke i risjellë pjesëmarrësve në rrënjët e tyre të identitetit kombëtar;
- d) sigurimin e asistencës së ndërsjellët për zgjidhjen dhe mbarëvajtjen e infrastrukturës së realizimit të kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe, ose çdo lloj situatë të ardhshme të paparashikuar në këtë Memorandum.

## Neni 2

### Objekti i bashkëpunimit

1. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për hartimin dhe implementimin e Programit “JAM SHQIPTAR” nën drejtimin e Koordinatorit Shtetëror të caktuar me urdhër të kryeministrit. Ai do të jetë një strukturë kursesh të gjuhës dhe kulturës shqipe, për pjesëmarrësit shqiptarë në diasporë të moshës 11 deri në 17 vjeç, të cilët dëshirojnë të vizitojnë vendin e tyre të origjinës si dhe të njihen me natyrën, vendet turistike, mjedisin, traditat, kulturën, doket, zakonet, historinë shqiptare, gjuhën dhe letërsinë shqipe, si dhe parqet arkeologjike.
2. Kohëzgjatja e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe është maksimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë brenda periudhës qershor – shtator (ose edhe në periudha kohore për të cilat palët bien dakord). Në bazë të kërkesë – regjistrimeve të anëtarëve të diasporës mund të krijohen disa grupe konsektive.
3. Vendi ku do të zhvillohet do të përcaktohet me dakordësi midis palëve vit pas viti.

## Neni 3

### Roli dhe përgjegjësitë e palëve

1. Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi realizohet si vijon:

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

- a) Harton dhe miraton programin mësimor që do t'u ofrohet pjesëmarrësve të diasporës shqiptare që do vizitojnë vendin dhe do ndjekin kurset e gjuhës dhe kulturës shqipe duke u bazuar në komponentët e kulturës, historisë, letërsisë dhe gjuhës shqipe;
- b) Autorizon institucionet e varësisë të cilat kanë këtë objekt përgjegjësie për publikimin e informacionit lidhur me kurset e gjuhës dhe kulturës shqipe edhe në faqet e tyre zyrtare;



- c) Autorizon institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar për përfshirjen në aktivitetet e kurseve të numrit të mësuesve të domosdoshëm për mbarëvajtjen e veprimtarive të kurseve gjatë gjithë periudhës 15 (pesëmbëdhjetë) ditore, si dhe mbikëqyrjes dhe përkujdesjes për fëmijët që ndjekin programin e këtyre kurseve;
- d) Cakton një person kontakti i cili do të kujdeset për mbarëvajtjen e përgatitjes dhe më pas zhvillimit të aktiviteteve të kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe.

Ministri Shtetit për Diasporën:

- a) Bashkëpunon me ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike shqiptare me qëllim koordinimin e krijimit të listave të pjesëmarrësve si dhe lehtësimin e udhëtimit të pjesëmarrësve të mitur nga vendbanimi i tyre drejt Shqipërisë;
- b) Nëpërmjet Agjencisë Kombëtare për Diasporën koordinon me institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar në hartimin e listës së pjesëmarrësve në programin e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe;
- c) Koordinatori Shtetëror i Programit “JAM SHQIPTAR” nëpërmjet Agjencisë
- d) Kombëtare për Diasporën koordinon me Agjencinë Kombëtare të Turizmit në përgatitjen e itinerarin që do të ndjekin grupet e pjesëmarrësve në kurset e gjuhës dhe kulturës shqipe;
- e) Agjencia Kombëtare e Diasporës administron tarifën për çdo paketë turistike të paguar nga pjesëmarrësit në kurset e Programit “JAM SHQIPTAR” të cilat miratohen nga Koordinatori Shtetëror i Programit. Të gjitha të ardhurat e grumbulluara do të përdoren për mbulimin e kostove të aktiviteteve të kurseve të gjuhës dhe shkollës shqipe si dhe do të publikohen në një raport transparence brenda një muaji nga përfundimi i kurseve të fundit;
- f) Agjencia Kombëtare e Diasporës mbulon koston e dietave për mësuesit dhe personelin mbështetës të AKD-së të cilët mbikëqyrin aktivitetet e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe gjatë gjithë kohëzgjatjes dhe i publikon ato në raportin e transparencës dhe pranë Koordinatorit Shtetëror të Programit “JAM SHQIPTAR”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:

- a) Autorizon Agjencinë Kombëtare të Turizmit në bashkëpunim me tour operatorët/ agjencitë turistike, në përgatitjen e një pakete turistike për të gjetur një ofertë optimale, ku të jenë të përfshira destinacionet turistike, akomodimi, transporti dhe vaktet ushqimore (full board);
- b) Paketa turistike për kurset verore të gjuhës dhe kulturës shqipe koordinohet nga Agjencia Kombëtare e Turizmit në bashkëpunim me institucionet arsimore



- vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe Agjencinë Kombëtare të Diasporës;
- c) Agjencia Kombëtare e Turizmit në raste të veçanta, mund të kërkojë modifikimin e paketës turistike duke realizuar çdo kërkesë nga ana logjistike.

Ministria e Kulturës:

- a) Autorizon hyrjen falas në parqet arkeologjike, monumentet kulturore dhe muzetë kombëtare të cilët janë në varësi të Ministrisë së Kulturës, të pjesëmarrësve në kurset verore, pas listës së dërguar paraprakisht nga Agjencia Kombëtare e Diasporës;
- b) Ofron guidë turistike në parqet arkeologjike, muzetë dhe monumentet e kulturës;
- c) Ofron kurse dhe trajnime pranë muzeve/parqeve arkeologjike, si dhe kurse të mësimin të valleve tradicionale dhe këngëve popullore shqiptare pranë Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore;
- d) Mundëson, rast pas rasti, realizimin dhe koordinimin e aktiviteteve, sipas tipologjisë së institucionit, bazuar në programin e kurseve përkatëse pas dakordësisë së palëve.
2. Palët brenda 3 (tre) muajsh nga nënshkrimi i këtij memorandumi bien dakord për:
- a) Mënyrën e shpërndarjes së Certifikatës “JAM SHQIPTAR”.
- b) Krijimin e sekretarisë teknike me përfaqësues nga çdo institucion palë e këtij Memorandumi.

#### Neni 4

### Regjistrimi i pjesëmarrësve

1. Koordinator Shtetëror për Programin “JAM SHQIPTAR” dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës shpallin çdo vit, brenda muajit prill programin e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe, si dhe detajet logjistike.
2. Regjistrimi në programin e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe bëhet online ose meanë të email-it të vendosur në dispozicion: [summerschoolalbania@akd.gov.al](mailto:summerschoolalbania@akd.gov.al).
3. Koordinator Shtetëror për Programin “JAM SHQIPTAR” i dërgon listën përfundimtare me emrat e pjesëmarrësve, të ndarë sipas grup moshave, MASR-së dhe MK-së për caktimin e emësuesve dhe specialistëve të kulturës, të cilët do të zbatojnë programin e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe.





Neni 5

**Certifikimi i pjesëmarrësve**

1. Pajisen me certifikatë vetëm pjesëmarrësit që kanë ndjekur të plotë programin e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe në të gjitha komponentët e saj.
2. Certifikimi i pjesëmarrësve kryhet nga Koordinatori Shtetëror për Programin “JAM SHQIPTAR”, sipas modelit bashkëngjitur këtij Memorandumi.
3. Certifikatat për pjesëmarrësit që nuk arrijnë t’i marrin personalisht në fund të kurseve verore, i dorëzohen Agjencisë Kombëtare të Diasporës me qëllim dërgimin e tyre nëpërmjet ambasadave shqiptare të akredituara nëpër botë.

Neni 6

**Llojet e aktiviteteve**

Aktivitetet bazë që do të zhvillohen gjatë kurseve e gjuhës dhe kulturës shqipe të Programit “JAM SHQIPTAR”, janë si më poshtë:

- a) mësimet e gjuhës, kulturës, historisë dhe gjeografisë së Shqipërisë;
- b) ushtrime, seminare, lojëra interaktive;
- c) ekskursione ilustruese në parqe arkeologjike, muze kombëtarë, monumente të kulturës dhe zona turistike;
- d) aktivitete që kanë për qëllim vizitat turistike, promovimin e turizmit si dhe të natyrës dhe mjedisit të Shqipërisë;
- e) aktivitete kulturore (koncerte, ekspozita).

Neni 7

**Vlerësimi i zbatimit të memorandumit**

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim nga Koordinatori Shtetëror për Programin “JAM SHQIPTAR”, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara gjatë një viti edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara. Raporti publikohet në faqet zyrtare të Palëve.



Neni 8

**Komunikimi mes palëve**

1. Palët angazhohen të krijojnë një Sekretari Teknike nën drejtimin e Koordinatorit Shtetëror për Programin “JAM SHQIPTAR” të përbërë nga përfaqësues të Palëve të cilët do të realizojnë komunikimin dhe koordinimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti për realizimin e këtij Memorandumi.
2. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve.
- 3.

Neni 9

**Kostot ftnciare**

1. Dietat dhe akomodimi i mësuesve dhe personave të angazhuar për mbarëvajtjen e këtij procesi do të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.
2. Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Agjencia Kombëtare e Diasporës ka të miratuara.

Neni 10

**Ndryshimi i Memorandumit**

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 11

**Kohëzgjatja e Memorandumit**

Ky memorandum nënshkruhet për një afat kohor 3 (tre) vjeçar.

Neni 12

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.



Neni 13

**Hyrja në Fuqi**

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 8 (tetë) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Ministrit të Shtetit për Diasporën, dy pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dy pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe dy pranë Ministrisë së Kulturës.

Nënshkruar në Tiranë, në .., 2019.

**MINISTRI I SHTESTIT PËR DIASPORËN  
PANDELI MAJKO**

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
BESA SHAHINI**

**MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
BLENDI KLOSI**

**MINISTRI I KULTURËS  
ELVA MARGARITI**



**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE FAKULTETIT**  
**TË HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË UNIVERSITETI I TIRANËS PËR**  
**BASHKËPUNIMIN NË RUAJTJEN E GJUHËS DHE IDENTITETIT KOMBËTAR NË**  
**DIASPORË**

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë pranë Universitetit të Tiranës (Në vijim referuar si Palët);

Të inkurajuar nga dëshira për ruajtjen e identitetit gjuhësor kombëtar të komunitetit shqiptar në diasporë;

Me dëshirën për të promovuar trashëgiminë kombëtare;

Janë dakorduar si vijon:

Neni 1

**Qëllimi**

Palët angazhohen reciprokisht, në përputhje me kompetencat e tyre, të bashkëpunojnë me qëllim:

- a) nxitjen e hapjes së katedrës së gjuhës shqipe në Ukrainë, nëpërmjet Konsullatës së nderit të Republikës së Shqipërisë në Kharkiv, në bashkëpunim me Universitetin Pedagogjik të Kharkivit në Ukrainë;
- b) realizimin e aktiviteteve për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të komunitetit Shqiptar të Arbëreshëve të Italisë, të komunitetit Shqiptar në Karakurt dhe Zaporozhye të Ukrainës, komunitetit Shqiptar të Kroacisë, si edhe pranë komunitetit shqiptarë në Diasporë;
- c) ruajtjen e identitetit gjuhësor kombëtar, nëpërmjet studimit, prodhimit dhe shpërndarjes së veprave në gjuhën shqipe;
- d) ofrimin e kurseve dhe trajnimeve mbi gramatikën e gjuhës shqipe, për komunitetin shqiptar;
- e) bashkëpunimin me institucione të vendeve pritëse të komunitetit shqiptar për përfshirjen e gjuhës shqipe në arsimin parashkollor, primar dhe sekondar;
- f) organizimin e ekskursioneve dhe vizitave pranë komunitetit shqiptar;
- g) dhurimin e teksteve shkollore, abetare, fjalorë, si dhe të veprave letrare në gjuhën shqipe për komunitetin shqiptar;
- h) krijimin e një arkivi digjital publikisht të aksesueshëm për publikimin e veprave në gjuhën shqipe;
- i) ndërmarrjen e iniciativave të tjera në fushën e diasporës, që konsiderohen të nevojshme nga palët, në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje.



Neni 2

**Parimet e përgjithshme**

1. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimt reciprok. Palët kontribuojnë në zbatimin e kësaj marrëveshje në përputhje me mundësitë dhe kompetencat që kanë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Palët njohin interesin e përbashkët në promovimin dhe ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar nga komuniteti shqiptarë në diasporë.

Neni 3

**Bashkëpunimi në organizimin e veprimtarive për ruajtjen e gjuhës**

1. Palët do të nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë në organizimin e veprimtarive gjuhësore të përbashkëta.
2. Aktivitetet bashkëpunuese në kryerjen e veprimtarive gjuhësore përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) vënien në dispozicion të pedagogut të gjuhës shqipe për dhënien e mësimit të gjuhës shqipe pranë katedrës së gjuhës shqipe në Ukrainë, e cila do të hapet në kuadër të marrëveshjes së konsullatës së nderit të Republikës së Shqipërisë në Kharkiv në bashkëpunim me Universitetin Pedagogjik të Kharkivit në Ukrainë.
  - b) vënien në dispozicion të 2 (dy) mësuesve të gjuhës shqipe për dhënien e mësimit të gjuhës shqipe pranë komunitetit Shqiptar të Arbëreshëve të Italisë,
  - c) vënien në dispozicion të 2 (dy) mësuesve të gjuhës shqipe për dhënien e mësimit të gjuhës shqipe pranë komunitetit Shqiptar të Ukrainës;
  - d) vënien në dispozicion të 2 (dy) mësuesve të gjuhës shqipe për dhënien e mësimit të gjuhës shqipe pranë komunitetit Shqiptar të Kroacisë;
  - e) vënien në dispozicion të 2 (dy) mësuesve të gjuhës shqipe për dhënien e mësimit të gjuhës shqipe pranë komunitetit Shqiptar në Diasporë.
  - f) përcaktimin e programeve të veprimtarive dhe aktiviteteve që do të organizohen në përputhje me këtë marrëveshje;
  - g) prodhimin dhe shpërndarjen e veprave artistike dhe letrare në gjuhën shqipe;
  - h) krijimin e një arkivi digjital publikisht të aksesueshëm për publikimin e veprave në gjuhën shqipe;
  - i) forma të tjera bashkëpunimi në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje.



Neni 4

**Bashkëpunimi për arsimin dhe trajnimet**

Palët angazhohen për organizimin e kurseve në gjuhën shqipe dhe trajnimeve të avancuara përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit të cilat përfshijnë:

- a) ofrimin e kurseve dhe trajnimeve mbi gramatikën e gjuhës shqipe, për komunitetin shqiptar në diasporë;
- b) bashkëpunimin me institucione të vendeve pritëse të komunitetit shqiptar në diasporë për përfshirjen e gjuhës shqipe në arsimin parashkollor, primar dhe sekondar;
- c) dhurimin e teksteve shkollore, abetare, fjalorë si dhe veprave letrare në gjuhën shqipe për komunitetin shqiptarë në diasporë;
- d) forma të tjera bashkëpunimi që nuk përmenden në këtë marrëveshje, por janë në përputhje me qëllimin e saj.

Neni 5

**Konfidencialiteti dhe Pronësia Intelektuale**

1. Palët detyrohen reciprocikisht për konfidencialitetin në lidhje me informacionin, të dhënat dhe njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje, me vendimmarrjen e përbashkët të tyre.
2. E drejta e pronësisë intelektuale të një Pale do të mbetet në zotërim të plotë të saj me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe.
3. Të drejtat e pronësisë intelektuale në pronësi të një Pale mund të përdoret nga Palët e tjera për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje vetëm me pëlqimin e shprehur të Palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë dhe në përputhje me rregullat e treguara nga ajo Palë.

Neni 6

**Përpunimi i të dhënave personale**

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike vetëm për qëllimet që lidhen me këtë Marrëveshje.



Neni 7

**Format e bashkëpunimit**

Palët janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte të tjera që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

**Përgjegjësia**

Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta.

Neni 9

**Kohëzgjatja, procedura e rinovimit dhe e drejta e tërheqjes**

1. Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.
2. Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje të pa caktuar. Rast pas rasti për aktivitetet nga të dyja palët do të hartohet një aneks kontratë.
3. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas një (1) muaji nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për tu tërhequr nga lidhja e kësaj marrëveshjeje. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshjeje nuk prodhon efekte mbi marrëdhëniet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshje ka qënë në fuqi.

Neni 10

**Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve.



Neni 11

**Gjuha e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në tri kopje.

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
TË DIASPORËS**

**DREJTORI EKZEKUTIV**

**ETLEVA KONDI**

**PËR FAKULTETIN E HISTORISË  
DHE FILOLOGJISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS**

**DEKANI**

**SABRILAÇI**





**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**MIDIS AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE TEATRIT KOMBËTAR**  
**TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË PËR BASHKËPUNIMIN NË RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E**  
**IDENTITETIT KULTUROR KOMBËTAR NË DIASPORË**

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor i Republikës së Shqipërisë, (referuar si “Palët”);

Duke patur parasysh objektin e veprimtarisë së palëve parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi;

Të nxitur nga dëshira për të ruajtur identitetin dhe trashëgiminë kulturore kombëtare të komunitetit shqiptar në diasporë;

Me dëshirën për të promovuar artin dhe kulturën shqiptare në diasporë;

Duke marrë në konsideratë forcimin e bashkëpunimit artistik dhe kulturor mes dy institucioneve;

Duke vlerësuar rëndësinë që kjo marrëveshje bashkëpunimi sjell në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet palëve, për të përcjellë në diasporë kulturën dhe identitetin folklorik;

Janë dakorduar si vijon:

Neni 1

**Qëllimi**

Palët angazhohen reciprokisht, në përputhje me kompetencat e tyre, të bashkëpunojnë me qëllim:

- a) realizimin e aktiviteteve për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kombëtare dhe kulturore të komunitetit shqiptar të Arbëreshëve të Italisë, të komunitetit shqiptar të Ukrainës, si edhe të komunitetit shqiptar të Kroacisë, por pa ukufizuar nëto;
- b) ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor, nëpërmjet ofrimit të kurseve dhe trajnimeve për mësimin e vlerave popullore dhe këngëve folklorike shqiptare për komunitetet shqiptare në diasporë;
- c) organizimin e ekskursioneve dhe realizimin e vizitave studimore të komunitetit shqiptar në Shqipëri;
- d) krijimin e një arkivi digjital publikisht të aksesueshëm për mësimin e vlerave popullore;
- e) ndërmarrjen e iniciativave të tjera në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në diasporë, që konsiderohen të nevojshme nga palët, në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje.



Neni 2

**Bashkëpunimi për kurse dhe trajnime**

Palët angazhohen për organizimin e kurseve në fushën e kulturës dhe trajnimeve të avancuara përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit të cilat përfshijnë:

1. vënien në dispozicion të një Grupi të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore për dhënien e mësimit të valleve popullore pranë komunitetit shqiptar të Arbëreshëve të Italisë,
2. komunitetit shqiptar të Ukrainës dhe pranë komunitetit shqiptar të Kroacisë, por pa u kufizuar në to;
3. bashkëpunimin me institucione të vendeve pritëse të komunitetit shqiptar në diasporë për përfshirjen e mësimit të valleve popullore dhe këngëve folklorike në këto vende;
4. krijimin e klasave të posaçme të mësimit të valleve popullore shqiptare dhe këngëve folklorike;
5. forma të tjera bashkëpunimi që nuk përmenden në këtë marrëveshje, por janë në përputhje me qëllimin e saj.

Neni 3

**Bashkëpunimi për organizimin e veprimtarive kulturore**

1. Palët do të nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë në organizimin e veprimtarive kulturore të përbashkëta.
2. Aktivitetet bashkëpunuese në kryerjen e veprimtarive kulturore përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) organizimin e një koncerti të përbashkët ndërmjet Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe pjesëtarëve të komunitetit që kanë marrë pjesë në kurset e mësimit të valleve dhe këngëve folklorike shqiptare;
  - b) përcaktimin e programeve të veprimtarive dhe aktiviteteve që do të organizohen në përputhje me këtë marrëveshje;
  - c) organizimin e ekskursioneve dhe realizimin e vizitave studimore në Shqipëri për pjesëtarët e komunitetit që kanë marrë pjesë në kurset e mësimit të valleve dhe këngëve folklorike shqiptare;
  - d) krijimin e një arkivi digital publikisht të aksesueshëm për publikimin e veprave artistike muzikore në gjuhën shqipe;
  - e) forma të tjera bashkëpunimi në përputhje me qëllimin ekësaj marrëveshjeje.
3. Palët do të bien dakord me shkrim, nëpërmjet një aneksi të kësaj marrëveshjeje,



për çdo aktivitet që do të organizohet në zbatim të kësaj marrëveshje dhe në përputhje me qëllimin e saj.

Neni 4

#### **Format e bashkëpunimit**

Palët janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk përfshihet forma të tjera bashkëpunimi të secilës prej tyre me palë të treta, për të njëjtin objekt dhe qëllim me këtë marrëveshje.

Neni 5

#### **Përgjegjësia**

Palët nuk kanë përgjegjësi për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta dhe që vijnë nga zbatimimi i kësaj marrëveshje.

Neni 6

#### **Ndryshimi i marrëveshjes**

Dispozitat e kësaj marrëveshje mund të ndryshohen me anë të pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të palëve.

Neni 7

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë nga interpretimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Neni 8

#### **Kohëzgjatja dhe e drejta e tërheqjes**

1. Marrëveshja lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.
2. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas gjashtë (6) muajsh nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për t'u tërhequr nga lidhja e kësaj marrëveshje. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshje nuk prodhon efekte mbi marrëdhëniet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshje ka qenë në fuqi.



Neni 9

**Gjuha e marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në katër kopje.

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
TË DIASPORËS**

**PËR TEATRIN KOMBËTAR TË  
OPERAS, BALETIT DHE  
ANSAMBLIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**DREJTOR EKZEKUTIV  
ETLEVA KONDI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
ZANA ÇELA**



**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET FONDACIONI “MAGNA GRECIA” DHE FONDI SHQIPTAR PËR**  
**ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Kjo MARRËVESHJE, e datës 18 Prill, 2019 (“FA”), lidhet ndërmjet, Fondacioni Magna Grecia, (ne vijim FMG), regjistruar në Romë, Itali, më datë 18 Maj 1986, me seli qëndrore në Romë, në Largo Fontanella di Borghese 84, Itali, Kodi Fiskal 97546360583 dhe Nipti. 11060011001 drejtuar nga Presidenti Hon. Antonino Foti, dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, me seli qëndrore në Tiranë - Shqipëri, rruga: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1.1000, me Nipt. L82224452L, (ne vijim FSHZHD) drejtuar nga Drejtoresha Ekzekutive Znj. Soana Jaupllari.

(Në vijim të quajtura “Palë”)

**PARASHTRIME**

- FMG është një organizatë ndërkombëtare me natyrë “think tank”, e vendosur në Romë, që prej vitit 1986, e cila promovon rritjen dhe zhvillimin e Italisë, dhe në veçanti të rajoneve jugore, nëpërmjet projekteve dhe iniciativave të fushave sociale, ekonomike dhe inovative, gjithashtu në bashkëpunim me Universitete, Qendra Kërkimore, Institucione, kompani publike dhe private;
- FMG është një organizatë jofitimprurëse, e cila është në statusin e Personit Juridik, dekretuar në 10 shkurt, 2000, Nr. 361;
- Përkrah objektivave institucionale, FMG promovon marrëdhëniet ndërmjet Italisë dhe komuniteteve me origjinë Italiane në botë, nëpërmjet projekteve kulturore dhe projekteve në turizëm;
- Më 19 dhjetor 2018, është nënshkruar një marrëveshje 3-vjeçare midis FMG dhe Universitetit Telematik e-Campus, një Universitet Italian i autorizuar me D.M. 30.01.2006 e cila mund të aktivizojë dhe ofrojë kurse diplome dhe kurse të mësimin në distancë duke shfrytëzuar teknologjitë informative dhe telematike, në mënyrë që të mbështesin kërkimin, inovacionin dhe trajnimin e FMG;
- FSHZHD është një institucion publik shqiptar, i cili menaxhon projekte të financuara nga Këshilli



- Ministrave ose donatorë të tjerë, në përputhje me fushëveprimin e veprimtarisë së saj bazuar në kushtet e parashikuara në marrëveshjen përkatëse;
- që, në përputhje me misionin e saj FSHZHD ka objektivat e mëposhtme: të mbështesë anëtarët e diasporës shqiptare për të siguruar integrimin e tyre të plotë në vendin pritës dhe për të nxitur shkëmbimin e programeve në lidhje me çështjet arsimore dhe kulturore; forcimi i bashkëpunimit me organizata të tjera jofitimprurëse dhe organizata filantropike, të cilat janë aktive në zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturor;
- Palët janë të interesuara të fillojnë bashkëpunime të reja dhe të përmirësojnë ato ekzistuese me institucione publike dhe private, kombëtare ose ndërkombëtare që janë aktive në fushat e projekteve, ekspertizës, kërkimeve shkencore dhe studimeve me fokus Diasporën, promovimin e edukimit dhe praktikave në fushën e udhëheqjes së karrierës, shkëmbimin e mundësive në punësim, në kulturë, në shkencë dhe në njohuri teknologjike;
- FSHZHD, duke konsideruar lidhjet dhe përvojat e përbashkëta të rrugëve historike të migracionit italian dhe shqiptar dhe duke marrë parasysh aktivitetet institucionale të promovuara gjatë kohës nga Fondacioni Magna Grecia, e njeh si FMG si një partner të duhur për të mbështetur programet e saj që synojnë Diasporën Shqiptare në Itali;
- Të bindur se shkëmbimi i eksperiencave dhe aktiviteteve të përbashkëta janë bazuar në marrëdhëniet reciproke tradicionale Itali – Shqipëri,

Palët kanë rënë si më poshtë:

#### Neni 1

#### **Preambul**

1. Parashtrimet janë pjesë integrale dhe thelbësore e këtij akti;
2. Klauzolat e kësaj marrëveshjeje private duhet të interpretohen në përputhje me qëllimet e palëve, sipas parashtrime të sipërcituara;



Neni 2

**Qëllimet**

Palët bien dakord që iniciativat mund të ndërmerren për qëllimet e mëposhtme:

1. Bashkëpunimi shkencor

- a) të kryejnë studime dhe hulumtime me qëllim të zhvillimit të njohurive dhe mundësive të aplikimit të praktikave inovative me interes social;
- b) të krijojnë, në partneritet, një Observator që monitoron komunitetin shqiptar në Itali dhe ofron informacion të dobishëm për proceset vendimmarrëse të FSHZHD-së, duke analizuar gjithashtu praktikat më të mirandërkombëtare;
- c) të promovojnë krijimin e një rrjeti për zbatimin e programeve dhe projekteve, gjithashtu me përdorimin e fondeve evropiane;
- d) të arrijnë qëllime reputacionale përmes fushatave mbështetëse dhe aktiviteteve promovuese;
- e) të nxisin aktivitete trajnuese, kurset edukimi dhe/ose rikualifikimi të punonjësve, tashmë të angazhuar ose që mund të riintegrohet në aktivitete produktive, ndërhyrje për të lehtësuar integrimin dhe përfshirjen në tregun e punës, me një fokus të veçantë ndaj anëtarëve të Diasporës Shqiptare;
- f) të nxisin pjesëmarrjen e përbashkët në spin-off, me qëllim nxitjen e sipërmarrjes së të rinjve të diplomuar/doktorantëve, veçanërisht ndaj anëtarëve të Diasporës Shqiptare;

2. Bashkëpunimi në fushën e kulturës

- a) Organizimin e konferencave dhe takimeve mbi çështje që lidhen me identitetin kulturor të diasporës;
- b) Realizimin e vizitave të përbashkëta arsimore dhe praktikave drejtuar studentëve në vendet respektive;
- c) Planifikimin e aktiviteteve për promovimin e publikimeve në fushën e Diasporës;
- d) Bashkëpunimi në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve kulturore me interes të përbashkët në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat aderohet palët;



### Neni 3

#### **Komiteti Operacional (ose ndryshe emërtuar Sekretariati Teknik)**

- Për implementimin e aktiviteteve referuar ne Nenin 2, Palët përcaktojnë personat përgjegjës me detyrën për të përkufizuar linjat e veprimit të përbashkët, duke verifikuar në mënyrë periodike zbatimin e tyre.
  - Për koordinimin e aktiviteteve bashkëpunuese të përmendura në këtë Marrëveshje, palët bien dakord të krijojnë një Sekretariat teknik të përbashkët të përbërë nga 2 (dy) përfaqësues për secilën palë. Ai kryen këto detyra:
    - Koordinon aktivitetet e përbashkëta;
    - Planifikon aktivitetet vjetore;
    - Monitoron nismat e përbashkëta të kryera në bashkëpunim dhe harton raportime të rregullta
    - për progresin e tyre tek drejtuesit e Palëve;
    - Anëtarët e Sekretariatit Teknik do të njoftohen nga njëra palë tek tjetra, me një komunikim të posaçëm formal brenda 15 ditësh nga firmosja e kësaj Marrëveshjeje.
3. Referuar dokumentit “Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe Migrimin 2018 – 2024 dhe Plani i Veprimit”, publikuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën,

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

1. FMG deklaron vullnetin e saj për t'i bërë propozime operationale FSHZHD-së, nën kornizën e masave në dokumentin e mësipërm, të identifikuar sipas këtyre numrave: 26, 29, 32, 33, 34, 36, 41, 42, 46, 53, 54, 68 dhe merr përsipër të bëjë këto propozime formalisht deri në datën 31 Gusht, 2019;
2. FSHZHD nga ana tjetër garanton FMG prioritetin ndaj projekt propozimeve referuar sipas pikave paraprake, se merr përsipër të mosvlerësojë propozimet e palëve të treta, deri në datën e shuarjes së këtij prioriteti.

### Neni 4

#### **Konventat dhe Marrëveshjet Operative**

1. Palët bien dakord të zbatojnë iniciativat e identifikuar kohë pas kohe dhe brenda qëllimit të objektivave të shprehura në nenin.2, ndërmjet Palëve, konventa specifike dhe marrëveshje operationale do të hartohen me metodologji





specifike të zbatimit, të propozuara nga komiteti operativ dhe në përputhje me marrëveshjen aktuale kornizë dhe rregulloret në fuqi;

Konventat dhe marrëveshjet operative do të rregullojnë mënyrat në të cilat do të kryhet bashkëpunimi midis Palëve, duke specifikuar në veçanti aspektet teknike, shkencore, organizative, menaxheriale dhe financiare në lidhje me përdorimin dhe pronësinë e rezultateve të bashkëpunimit, si dhe aspekte specifike të sigurisë;

#### Neni 5

#### **Shpenzim**

1. Kjo marrëveshje nuk sjell ndonjë shpenzim specifik të palëve. Çdo shpenzim do të përcaktohet në konventat individuale dhe marrëveshjet operative të referuara në nenin 4 i cili do të identifikojë strukturën organizative të secilës palë në të cilën do të ngarkohen këto shpenzime, në varësi të verifikimit të ekzistencës dhe disponueshmërisë së fondeve përkatëse;

#### Neni 6

#### **Të drejtat e pronësisë intelektuale**

1. Palët marrin përsipër, secila për marrëdhëniet e saj të kompetencës, të sigurojnë që të gjithë subjektet e përfshira në projektet bashkëpunuese shkencore, të mbuluara nga kjo marrëveshje shprehin në mënyrë specifike bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë në botimet shkencore, duke i evidentuar në të gjitha komunikimet për publikun: në veçanti nëpërmjet publikimeve të përbashkëta shkencore, pjesëmarrjes në konferenca, aktivitete edukative dhe trajnuese që rezultojnë nga veprimtari të tilla;
2. Palët do të shqyrtojnë së bashku, në bazë të kontributeve aktuale, mundësinë për të vazhduar me paraqitjen e patentave që lidhen me rezultatet e gjetjeve shkencore, që rezultojnë nga projektet bashkëpunuese, në përputhje me të drejtat ligjore të shpikësve;
3. Në çdo rast, nëse nuk është rënë dakord ndryshe në konventat dhe marrëveshjet operative të përmendura në nenin 4, pronësia intelektuale në lidhje me metodologjitë dhe studimet, që rezultojnë nga projektet bashkëpunuese, do të njihet në bazë të kontributit të secilës palë. Përsa i përket pronësisë së produkteve, rezultat i projekteve bashkëpunuese, përcaktimi i pronësisë do të jetë objekt i një marrëveshjeje të veçantë brenda marrëveshjeve operative të lartpërmendura



Neni 7

**Kohëzgjatja dhe rinovimi i marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje ka një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh duke filluar nga data e hyrjes në fuqi nga të dyja palët dhe mund të rinovohet pas një marrëveshjeje pasuese me shkrim ndërmjet palëve, me vendim të organit kompetent, me përjashtim të rastit kur anulohet me letër të regjistruar 3 (tre) muaj para kohës së vlefshmërisë;
2. Garancia e kompletimit të aktiviteteve në progres në kohën e shuarjes të kësaj marrëveshjeje, si dhe pjesëmarrja në shpenzimet e ndërrmarra në datën e shuarjes, të cituara në nenin 4 dhe 5, është e rezervuar;
3. Në përfundim të kësaj marrëveshjeje palët në bashkëpunim do të hartojnë një raport vlerësimi për aktivitetet e kryera dhe rezultatet e arritura; në rast të rinovimit, kjo do të shtohet në programin për objektivat e ardhshme që duhen arritur.

Neni 8

**Tërheqja ose Përfundimi**

1. Palët kanë të drejtë të tërhiqen në mënyrë të njëanshme nga kjo Marrëveshje ose me marrëveshje konsensuale; tërheqja duhet të bëhet me anë të një komunikimi me shkrim të njoftuar përmes PEC (shërbimi i vërtetuar i postës) dhe / ose me letër të regjistruar vajtje-ardhje, 3 (tre) muaj para dates së tërheqjes;
2. Tërheqja do të hyjë në fuqi tre muaj nga data e njoftimit të saj;
3. Tërheqja e njëanshme ose zgjidhja e memorandumit do të ketë efekt për aktivitetet e ardhshme, projektet etj., dhe nuk ndikojn në asnjë pjesë të marrëveshjes për ato të kryera;
4. Në rastin e tërheqjes së njëanshme ose zgjidhjes së memorandumit, palët bien dakord, të përfundojnë aktivitetet në progres dhe marrëveshjet individuale dhe operative të përcaktuara tashmë në datën e përfundimit të marrëveshjes, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë dokument.

Neni 9

**Konfidencialiteti**

Palët marrin përsipër, përmes procedurave përkatëse, të mos bëjnë publike; të dhëna, lajme dhe informacione konfidenciale, të fituara si rezultat dhe në lidhje me aktivitetet e mbuluara nga marrëveshja.



Neni 10

### **Trajtimi i të dhënave personale**

Palët angazhohen reciprokisht për të përpunuar dhe ruajtur të dhëna dhe informacione, si ato në letër dhe të dhëna elektronike, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarive që lidhen me këtë marrëveshje dhe me konventat dhe marrëveshjet operative sipas nenit. 4, në përputhje me masat dhe detyrimet e vendosura nga direktivat e BE-së për Rregullimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Globale, Legjislacioni i datës 30.6.2003, nr. 196, "Code regarding the protection of personal data" and ss.mm.ii.

Neni 11

### **Zgjedhja e Mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet për interpretimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me mirëkuptim të ndërsjellë përmes diskutimeve të ndërsjellta.

Neni 12

### **Nënshkrimi i Marrëveshjes**

Ky Akt, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) fletë është hartuar në dy kopje dhe do të nënshkruhet në eventin e përcaktuar, në përputhje me Dekretin Presidencial, nr. 131, datë 26.04.1986, sipas legjislacionit respektiv të palës e cila do të kërkojë regjistrimin.

Palët sipas kësaj Marrëveshjeje, përbërë nga 7 (shtatë) fletë, përfshirë këtë, konfirmojnë në mënyrë të shprehur dhe të pakushtëzuar pajtueshmërinë e tyre, me të gjithë klauzolat e përfshira në të, nëpërmjet nënshkrimeve të mëposhtme:

**FONDACIONI MAGNA GRECIA  
PRESIDENTI I FMG  
ANTONINO FOTI**

**MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN  
MINISTËR  
PANDELI MJAKO**

**FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS  
DREJTORI EKZEKUTIV  
SOANA JAUPLLARI**



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**MIDIS FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE KOLEGJIT UNIVERSITAR PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI,**  
**KOSOVË**

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD) dhe Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Kosovë, në vijim referuar si “Palët”

Me dëshirën për të bashkëpunuar në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe Inovacionit, si dhe duke patur parasysh që:

Kolegji UBT është institucion themeluar mbi disa vlera thelbësore si nxitja e mësimdhënies, hulumtimit dhe inovacionit, promovimin e vlerave, standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të cilësisë, krijimin e një mjedisi dinamik icili nxit zhvillimin në nivel individual dhe atë profesional;

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për Diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të Diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj;

Nisur dhe nga interesi i të dy organizmave për krijimin e mjeteve për të promovuar bashkëpunimin konkret në fushën kërkimore shkencore dhe arsimore mes institucioneve, bazuar në mundësinë për të zhvilluar aktivitete kërkimore dhe trajnuese, si dhe në promovimin e çdo bashkëpunimi në fushën shkencore, të dobishëm për realizimin më të mirë të qëllimeve përkatëse institucionale, gjithashtu me përfshirjen e subjekteve të tjera publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime të inovacionit dhe shfrytëzimit të rezultateve;

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

**Objekti**

1. UBT dhe FSHZHD, pajtohen të themelojnë dhe të zbatojnë projekte, programe dhe aktivitete në fusha të ndryshme në përputhje me misionin e tyre ;
2. UBT do të asistojë FSHZHD në dhënien e ekspertizës profesionale me qëllim



arritjen në një shkallë të suksesshme në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimore, veçanërisht në: ide, projekte, pilot –projekte, programet e caktuara, që janë segmente të rëndësishme të angazhimit me këtë memorandum;

## Neni 2

### Parime të përgjithshme

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të interpretohen në përputhje me parimin e bashkëpunimit insitucional dhe atij akademik;
2. Në mënyrë që të arrihen më mirë qëllimet e tyre institucionale, palët njohin interesin e përbashkët për të ruajtur dhe zhvilluar format e bashkëpunimit për të kryer kërkime, mësimdhënie, zhvillimin teknologjik dhe inovacionit, në aktivitete të mësimdhënies dhe trajnimit, si dhe për ofrimin e shërbimeve për të mbështetur aktivitetet kërkimore.
3. Palët synojnë të identifikojnë modele të reja dhe strategji për të forcuar lidhjen me territorin, duke përfshirë edhe në aspektin social dhe kulturor, duke eksperimentuar me forma të reja të komunikimit dhe përhapjen e njohurive të teknologjisë së lartë dhe përvojës brenda komunitetit lokal.
4. Palët marrin përsipër të vlerësojnë mundësinë e realizimit të formave të lëvizshmërisë së studentëve, të stafit mësimdhënës dhe hulumtues, si dhe të aktiviteteve të orientimit universitar;
5. Çdo propozim për aktivitete të përbashkëta duhet të aprovohet paraprakisht nga të dy institucionet. Pasi të pranohet propozimi, të dy institucionet caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e aktivitetit.

## Neni 3

### Qëllimi

1. Palët angazhohen reciprokisht, në përputhje me ligjet e tyre përkatëse dhe brenda kompetencave të tyre, të bashkëpunojnë me qëllim:
  - a) Identifikimin e prioriteteve për formulimin dhe zhvillimin e projekteve të mësimdhënies dhe orientimit në hyrje, hulumtim dhe zhvillim, të identifikuara edhe përmes një analize të kujdesshme të kërkesës së shprehur nga komponentët e ndryshëm të realitetit social, ekonomik dhe industrial, si dhe në bashkëpunim me universitetet etjera dhe institucionet kërkimor
  - b) Realizimin e mobilitetit të studentëve, mësimdhënies dhe hulumtimit;
  - c) Planifikimin e kurseve të përbashkëta të trajnimit ose sigurimin e njohjes



- së aktiviteteve arsimore në përputhje me rregulloret në fuqi në të dy vendet;
- d) Hartimin, zbatimin dhe aktivizimin e kurseve ndërkombëtare të doktoratës;
  - e) Shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit, transferimin teknologjik dhe inovacionin, duke favorizuar ndërveprimet me sistemin industrial dhe territorial;
  - f) Kryerjen e veprimtarive arsimore, kërkimin dhe shpërndarjen e rezultateve të aktiviteteve kërkimore nga profesorët.
2. Këto veprime do të zhvillohen duke favorizuar bashkëpunimet dhe sinergjitë e përshtatshme me Organet dhe Agjencitë Kombëtare, me sistemin industrial dhe me çdo organ tjetër që tregon interes për të marrë pjesë.
  3. Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të qeveriset nga dispozitat e parashikuara:
    - a) në këtë Marrëveshje;
    - b) në Aktet Operative individuale të përshkruara më poshtë;
    - c) në të gjitha dispozitat e zbatueshme.

#### Neni 4

#### **Bashkëpunimi për aktivitetet kërkimore, zhvillimore dhe inovative**

1. Palët do të nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë në kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje, palët mund të pajtohen me tema specifike të hulumtimit.
2. Këto forma të bashkëpunimit mund të arrihen përmes përcaktimit të akteve operacionale të parashikuara më poshtë, duke identifikuar strukturat shkencore të secilit trup të përfshirë në projekt. Secili akt duhet të miratohet nga Palët sipas ligjeve të tyre të brendshme.
3. Aktivitetet bashkëpunuese në kryerjen e partneriteteve të projekteve specifike mund të përfshijnë, si më poshtë:
  - a) përcaktimin e programeve afatmesme në kërkimin dhe zhvillimin e projekteve të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit, për pjesëmarrje të përbashkët në Programet e Kornizës Evropiane, përveç formulimit të propozimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
  - b) bashkëpunim në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare në të cilat marrin pjesë palët;
  - c) studimin dhe eksperimentimin e shërbimeve inovative për shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit, transferimin e teknologjisë dhe financimin e fillimit të inovacionit;
  - d) promovimin, krijimin, rritjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja të biznesit dhe produkteve të reja që mbështesin dinamizmin e inovacionit në territoret



- e përfshira dhe eksperimentojnë me një model inovativ;
- e) nxitjen e aktiviteteve për përhapjen e kulturës shkencore dhe teknologjike në territor;
  - f) Shkëmbimin e ekspertizës ndërmjet institucioneve respektive;

#### Neni 5

#### **Bashkëpunimi në fushën e arsimit, kulturës dhe trajnimeve të avancuara**

- a) Në kontekstin e bashkëpunimit në aktivitetet didaktike dhe të trajnimit, palët deklarojnë disponueshmërinë e tyre për të kryer aktivitete të përbashkëta si më poshtë, por pa u kufizuar vetëm në to:
- b) Informimi, mbështetja dhe përkrahja e kandidateve potencial për të studiuar në UBT;
- c) mbështetja për zhvillimin e tezave dhe projekteve për arritjen e diplomave të nivelit baçelor, master, doktoraturë, si dhe kryerjen e praktikave mësimore;
- d) organizimi i vizitave edukativo - arsimore dhe praktikave të studentëve;
- e) organizimi i konferencave, debateve, seminareve, tryezave dhe aktiviteteve të tjera me interes të përbashkët;
- f) organizimi i aktiviteteve të përbashkëta akademike;
- g) bashkëpunimi në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat aderojnë palët;
- h) organizimin e eventeve edhe në sinergji me organe të tjera;
- i) të favorizojë aktivitetet e punës praktike të rregulluara me një marrëveshje specifike të përcaktuar në bazë të legjislacionit aktual;
- j) UBT do të ofroj bursa studimi për të gjithë studentët e shkëlqyer nga diaspora të cilat do të përcaktohen me vendim të veçantë, në mënyrë që të kontribuojnë në edukimin cilësorë të rinisë;
- k) Përkrahja e të rinjve në ngritjen e kompetencave profesionale, nëpunësim, sipërmarrje dhe aktivitete të tjera inovative, kulturore dhe artistike. Ngjashëm vlen edhe për grupet tjera të komunitetit me interes të veçantë për zhvillimin e shoqërisë, specifikiisht siç janë femrat, etj.;
- l) Përkrahjen e FSHZHD-së në ngritjen e kapaciteteve dhe performancës konform kërkesave aktuale, praktikave më të mira të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, duke ofruar trajnime, këshillime, certifikime, hulumtime, analiza dhe në përgjithësi studime fizibiliteti;
- m) Organizimin e eventeve me interes të përbashkët;
- n) Përgatitja dhe pjesëmarrja e përbashkët në projekte zhvillimore në kontekst



- lokal, rajonal, evropian dhe ndërkombëtar, projekte ndërkufitare, si dhe projekte tjera me interes për zhvillimin e diasporës;
- o) Përkrahja me ekspertizë në përgatitjen e dokumenteve dhe raporteve të nevojshme;
  - p) Implementimin e Standardeve dhe rregullave teknike, etj.

#### Neni 6

#### **Komiteti i përbashkët drejtues**

1. Për koordinimin e aktiviteteve bashkëpunuese të përmendura në këtë Marrëveshje, palët bien dakord në krijimin e një komiteti të përbashkët drejtues, i përbërë nga dy përfaqësues për secilën palë. Komiteti emëron Kryetarin e tij; në rast të një votimi të barabartë, Kryetar emërohet anëtari më i vjetër që ka mbledhur shumicën e votave.
2. Komiteti gjithashtu takohet, në mënyrë telematike, me një nga Palët dhe harton një rregullore për funksionimin e tij.
3. Komiteti mbetet në detyrë për kohëzgjatjen e Marrëveshjes dhe rimërohet në rast të rinovimit të Marrëveshjes.
4. Anëtarët e Komitetit nuk shpërblehen për anëtarësinë e tyre. Çdo shpenzim për misionin e anëtarëve do të mbulohet nga Enti i anëtarësisë përkatëse.
5. Komiteti ka këto detyra:
  - a) koordinon aktivitetet bashkëpunuese;
  - b) planifikon ndërhyrjet në baza trevjeçare;
  - c) monitoron nismat e përbashkëta të kryera në bashkëpunim dhe harton raporte të rregullta për progresin e tyre tek organet kompetente të Palëve;
  - d) përcakton individët të cilët do të ndjekin këto aktivitete, trajnime etj.

#### Neni 7

#### **Aktet Operative**

Palët bien dakord mbi zbatimin e projekteve kërkimore, aktiviteteve trajnuese, orientimit në studime, orinetimit profesional dhe në karrierë, iniciativave që kanë për qëllim rritjen e rezultateve të kërkimit shkencor dhe të çdo aktiviteti tjetër me interes të përbashkët, nëpërmjet përcaktimit të akteve operative, identifikimit të strukturave të studimeve shkencore të çdo Pale të përfshirë në projekt ose iniciativë të përbashkët. Secili akt duhet të miratohet nga Palët sipas ligjeve të tyre të brendshme.





Neni 8

**Konfidencialiteti dhe Pronësia Intelektuale**

1. Palët detyrohen reciprokisht për kufizimet e fshehtësisë në lidhje me informacionin, të dhënat dhe njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të atij informacioni, të dhënave, lajme dhe vendime për të cilat ligji ose një urdhër administrativ ose gjyqësor imponon një detyrim për të komunikuar dhe/ose për të marrë miratimin e Palës nga e cila vijnë këto të dhëna.
2. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale në pronësi të një Pale do të mbetet në pronësi të plotë të saj dhe përdorimi i saj që i lejohej Palëve të tjera sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të nënkuptojë njohjen e ndonjë licence apo të drejte në lidhje me këtë të drejtë, me përjashtim të rasteve kur transferimi i kësaj licence ose të drejte është parashikuar shprehimisht në aktet operative.
3. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale në pronësi të një Pale mund të përdoret nga Palët e tjera për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje vetëm me pëlqimin e shprehur të Palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë dhe në përputhje me rregullat e treguara nga ajo Palë dhe/ose të përfshira në aktet operative.

Neni 9

**Të dhënat personale**

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale në përputhje me legjislacionin aktual për mbrojtjen e të dhënave personale; të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike vetëm për qëllimet që lidhen me këtë Marrëveshje.

Neni 10

**Format e bashkëpunimit**

Palët kanë rënë dakord që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

**Kohëzgjatja**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e përfaqësuesve të të dy Institucioneve.



2. Kjo marrëveshje është e vlefshme për një afat të pacaktuar.
3. Palët mund t'i japin fund në mënyrë të njëanshme dhe në çdo kohë kësaj marrëveshjeje, për arsye legjitime. Për ta bërë këtë, ato do të duhet të bëjnë kërkesë e tyre me shkrim se dëshirojnë ta ndërpresë bashkëpunimin, gjashtë muaj para.
4. Në rast të anulimit apo mos vazhdimit të marrëveshjes, aktivitetet e filluara duhet të përfundohen.

#### Neni 12

#### **Mosmarrëveshjet**

1. Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve.
2. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe UBT nuk janë përgjegjës për mosmarrëveshjet që mund të ketë pala tjetër me personat e tretë.

#### Neni 13

#### **Nënshkrimi**

1. Kjo Marrëveshje hartohet 2 kopje për secilën palë dhe firmoset sot, datë në

**PËR UBT-NË**  
**PRESIDENTI**  
**PROF. DR. EDMOND HAJRIZI**

**PËR FSHZHD-NË**  
**DREJTORI EKZEKUTIV**  
**PROF. ASSOC. DR. SOANA JAUPLLARI**



**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS DHE**  
**INSTITUTIT "ALB-SHKENCA" PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E KËRKIM-**  
**ZHVILLIMIT DHE TË BASHKËVEPRIMIT ME DIASPORËN SHKENCORE**  
**SHQIPTARE**

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FShZhD) dhe Instituti i studiuesve shqiptarë "Alb-shkenca" (IASh), të udhëhequr nga vullneti dhe dëshira për të realizuar një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të Shqipërisë dhe trojeve shqipfolëse, bien dakort për të bashkëpunuar në kuadrin e kësaj marrëveshje.

FShZHD është një agjenci shtetërore në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe IASh është një strukturë shkencore joqeveritare e jofitimprurëse që bashkon studiues të të gjitha disiplinave nga diaspora e nga mbarë trojet shqiptare në Ballkan, me qendra në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

FShZHD dhe IASh, të quajtur në vijim "Palët", me dëshirën për të bashkëpunuar në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e konferencave shkencore, botimeve dhe studimeve në funksion të interesit dhe përftimit të përbashkët, bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

**Qëllimi**

1. Palët, me angazhim të ndërsjellë, e në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojnë me qëllim të:
  - a) Realizimit të botimeve të përbashkëta në fushën e diasporës për interesa studimore dhe arsimore;
  - b) Organizimit të konferencave apo trajnimeve mbi çështje që lidhen me kërkim-zhvillim në bashkëveprim me diasporën shkencore;
  - c) Realizimit të programimit të botimeve të cilat ndihmojnë në thellimin e njohurive mbi diasporën shqiptare. Botimit të kontributeve dhe punimeve shkencore të realizuara në konferencat tematike;
  - d) Ndërmarrjes së nismave të tjera në fushën e diasporës, që konsiderohen të nevojshme nga palët, në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje.



Neni 2

**Parimet e përgjithshme**

1. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Palët vlerësojnë interesin e përbashkët për të ruajtur dhe zhvilluar forma bashkëpunimi për të promovuar, botuar dhe për të bërë kërkime shkencore e kulturore në bashkëveprim me diasporën.

Neni 3

**Bashkëpunimi për punimet shkencore dhe aktivitetet**

1. Palët do të nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e botimit, kërkimit shkencor dhe trashëgimisë kulturore.
2. Aktivitetet bashkëpunuese në kryerjen e kërkimit shkencor përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) Bashkëpunimin për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare në të cilat marrin pjesë palët;
  - b) Organizimin e konferencave apo trajnimeve mbi çështje që lidhen me diasporën dhe më gjerë;
  - c) Botimin apo publikimin e studimeve mbi historinë e diasporës shqiptare dhe trashëgiminë kulturore;
  - d) Promovimin dhe publikimin e studimeve apo botimeve në formatin e-book;
  - e) Nxitjen e aktiviteteve në vendet ku palët e marrëveshjes kanë qendrat e veprimtarisë së tyre;
  - f) Organizimin e aktiviteteve në bashkëpunim edhe me palë të tjera;

Neni 4

**Konfidencialiteti dhe pronësia intelektuale**

- a) Palët detyrohen ndërsjelltas të ruajnë fshehtësinë në lidhje me informacionin, të dhënat dhe njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me vendimarrjen e përbashkët të tyre.
- b) E drejta e pronësisë intelektuale të një pale do të mbetet në zotërim të plotë të asaj pale, me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe.
- c) Të drejtat e pronësisë intelektuale në pronësi të një pale mund të përdoren nga pala tjetër për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje vetëm me



pëlqimin e shprehur me shkrim të palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë dhe në përputhje me rregullat e parashikuara nga ajo palë.

Neni 5

#### **Përpunimi i të dhënave personale**

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike vetëm për qëllime që lidhen me këtë Marrëveshjeje.

Neni 6

#### **Format e bashkëpunimit**

Palët janë pajtuar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësinë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte të tjera që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që bashkëpunimet me palët e treta të mos bien ndesh me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

#### **Përgjegjësia**

Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta.

Neni 8

#### **Kohëzgjatja, procedura e rinovimit dhe e drejta e tërheqjes**

1. Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dyja Palët.
2. Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh nga data e hyrjes në fuqi dhe mund të rinovohet për të njëjtën periudhë në bazë të një marrëveshjeje të shkruar midis palëve.
3. Palët mund të bëjnë ndryshime eventuale apo të tërhiqen nga kjo Marrëveshje, duke i komunikuar me shkrim palës tjetër, që 6 muaj më parë. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshjeje nuk prodhon efekte mbi marrëdhëniet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshjeje ka qënë në fuqi.



Neni 9

**Komunikimi mes palëve**

1. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim bashkërendimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 10

**Amendimet**

Palët do të bëjnë amendime në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

Neni 11

**Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Neni 12

**Gjuha e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në 2 kopje për secilën palë.

**PËR INSTITUTIN ALB-SHKENCA**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I IASH,  
PROF. DR. FATOS YLLI**

**PËR FONDIN SHQIPTAR PËR  
ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

**DREJTORI EKZEKUTIV,  
SOANA JAUPLLARI**



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**  
**MIDIS MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN, FONDACIONIT PËR**  
**POLITIKAT DIPLOMATIKE DHE KËRKIMIN SHKENCOR (DRPF) DHE**  
**ORGANIZATA PËR EDUKIM, SHKENCË DHE KULTURË E KOMBEVE TË**  
**BASHKUARA (UNESCO) PËR PJESËMARRJEN E TYRE NË KËRKIMIN**  
**SHKENCOR ARSIMOR DHE ZHVILLIMIN, ADVOKIMIN, TRAJNIMIN NË**  
**KUADRIN E MANDATIT UNIVERSITAR**

PREAMBUL

Duke marrë parasysh gatishmërinë e palëve për të punuar në zgjerimin dhe më tej forcimin e marrëdhënieve midis palëve në lidhje me vlerat e arsimit cilësor, promovimit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, promovimit të gjuhës shqipe dhe të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe në emër të solidaritetit;

Duke qenë të vetëdijshëm për interesat e tyre të ndërsjella të bashkëpunimit dhe mbështetjes reciproke;

Për të mbështetur bashkëpunimin ndër-rajonal dhe ndërkombëtar, në kuadër të procesit të integritimit evropian duke pasur parasysh ekspertizën e UNESCO-s dhe fushën e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Diasporën, në përputhje me VKM nr. 510, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Diasporën”

Në përputhje të plotë me legjislacionin në Republikën Shqipërisë si dhe me parashikimet e legjislacionit ndërkombëtar dhe detyrimet që lindin nga traktatet ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare;

Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe z. Jaagz Bajaj, përfaqësues i DRFD dhe ekspert i UNESCO-si ngarkuar me punë special për Shqipërinë (këtej e tutje “palët”) shprehin vullnetin si më poshtë vijon:

Neni 1

Fondacioni Për Politikat Diplomatike Dhe Kërkimin Shkencor (DRPF) Palët marrin pjesë në Kuadër të Bashkëpunimit Arsimor dhe Kërkimor Shkencor me Mandat Universitar duke qenë subjekt i të drejtës ndërkombëtare me zotësi për të vepruar dhe të aftë për të përmbushur funksionet dhe detyrimet e tyre.

Me qëllim përmbushjen e qëllimeve të këtij memorandum, Ministri i Shtetit për Diasporën si anëtar Kuadrit për Bashkëpunim Arsimor dhe Kërkimor Shkencor me Mandat Universitar zotëron madat të plotë të zhvillojë kuadrin Arsimor dhe Kërkimor Shkencor.



## Neni 2

### Objektivat

Palët, brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre përkatëse, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e palëve përkatëse, dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe komunitare, marrëdhëniet bilaterale dhe arsimore, do të organizojnë aktivitete sociale dhe kulturore, veprime të koordinuara për zbatimin e projekteve të partneritetit dhe shkëmbimit, brenda kornizës së politikave dhe programeve të UNESCO-s.

## Neni 3

### Fusha e bashkëpunimit

Palët angazhohen për zhvillimin e bashkëpunimit në sektorët e mëposhtëm:

a) Kultura dhe Edukimi

- Vendosja e bashkëpunimit midis universiteteve dhe institucioneve kryesore kulturore të dy palëve dhe krijimin e një programi të përbashkët për këtë qëllim.
- Sigurimi i një trajnimit të specializuar, kurse, zhvillimi i kurrikulës, funksionimi i orëve të rregullta në modalitetin e mësimin në distancë, module të certifikimit për kandidatët e partive pjesëmarrëse dhe publikun e gjerë, përfshirë dhënien e diplomës, gradave dhe titujve pasuniversitar të duhur, përfshirë gradën e doktoratës bazuar në standardet ndërkombëtare.
- Monitorimi dhe vlerësimi i arsimit cilësor dhe hulumtimit në përputhje me politikat e ndryshme të UNESCO-s për arsimin.
- Krijimi i një programi të zhvillimit të qëndrueshëm në arsim në gjuhën shqipe duke ndihmuar komunitetet shqiptare në mënyrë që të mbrojnë dhe promovojnë një gjuhë unike siç është shqipja dhe ta transmetojnë atë në generatën e dytë dhe të tretë të shqiptarëve jashtë vendit.
- Formulimi dhe shpërndarja e politikave arsimore për rritjen gjithëpërfshirëse të qeverive pjesëmarrëse.
- Sigurimi i një trajnimit të specializuar dhe module certifikimi për kandidatët e partive pjesëmarrëse dhe publikun e gjerë, përfshirë dhënien e diplomës, gradave dhe titujve pasuniversitar të duhur.
- Të bashkëpunojë me Universitetet, OJQ-të, fondacionin e vendeve pjesëmarrëse me një objektiv të ngjashëm përmes bashkëpunimit në arsim.
- Bashkëpunimin dhe ndihmën në krijimin e Qendrave Kulturore Shqiptare në përputhje me dispozitat ligjore.





- b) Ndiurma sociale dhe shëndetësore
- Inkurajimin dhe mbështetjen e shkëmbimit të teknologjisë në sektorin e shëndetësisë;
  - Promovimin e bashkëpunimit midis sektorëve të kërkimit dhe shëndetit;
  - Orientimi i iniciativave të bashkëpunimit drejt një logjike të sistemit të përbashkët dhe organizimit ose pjesëmarrjes në aktivitetet vjetore të organizuara nga palët;
- c) Siguria dhe cilësia e produkteve ushqimore
- Promovimi i bashkëpunimit në fushat e kontrollit të cilësisë në zinxhirin ushqimor, me theks të veçantë në bujqësi dhe bagëti;
  - Promovimi i bashkëpunimit midis qendrave të shërbimit dhe institucioneve kërkimore në këtë fushë;
  - Inkurajimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet operatorëve në sektor.

#### Neni 4

### Mënyrat e bashkëpunimit

Palët angazhohen të mbajnë kontakte të drejtpërdrejta dhe do të angazhohen për shkëmbimin e përfaqësuesve dhe zyrtarëve publik, të paktën një herë në vit, në mënyrë që të kontribuojnë në zbatimin e këtij Memorandumi i Mirëkuptimit, si dhe projekteve të hartuara bashkërisht.

Palët marrin përsipër të promovojnë marrëdhënie partneriteti midis institucioneve vendore dhe organizatave të tjera, ndërmarrjeve dhe personave të interesuar, si në format e mëposhtme:

- Shkëmbimin e informacionit dhe përvojave në interes të përbashkët të palëve kontraktuese;
- Takime, seminare, vizita studimore dhe punëtori për çështje me interes të përbashkët për palët;
- Pjesëmarrje në projekte të përbashkëta të financuara nga fondet evropiane;
- Promovimi i aktiviteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në fushëveprimin e institucioneve të Bashkimit Evropian.

#### Neni 5

Korniza bashkëpunuese midis arsimit dhe kërkimit me Universitetin rregullohen nëpërmjet statutit të tij, i cili është në dispozicion në zyrën e sekretarisë së caktuar dhe e publikuar në faqen zyrtare të internetit të organizatës.



Neni 6

**Burimet**

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të vihet në dispozicion përmes financimit të projekteve që do të zbatohen, dhe duke iu referuar UNESCO-s dhe fondeve ndërkombëtare, ose burimeve ekonomike të institucioneve në fjalë.

Palëve pjesëmarrëse nuk do t'ju kërkohet të ofrojnë mbështetje financiare për Kornizën e Arsimit Bashkëpunues dhe Kërkimit me Mandatin e Universitetit përtej kontributeve vullnetare, dhe as nuk do të jenë përgjegjës, individualisht ose kolektivisht, për çdo borxh, detyrim ose detyrim të Organizatës.

Neni 7

**Dispozitat përfundimtare**

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet ose shtohet me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve, në përputhje me Kuadrin e Edukimit dhe Hulumtimit Bashkëpunues me Depozituesin e Mandatit të Universitetit, që vepron si depozitues i të gjitha rishikimeve.

Ky memorandum multilateral dhe i hapur hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe vazhdon për secilën Palë derisa të deklarojë qëllimin e tij për të ndërprerë pjesëmarrjen e saj duke siguruar në mbështetje me Kornizën e Edukimit dhe Kërkimit Bashkëpunues me Depozituesin e Mandatit të Universitetit, një njoftim me shkrim jo më pak se gjashtë muaj para përfundimi i pjesëmarrjes së saj.

Nëse ky Memorandum Mirëkuptimi ndërpritet për ndonjë arsye në përputhje me procedurat e përshkruara më lart, Palët mund të vazhdojnë me çdo veprimtari të filluar para përfundimit të këtij Memorandumi.

Neni 8

**Gjuha**

Palët bien dakord të përdorin gjuhën angleze si gjuhë pune, të shkruar dhe të folur për komunikim.

Neni 9

**Anëtarësia**

Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare mund të njoftojë në çdo kohë depozitarin e caktuar për kërkesën e tij për të marrë pjesë në organizatë. Nëse kërkesa miratohet



me miratimin e rezolutës, pjesëmarrja do të hyjë në fuqi menjëherë pas datës së depozitimit të dokumentacionit të duhur. Kërkesa mund të dërgohet edhe përmes postës elektronike gjithashtu.

Neni 10

### **Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me përkthimin dhe zbatimin e këtij memorandumi mirëkuptimi duhet të zgjidhet miqësisht ndërmjet palëve.

Neni 11

### **Hyrja në fuqi**

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.  
Tiranë më, 08/10/2019

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTËR SHTETI PËR DIASPORËN**

**PËRFAQËSUES I DRFD**  
**DHE EKSPERT I UNESCO-S**  
**PËR SHQIPËRINË**

**PANDELI MAJKO**

**MR. JAAGZ BAJAJ**



**STRATEGJIA  
KOMBËTARE E DIASPORËS  
2018 - 2024  
DHE PLANI I VEPRIMIT**



## STRATEGJIA KOMBËTARE E DIASPORËS

HYRJE

DIASPORA SI CILËSI KOMBËTARE

### I. KUSHTET AKTUALE

- 1.1. SITUATA AKTUALE SI EDHE VLERËSIMI I SITUATËS
- 1.2. FAZATE MIGRIMIT SHQIPTAR DHE DIASPORA
- 1.3. FAKTORËT E ZHVENDOSJES SË SHQIPTARËVE
- 1.4. FENOMENI I “IKJES SË TRURIT”
- 1.5. MIGRIMI DHE FQINJËT
- 1.6. FAKTORIZIMI SOCIAL DHE POLITIK
- 1.7. GJENDJA AKTUALE E DIASPORËS
- 1.8. DIASPORA DHE INTEGRIMI NË BE
- 1.9. SHQIPËRIA DHE KOSOVA

### II. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

- 1.10. VIZIONI, MISIONI
- 1.11. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

### III. OBJEKTIVAT SPECIFIK DHE MASAT

KRIJIMI I NJË KUADRI TË PLOTË TË POLITIKËBËRJES MBI DIASPORËN

- SHTETI DHE DIASPORA
- AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS
- FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT TË DIASPORËS
- QENDRA PËR BOTIMET NË DIASPORË
- KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN
- SAMITI I DIASPORËS
- KËSHILLI KOORDINATIV I DIASPORËS
- DIASPORA DHE MENAXHIMI SHTETËROR
- SHËRBIMET KONSULLORE DHE DIPLOMACIA
- MARRËDHEËNIA E SHTETIT ME DIASPORËN
- KRIJIMI I REGJISTRIT TË ORGANIZATAVE TË DIASPORËS
- NGRITJA E QENDRAVE KULTURORE SHQIPTARE
- PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË DIASPORËS
- POLITIKA SHTETËRORE DHE DIASPORA
- ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE NË DIASPORË
- E DREJTA E VOTËS



- *NËNKOMISIONI PARLAMENTAR PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN*

- *DIPLOMACIA PUBLIKE E DIASPORËS*

KRIJIMI I NJË INSTRUMENTI TË DOBISHËM NË NDIHMË TË QEVERISË DHE AKTORËVE TË TJERË PËR TË PËRMIRËSUAR DHE FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN ME DIASPORËN DHE MIGRACIONIN E LIGJSHËM.

- *PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË EKONOMINË KOMBËTARE*

- *REMITANCAT - NGA KONSUMI DREJT ZHVILLIMIT*

- *DIASPORA-KONTRIBUESE E ZHVILLIMIT TË SHQPËRISË*

- *RRJETET E DIASPORËS*

- *INSTRUMENTA TË DOBISHËM*

PËRGATITJA E ADMINISTRATËS PËR NIVELIN E RI TË MARRËDHËNIES TË POLITIKËS SHTETËRORE ME DIASPORËN

- *KOMUNITETET SHQIPTARE JASHTË VENDIT DHE ZHVILLIMI EKONOMIK*

- *MBROJTJA E IDENTITETIT DHE TRASHËGIMIA KULTURORE*

- *KAPITALI HUMAN, SOCIAL DHE KULTUROR*

- *RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR*

- *ARSIMIMI, EDUKIMI DHE MEDIA*

#### **IV. KOSTIMI DHE BUXHETIMI**

#### **V. MONITORIMI DHE ZBATIMI MONITORIMI**

#### **VI. PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS 2018 - 2024**

#### **VII. GRUPI I PUNËS**



## HYRJE

### DIASPORA SI CILËSI KOMBËTARE

Diaspora është një term i njohur më shumë se 2500 vite më parë. Sot kjo fjalë mund të përcaktohet si “bashkësi migrantësh, që ruajnë lidhjet materiale apo sentimentale me atdheun, duke u adoptuar në mjedisin dhe institucionet e shoqërisë mikpritëse”. Diaspora nuk duhet kuptuar si diçka e pandryshueshme dhe e ngurtë, as si moment social unitar apo i kornizuar. Përkundrazi, për diasporën duhet folur si për komunitete migrantësh, identiteti dhe cilësitë e të cilëve ndryshojnë me kalimin e kohës.

Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia (Lugina) janë hapësira, që përfshijnë shtetet dërguese të shqiptarëve për migrim.

Diaspora shqiptare është tradicionale. Rreth 200 000 njerëz migruan kur osmanët pushtuan tokat shqiptare në shekullin e XV-të. Më vonë, shqiptarët lëviznin brenda territorit osman, dhe mbanin gjithashtu pozita të rëndësishme në strukturat osmane në vende të ndryshme të Perandorisë.

Një prej diasporave më të vjetra shqiptare është komuniteti arbëresh në Itali, i cili akoma ruan rrënjët e veta kulturore dhe gjuhësore. Kjo popullatë është pasardhëse e atyre familjeve shqiptare, që udhëhiqnin Shqipërinë në shekullin e XV kur osmanët pushtuan këtë zonë dhe ata u bënë refugjatë kryesisht në Mbretërinë e Napolit.

Diasporë me origjinë shqiptare gjendet në Turqi. Për një kohë të gjatë ishte e rrezikshme të deklarohej prejardhja shqiptare, por në Turqinë e sotme, diaspora shqiptare është e respektuar dhe historiografia turke çmon rolin e rëndësishëm që kanë luajtur shqiptarët në hierarkinë osmane, por edhe mëvonë në kohën e themelimit të shtetit modern të Turqisë.

Migracioni për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është i konsoliduar në kohë dhe në vitin 2012, shoqata më e vjetër kulturore shqiptare “Vatra” festoi përvjetorin e saj të 100-të.

Në Rumani, Kroaci, Bullgari, Ukrainë, Egjipt deri në Argentinë ekziston një diasporë, e cila edhe pse e vjetër ruan lidhjet gjuhësore dhe është në kërkim të identitetit të vet. Sot, diaspora shqiptare është e pranishme në shtetet evropiane, Kanada, Australi dhe në Afrikë. Në shumicën e vendeve mikpritëse, shqiptarët kanë themeluar organizatat e tyre.

Në trajtimin e diasporës shqiptare organizatat ndërkombëtare fokusohen kryesisht vetëm në atë aktuale. Bëhet fjalë për ata që janë larguar nga Shqipëria dhe Kosova pas rënies së komunizmit në vitet 1990-të dhe më vonë. Ky përkufizim është i mangët dhe nuk përfaqëson realitetin e diasporës shqiptare. Shumë nga ata që u larguan në vitet '90, u bashkuan me familjarët apo miqtë e tyre, që tashmë po jetonin jashtë vendit.



Ata u janë bashkuar shoqatave shqiptare, që ekzistojnë prej kohësh në shumë vende mikpritëse.

Migrimi mbetet një sfidë e vështirë për institucionet shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare është t'i sigurojë Shqipërisë një politikë gjithëpërfshirëse për diasporën dhe vendosjen e saj në një linjë me orientimet e politikës së integritit të Bashkimit Evropian dhe trajtimin e saj me standardet më të mira ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare mbështet migrantët që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme. Ajo synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve të vet, që jetojnë jashtë vendit.

Strategjia nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë. Ajo nuk mbulon çështjet që lidhen me shtetasit e huaj që jetojnë ose duan të jetojnë në Shqipëri.

Strategjia synon që nëpërmjet politikave të bashkëpunimit me Diasporën dhe migrantët të forcojë dhe lehtësojë marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tyre pritëse. Strategjia ekonsideron Diasporën vlerë të shtuarta të shoqërisë shqiptare dhe parashikon rritjen e aftësive të Qeverisë për politikbërjen ndaj saj. Ajo mbështet organizimin e komuniteteve shqiptare në botë, në një diasporë të strukturuar, me qëllim faktorizimin e tyre në bashkëveprimin për përshejtimin e zhvillimit të vendit.

Dokumenti kërkon rivlerësimin e diasporës si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e saj në vendlindje dhe anasjelltas, duke përshtatur kombin me kushtet e reja të kohës që jetojmë.

Dokumenti ndahet në dy pjesë: Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit, i cili përmban objektivat dhe aktivitetet që planifikohen të përmbushen në periudhën 2018 – 2024.

Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2018 – 2024 të Republikës së Shqipërisë është hartuar me kontributin e dhënë nga Grupi i Punës Ndërmintorror i drejtuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën. Në këtë proces janë përfshirë edhe ekspertë të ardhur nga ministri dhe institucione të ndryshme. Në këtë dokument janë përfshirë kontributet dhe propozimet të bëra nga shoqëria civile.

## I. KUSHTET AKTUALE

### 1.1 SITUATA AKTUALE SI EDHE VLERËSIMI I SITUATËS

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018 - 2024 është një instrument, i cili trajton gjendjen e fenomenit migrator dhe diasporës së Shqipërisë. Ajo jep një numër





rekomandimesh, të cilat do të mund të qartësojnë punën e ardhshme të strukturave shtetërore.

Kompleksiteti i fenomenit të diasporës kërkon koordinimin e shumë institucioneve dhe organeve shtetërore dhe përcakton natyrën e dokumentit strategjik, si një strategji komplekse ndërdisiplinore. Të njëjtën natyrë pune ndoqi edhe përgatitja dhe përpunimi i Planit Kombëtar të Veprimit. Ky i fundit nëpërmjet masave të veta, do të bëjë të mundur zbatimin e Strategjisë Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2018 - 2024.

Strategjia Kombëtare është një dokument dinamik, icili e ka të nevojshëm ndjekjen, përshtatjen dhe monitorimin evazhdueshëm të saj. Strategjia do të jetë një instrument i vlefshëm për qytetarët e interesuar dhe do të nxisë strukturat shtetërore, për realizimin e detyrimeve të parashikuara në të.

Në Shqipëri, politikat publike ndaj diasporës deri tani janë ndikuar nga komuniteti idonatorëve dhe OJQ-të. Në vitin 2004 Shqipëria miratoi “Strategjinë Kombëtare të Migracionit 2005 - 2010” për menaxhimin e migrimit në mënyrë sa më të plotë. Ai ishte dokumenti i parë, që provoi të përfshijë interesat e shqiptarëve brenda edhe jashtë vendit në profilin e një politike shtetërore. Strategjia e parë shqiptare për migrimin e vitit 2004 kërkonte, që Shqipëria të konsiderohej vend i aftë për menaxhimin e rrjedhave të migrimit. Ajo u përgatit me financim të BE-së dhe përkrahur nga IOM-i. Pavarësisht dëshirës, synimi kishte pak të bënte me zhvillimin ekonomik të vendit. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018 - 2024 është mbështetur edhe në vlerësimin kritik të zbatimit të politikave të Qeverive Shqiptare në fushën e migracionit nëpërmjet:

- studimit të strategjive të mëparshme në fushën e migracionit dhe të planveprimëve të tyre,
- verifikimit të masave të ndërmarra dhe të ndikimit të tyre në veprimin shtetëror,
- verifikimit të arsyeve të vonësive dhe masat që duhen marrë në vazhdim,
- analizimit të kushteve ekzistuese për realizimin e qëllimeve,
- hartimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve për zhvillimin e politikës shtetërore mbi këtë çështje.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare trajton:

- shkaqet e migracionit,
- mekanizmat e faktorizimit social dhe politik të diasporës në shoqërinë shqiptare,
- mbrojtjen e komuniteteve shqiptare të diasporës jashtë Shqipërisë,



- organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit,
- përmirësimin e shërbimeve konsullore nga ana e konsullatave dhe ambasadave shqiptare.


## 1.2 FAZAT E MIGRIMIT SHQIPTAR DHE DIASPORA

Diaspora është e ndërlidhur me procesin e “pjekurisë” së migrimit. Në raport me të, për Shqipërinë e periudhës kohore të fundit, mund të identifikojmë tre faza të migracionit:

- vala e migrantëve para vitit 1944,
- diasporën më të vonshme të atyre, që u larguan gjatë viteve 1945-1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi,
- valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit, pas vitit 1990.

Në vitin 1989, rreth 19.5% e popullatës i përkiste grup-moshës 15-24 vjeç. Izolimi politik i regjimit komunist dhe ideja e lirisë në Perëndim, u personifikuan si ide të lirisë së lëvizjes dhe migrimin drejt shteteve fqinje, kryesisht në Itali dhe Greqi. Lëvizja jashtë vendit shihej si një investim për të ardhmen dhe për një jetë më të mirë.

**Fig.1 Popullsia mesatare vjetore dhe dy komponentët kryesorë (Shtesa Natyrore dhe Migracioni Neto), 2017**




Burimi: INSTAT



Shqipëria u bë vendi me fluksin më të madh të migrimit në Evropë, sipas matjes së raportit mes migrantëve dhe popullsisë. Kjo fazë e migrimit mund të ndahet në disa periudha:

- periudha 1991- 1992, e cila ishte tërësisht e pakontrolluar, kur përafërsisht 300 000 shqiptarë braktisën vendin,
- periudha e viteve 1992-1996, kur po aq migruan, kryesisht ilegalisht, përkundër përmirësimeve të përkohshme të ekonomisë dhe kontrollit më të mirë kufitar,
- periudha 1996-1997, menjëherë pas krizës së rënies së skemave piramidale të kursimeve të një numri të konsiderueshëm njerëzish. Shqipëria u zhyt në anarki dhe shumë të tjerë u shpërngulën nga frika e dhuna,
- periudha pas vendosjes së lëvizjes së lirë të njerëzve ku ata mund të lëviznin lirisht vetëm me pasaportën shqiptare.

**Fig. 2 Numri i imigrantëve, emigrantëve dhe migracioni (neto)**



Burimi: INSTAT

Gjatë dekadës së parë së tranzicionit u shfaq një mungesë e kontrollit qeveritar mbi migrimin. Në fillim të viteve 2000, përafërsisht 25% e popullatës së përgjithshme, apo mbi 35% e fuqisë punëtore, kishte emigruar.



### 1.3 FAKTORET E ZHVENDOSJES SE SHQIPTAREVE


Njerëzit migrojnë kur në vendin e tyre mungojnë burimet dhe mundësitë për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre. Termi “për një jetë më të mirë” përfshin disa faktorë të cilët idetyrojnë shqiptarët të largohen nga vendi. Kjo është e reflektuar në mungesën e njëtrajtshmërisë ndërmjet migrantëve shqiptarë.

Faktorët kryesorë janë kryesisht:

- **Faktori ekonomik:** Shqiptarët janë larguar kryesisht për arsye ekonomike siç janë - mungesa e mundësive të punësimit, - kushtet e vështira të jetesës, veçanërisht në disa zona ku mungojnë kushtet elementare si energjia elektrike, uji dhe strehimi.
- **Siguria publike:** Shqipëria është përballur me flukse masive emigratore si pasojë e nivelit të ulët të sigurisë publike apo trazirave në vend. Një numër i madh i personash të kualifikuar, me kushte të mira ekonomike, janë larguar nga vendi për një të ardhme më të sigurt për veten dhe familjen e tyre. Kjo dukuri ka ndodhur veçanërisht pas trazirave të vitit 1997 dhe u shoqërua me një valë tjetër largimi.
- **Institucionet e dobëta** çojnë në mungesën e besimit te qytetarët për përmirësimin e situatës në vend, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Institucionet e dobëta dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit gjithashtu, ndikojnë në përpjekjet dhe perspektivat e emigrantëve për t'u kthyer dhe vendosur në vend, veçanërisht kur ata hasin vështirësi në ndërtimin e aktiviteteve private, apo në marrëdhënie me administratën publike.
- Një rast i veçantë, janë largimet për shkak të traditës së “gjakmarrjes”, të cilat kanë një ngarkesë sociale dhe kulturore të veçantë në zonat veriore të vendit.

Arsyet e largimit kanë ndryshuar peshën me kalimin e kohës. Në një studim i cili tregon arsyet e largimit nga Shqipëria në vitin 2017, sipas INSTAT-it, vlerësohen në pesë kategori faktorët e largimit nga vendi.

**Fig. 3 Faktorët e largimit nga Shqipëria, 2017**





Ndër faktorët kryesorë në kushtet e lëvizjes së lirë në hapësirën e Bashkimit Evropian mundësia për të punuar jashtë vendit zë vendin e parë (në rastet e individëve të cilët kanë qenë të punësuar edhe në Shqipëri 84%), pastaj vjen faktori familjar (4.6%), i cili ndiqet nga faktori i papunësisë si pamundësi (4.2%), mundësitë e studimit (3.5%) dhe faktorë të tjerë (3.6%).

Në dokumentet e mëparshme qeveritare largimi nga vendi është trajtuar kryesisht në kuadrin e masave kundër trafikimit dhe menaxhimit të kufijve. Nga vetë natyra e tij, ai nuk mund të luftohet me masa represive, por gjithashtu kërkohen masa parandaluese. Fenomeni kërkon reflektim në trajtimin me metoda afatgjata të përqendruara në shkaqet e migracionit në një këndvështrim praktik. Ky qëndrim duhet të konsiderojë përputhjen me Politikën e Përbashkëta Evropiane për Migracionin.

#### 1.4 FENOMENI I “IKJES SË TRURIT”

Niveli i lartë i largimit të njerëzve të kualifikuar është një karakteristikë e migrimin të shqiptarëve të Shqipërisë, krahasuar me shqiptarët nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

Në 1990, 40% e arsimtarëve dhe studiuesve u larguan nga Shqipëria. Në fillim të viteve 2000, rreth 60 përqind e të diplomuarve në vendet perëndimore ose ishin larguar nga vendi ose nuk ishin kthyer pas diplomimit.<sup>1</sup>

Shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e profesionistëve të kualifikuar kanë gjetur punë në sektorë që ndryshojnë nga kualifikimi i tyre.

Largimi i “trurit” përfshin akademikët, personat e kualifikuar në fushat të ndryshme, si edhe një numër të konsiderueshëm studentësh shqiptarë që studiojnë në universitete të huaja. Nga Italia e Greqia, “truri” i vendit largohet në drejtim të Kanadasë, SHBA, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe vendeve të tjera të BE-së.

Fenomeni “*Brain Drain*” është etiketuar në mënyrë simbolike si fenomeni “Kanada”, duke qenë se politikën e emigracionit të qeverisë së Kanadasë favorizojnë emigrimin e njerëzve të kualifikuar.

“Humbja” e personave të kualifikuar dhe të arsimuar vlerësohet si një dëm i zhvillimit social-ekonomik të një vendi, pasi ata janë forca drejtuese e çdo vendi.

Marrja e masave për të shmangur largimin e përhershëm të individëve të kualifikuar dhe të arsimuar kërkon nxitjen dhe promovimin e migracionit të përkohshëm, në veçanti të migracionit qarkullues të individëve të kualifikuar.

<sup>1</sup> ICESS (2003) *From Brain Drain to Brain Gain: Mobilizing Albania's Skilled Diaspora*. (Nga Ikja e Trurit në Kthimin e Trurit: Mobilizimi i Diasporës së Kualifikuar të Shqipërisë). Dokumenti i politikave për Qeverinë e Shqipërisë. Përgatitur nga Qendra për Studime Sociale dhe Ekonomike, në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore të Zhvillimit për Migracionin, Globalizimin dhe Varfërinë, Universiteti i Sussex, UK, Tiranë, prill 2003.



Qeveria e Shqipërisë synon të nxisë kthimin vullnetar të emigrantëve të kualifikuar, të përhershëm ose të përkohshëm, nëpërmjet qëndrimeve afat-shkurtra për qëllime konsultimi, mësimdhënie apo trajnimi. Kësaj do t'i shërbejë edhe evidentimi i të gjithë kapaciteteve intelektuale që ndodhen jashtë vendit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të nxisë përfaqësuesit e brezit të ri të talentuar jashtë vendit të tërhiqen drejt një karriere profesionale në vend. Një mundësi do të jetë ofrimi i bursave për studime të mëtejshme jashtë vendit dhe krijimi i mundësive për pjesëmarrje në programe për shkëmbime eksperiencash me vendet e treta, me kushtin e detyrimit për t'u kthyer. Ky do të konsiderohet një investim për të ardhmen duke rritur nivelin e akademikëve të rinj. Për të siguruar kthimin e tyre, institucionet (dërguese) do të mbajnë marrëdhënie të afërta me migrantët dhe përfaqësuesit e diasporës së kualifikuar dhe do t'u ofrojnë atyre mundësi punësimi në atdhe.

## 1.5 MIGRIMI DHE FQINJËT

Në përzgjedhjen e shtetit mikpritës faktor kryesor për migracionin e ri shqiptar ishte afërsia gjeografike, kulturore dhe gjuhësore. Fqinjët si Greqia dhe Italia ishin destinacionet kryesore gjatë periudhës së viteve 1992-1995. Vendet e lartpërmendura janë parapëlqyer edhe për shkak të mundësive të pakta për të zbatuar një projekt të kushtueshëm migrimi. Parapëlqimi i migrantëve shqiptarë për shtetet e tjera të Evropës Perëndimore, apo SHBA-së u kufizuan për shkak të gjendjes ekonomike dhe politikave të migrimit në këto vende.

Statistikat e migrimit janë të qarta në paqartësinë e tyre. Njëzet vite pas rënies së komunizmit vlerësohej se përafërsisht 1,44 milionë shqiptarë, respektivisht 45 % e popullsisë prej 3,2 milionë që aktualisht jetojnë në Shqipëri, kishin migruar dhe jetonin jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali. Qeveria e Shqipërisë vlerësoi që në vitin 2005 në Greqi jetonin 600 000 shqiptarë, ndërsa në Itali 250 000 (ndonëse burimet italiane pretendonin se gjendeshin rreth 400 000 shqiptarë).

Nëse marrim për bazë të dhënat e "peoplemovin"<sup>2</sup>, i cili i referohet gjendjes së migracionit, mund të diskutohen këto të dhëna mbi Shqipërinë (fig.4).

<sup>2</sup> "Peoplemovin" është një projekt eksperimental në vizualizimin e të dhënave, që tregon flukset e emigrantëve që nga 2010. Të dhënat e migrimit të ofruara nga Banka Botërore janë hartuar si një tabelë rrjedhëse që lidh emigracionin dhe vendet e destinacionit.



Fig. 4 Migrantët shqiptarë sipas vendeve kryesore të destinacionit

Migrantë	
Greqi	676 846
Itali	522 647
Maqedoni	91 128
Amerikë	83 018
Gjermani	15 964
Kanada	11 985
Turqi	3 712
Angli	3 065
Francë	3 037
Australi	2 628

Burimi: Peoplemovin


Italia për shqiptarët përbënte një vend ku kombinohen parapëlqimet kulturore dhe afërsia gjeografike. Jetesa nën regjimin komunist të vendit, kishte bërë që Italia të shihej si simbol i lirisë dhe Perëndimit. Transmetimet në radio dhe televizion ishin rrugët më të rëndësishme përmes së cilave shqiptarët në komunizëm ruanin lidhjet me Perëndimin. Italishtja ishte gjuha më e folur e huaj në Shqipëri, arti dhe kultura italiane përbënin tërheqje të veçanta. Të gjithë këta faktorë ndihmojnë të kuptohet përse Italia ishte vendi më i kërkuar nga emigrantët shqiptarë. Në Itali numri i shqiptarëve në mesin e vitit 2005 ishte më i larti krahasuar me emigrantët e tjerë në atë vend, respektivisht 13,7% më shumë se rumunët dhe marokenët. Duke ju referuar të dhënave të Institutit të Statistikave Italiane, në vitin 2005 emigrantët shqiptarë në Itali ishin në vendin e parë me 348 813, në vendin e dytë vinin rumunët me 297 570.

Greqia është shteti tjetër i cili është gjeografikisht i afërt me shqiptarët. Kalimi ilegal i kufirit greko-shqiptar nuk kërkonte shpenzime të mëdha financiare. Shtetasit e të dy vendeve gjithashtu ndajnë ngjashmëri të caktuara kulturore dhe historike. Edhe pse greqishtja nuk flitet në Shqipëri por vetëm në disa rajone jugore ku banon komuniteti grek, migrimi masiv në drejtim të këtij vendi ka përfshirë një numër të shtuar të shqiptarëve. Kjo solli rritjen e lartë të atyre që mund të flisnin greqisht, duke shkurtuar edhe distancën kulturore e gjuhësore mes dy vendeve fqinje.



Studiuesit e përshkruajnë migrimin nga Shqipëria si ekonomik dhe me një nivel të lartë parregullsie, me flukse emigrantësh pa dokumente dhe të zhvilluar shpejt e në mënyrë dinamike. Cilësi të veçantë migrimi shfaq (me shumë vajtje e ardhje) sidomos me Greqinë.

**Fig. 5 Numri i emigrantëve, dhe emigrantë për 1000 banorë**



Burimi: INSTAT

Lëvizshmëria e migrantëve që udhëtojnë shpesh mes vendlindjes dhe vendeve mikpritëse është normalizuar për shkak të procesit rregullues (të statusit juridik) në Itali dhe Greqi dhe lëvizjes së lirë pa viza. Ky proces ka krijuar diasporën shqiptare në këto vende e cila fokusohet në stabilizimin e statusit social dhe juridik në vendet mikpritëse për brezin pasardhës.

## 1.6 FAKTORIZIMI SOCIAL DHE POLITIK

Një cilësi dalluese e migracionit shqiptar sidomos në Greqi dhe Itali është krijimi i organizatave bazuar në interesat e partive politike në Shqipëri. Ato kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkatdhetarëve që të marrin pjesë në votimet elektorale (duke udhëtuar drejt Shqipërisë). Në disa parti politike përfaqësuesit e këtyre organizatave janë pjesë e strukturave drejtuese duke rritur influencën politike të migracionit në politikën shqiptare.

Me rregullimin e statusit juridik në shoqëritë pritëse, veçanërisht në Itali dhe Greqi migrantët shqiptarë po shkojnë drejt marrjes së një roli të natyrshëm. Votat e tyre





po vlerësohen të rëndësishme në proceset elektorale vendase. Kjo po krijon mundësi për përfaqësimin e kandidatëve me kombësi shqiptare në strukturat politike dhe përfaqësuese të vendeve pritëse.

Angazhimi i organizuar i migracionit në Itali dhe Greqi ka ndikuar dukshëm në marrëdhëniet e Shqipërisë me këto dy vende. Ato janë ngritur në nivelin e partneritetit strategjik duke qenë një shembull se si migracioni dhe diaspora ndikon në marrëdhëniet bilaterale midis dy shteteve.

### 1.7 GJENDJA AKTUALE E DIASPORËS

Analiza e gjendjes aktuale tregon se diaspora shqiptare është shumë dinamike. Ajo gjendet në shumë shtete udhëheqëse të botës si në Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Greqi, Itali, Turqi, Zvicër, Norvegji, Suedi, Finlandë dhe Francë, por gjithashtu edhe në fuqitë e reja ekonomike siç është Kanadaja dhe Australia.

Diaspora shqiptare është gjithnjë më e organizuar, e arsimuar dhe e gatshme të mbajë kontaktet me vendet e origjinës. Niveli aktual i remitançave të saj është i debatueshëm, por interesi kryesor ka të bëjë me të ardhmen e këtyre të ardhurave.

Vlerësimi i organizatave shqiptare të diasporës dhe politikave të migrimit tregojnë për rolin në rritje që mund të luajë diaspora si një ndërmjetësuese mes vendeve mikpritëse dhe vendlindjes.

Organizatave të diasporës shqiptare në Perëndim, po përqendrohen edhe më shumë në mënyrën e organizimit më të mirë të tyre në vendet mikpritëse dhe përparësitë e tyre të brendshme. Ato po adresojnë situatën e anëtarëve të diasporës, të nevojave dhe kërkesave të tyre të ndërlidhura me pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e punëtorëve të huaj, shtetësinë dhe të drejtat e komuniteteve fetare.

Cilësia kryesore e diasporës shqiptare është mobilizimi edhe përmes lobimit indirekt për të bindur qeverinë pranuese që të veprojë në favor të mbështetjes të shtetit të prejardhjes. Një angazhim të tillë diaspora shqiptare e ka pasur në përpjekjet për pavarësinë, së pari të Shqipërisë e pastaj të Kosovës. Aftësitë reaguese kanë qenë më të mira se sa ato me të cilat mund të krijohet një vetorganizim më i mirë.

Migrimi mbetet një sfidë e vështirë për institucionet shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare është t'i sigurojë Shqipërisë një politikë



githëpërfshirëse për diasporën dhe vendosjen e saj në një linjë me orientimet e politikës së integritit të Bashkimit Evropian dhe trajtimin esaj me standardet më të mira ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare mbështet migrantët që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme. Ajo synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve të vet, që jetojnë jashtë vendit.

Strategjia nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë. Ajo nuk mbulon çështjet që lidhen me shtetasit e huaj që jetojnë ose duan të jetojnë në Shqipëri.

Strategjia synon që nëpërmjet politikave të bashkëpunimit me Diasporën dhe migrantët të forcojë dhe lehtësojë marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tyre pritëse.

Strategjia ekonsideron Diasporën vlerë të shtuarta të shoqërisë shqiptare dhe parashikon rritjen e aftësive të Qeverisë për politikbërjen ndaj saj. Ajo mbështet organizimin e komuniteteve shqiptare në botë, në një diasporë të strukturuar, me qëllim faktorizimin e tyre në bashkëveprimin për përsheptimin e zhvillimit të vendit.

## 1.7 DIASPORA DHE INTEGRIMI NË BE

Diaspora dhe migrimi janë dy “enë” komunikuese në proces. Migrimi ka qenë një temë e rëndësishme e reflektimit të politikave të Bashkimit Evropian gjatë viteve të fundit. Strategjia Evropiane 2020 dhe Programi i Stokholmit pranojnë potencialin e lartë dhe kontributin e madh të migrantëve për BE-në si edhe për ndërtimin e një ekonomie konkurruese dhe të qëndrueshme.

## 1.8 SHQIPËRIA DHE KOSOVA

Shqipëria dhe Kosova supozohet të jenë ndër vendet më të varfra të Evropës. Por, ky vlerësim ndodh vetëm nëse shikohet në vlerat e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Këto vlera nuk e japin pasqyrën e plotë për forcën ekonomike të kombit shqiptar. Në mesin e pasurive të fshehura të këtyre dy shteteve, duhet të llogaritet edhe diaspora e madhe dhe e shpërndarë nëpër shumë vende të botës, e cila dërgon rregullisht remitanca, duke mbartur kështu përgjegjësi të rëndësishme për mirëqenien e vendlindjes dhe popullsisë së saj.



Strategjia Kombëtare parashikon një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e shtetit të Kosovës për një rivlerësim të marrëdhënies me diasporën e përbashkët. Marrëveshjet në fushën e Diasporës midis dy shteteve kanë shërbyer si një hap cilësor në këtë drejtim. Ndërtimi i një Plani Veprimi të përbashkët do të ishte irëndësishëm sa edhe idetyrueshëm.

Të dyja shtetet do të vlerësojnë nivelin e përbashkët të bashkëpunimit edhe me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë për të koordinuar me institucionet përgjegjëse të tyre, rast pas rasti, të drejtat e diasporës shqiptare në vendlindje.

## II. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

### 2.1 VIZIONI, MISIONI

Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare është konkluzion i reflektimit në lidhje me punën që duhet të kryejnë institucionet për krijimin e një politike të re shtetërore për diasporën.

**Vizioni** i Strategjisë Kombëtare përkrah në rivlerësimin e situatës dhe strukturimin cilësor të raporteve të shtetit shqiptar me diasporën.

Diaspora dhe komunitetet shqiptare janë të lidhura me Shqipërinë dhe me njeri-tjetrin nga mënyra e të kuptuarit të interesave zhvillimore dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në kushtet e reja të shoqërisë dhe marrëdhënieve ndërkombe të.

**Misioni** i Strategjisë Kombëtare ka qëllim të përfshijë dhe fuqizojë pjesëmarrjen e diasporës dhe migrantëve si faktor të zhvillimit të Shqipërisë, nëpërmjet kapitaleve të dijeve dhe vlerave që ata zotërojnë.

**Vlerat themelore** që kërkohen të realizohen ky dokument është krijimi i besimit dhe përfshirja e kontributit të diasporës shqiptare nëpërmjet përfitimit reciprok, lehtësimit me një politikë mbështetëse e cila ndryshon cilësinë e marrëdhënies dhe forcon lidhjet e shqiptarëve kudo që ndodhen me vendlindjen dhe njëri-tjetrin.

### 2.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Në realizimin e politikave ndaj diasporës, parashikimi dhe planifikimi strategjik do të çojnë drejt të kuptuarit të rreziqeve kryesore të së ardhmes si për vendlindjen ashtu edhe për diasporën, të cilat aktualisht përballen me sfida politike, ekonomike dhe sociale.



Objektivat kryesorë të strategjisë janë:

- Krijimi i një kuadri të plotë të politikbërjes mbi Diasporën.
- Krijimi i një instrumenti të dobishëm në ndihmë të Qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me Diasporën dhe migracionin e ligjshëm.
- Përgatitja e administratës për nivelin e ri të marrëdhënies të politikës shtetërore me Diasporën.

### III. OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT

#### 3.1 KRIJIMI I NJË KUADRI TË PLOTË TË POLITIKBËRJES MBI DIASPORËN

##### 1. SHTETI DHE DIASPORA

###### - AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës është krijuar me ligj të veçantë. Ajo është përgjegjëse për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet; ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare; nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të originës dhe diasporës; bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës i Agjencisë. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën.

Këshilli Drejtues i Agjencisë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme që lidhen me zbatimin e politikave për diasporën shqiptare.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për qëllim:

- Krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale,



- Zbatimin e politikave dhe projekteve që lidhen me diasporën,
- Koordinimin e diasporës me vendin e tyre të originës,
- Bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë,
- Ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës,
- Informimin e diasporës mbi proceset politike në vendin e originës,
- Përgatitjen e raporteve periodike për veprimtarinë e saj.

### **- FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT TË DIASPORËS**

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, (FSHZHD) ka për qëllim sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare për projekte konkrete të cilat do të vlerësohen si prioritet dhe që kanë një ndikim në përmirësimin ekushteve të jetesës. Ai do të nxisë bashkëpunimin dhe ndërveprimin nëpërmjet promovimit, inkurajimit të prirejeve filantropike dhe investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit në vend.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës, (FSHZHD) do të bashkëpunojë me komunitet dhe shoqata/organizata shqiptare jashtë vendit që dëshirojnë të kanalizojnë kursimet e tyre drejt investimeve, zhvillimit të mbështetjes së projekteve për investimet e diasporës, bazuar në përvojat më të mira.

FSHZHD-ja shërben si mekanizëm i njohur nga ligji ku objektivat kryesorë janë:

1. Mbështetja e anëtarëve të diasporës për të mundësuar kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore, shëndetësore dhe të zhvillimit rural;
2. Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse, organizata dhe individë për qëllime filantropike që veprojnë në fusha lidhur me zhvillimin social-ekonomik, kulturor, arsimor të diasporës.

### **- QENDRA E BOTIMEVE TË DIASPORËS**

Qendra e Botimeve të Diasporës është përgjegjëse e botimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore të miratuara dhe literatura plotësuese të cilat do të shërbejnë mësimdhënies dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare të Diasporës. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Botimeve të Diasporës do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.



## - KOMITETI SHETETËROR PËR DIASPORËN

Komiteti Shtetëror për Diasporën është organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Ministrin e Drejtësisë, Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrin e Kulturës, Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit, Ministrin e Shtetit për Diasporën, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Kryetarin e Akademisë së Shkencave, Drejtorin e INSTAT-it.

Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:

- a) Përgatitjen e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në fushën e diasporës;
- b) Propozimin e mekanizmave ligjore dhe institucionale për çështje që lidhen me përmirësimin e pozitës së anëtarëve të diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku jetojnë;
- c) Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit në fushën e zhvillimit të komuniteteve të diasporës;
- d) Koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
- e) Mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën.

## - SAMITI I DIASPORËS

Samiti i Diasporës do të kthehet në një ngjarje mbarëkombëtare duke u trajtuar si eveniment ipërbashkët ipjesëtarëve më të suksesshëm e përfaqësues të diasporës. Krijimi i kësaj tradite do të fuqizojë ndjenjën e identitetit dhe bashkimit kombëtar. Ai do të rrisë respektin për diasporën dhe do të nxisë konkluzione praktike në koordinimin dhe angazhimin e saj brenda dhe jashtë vendit.

Samiti do të mbledhë figura të spikatura të biznesit, shkencës, artit, kulturës, sporteve dhe studentët e suksesshëm që jetojnë jashtë vendit. Aty do të vlerësohen arritjet dhe shkëmbehen eksperiencat në diskutimin e sfidave kombëtare dhe tejkalimin e tyre.



## - KËSHILLI KOORDINATIV I DIASPORËS

Marrëdhënia e re e shtetit me diasporën do të formalizohet e institucionalizohet me ngritjen e Këshillit Koordinativ të Diasporës Shqiptare, i cili do të krijohet si një organizim qendror bashkëpërfaqësimi. Këshilli do të drejtojë procesin e bashkëpunimit të institucioneve shtetërore me komunitetet shqiptare jashtë vendit.

Këshilli do të jetë një strukturë ndërinstitucionale për angazhimin e diasporës dhe emigrantëve dhe do të përbëhet nga partnerët kryesorë institucionalë të shtetit shqiptar dhe të diasporës.

Këshilli i Diasporës do të mbështesë krijimin e një rrjeti të organizuar të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse dhe shteteve të origjinës. Organizatat e diasporës do të përcaktojnë qëllimet e tyre, strategjitë, funksionet dhe fushat e veprimit, në pajtim me burimet e disponueshme dhe mundësitë ligjore e rregullimet institucionale në shtetet pritëse.

Rëndësia e organizimeve të diasporës është pranuar nga institucionet politike kombëtare e ndërkombëtare gjatë viteve të fundit, si Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe qeveritë e vendeve pritëse. Në Shtetet e Bashkuara, organizatat shqiptaro-amerikane janë falenderuar publikisht për punën e tyre prej institucioneve e politikanëve të niveleve të larta.

## - DIASPORA DHE MENAXHIMI SHTETËROR

Menaxhimi i migrimit përfshin një sërë praktikash për avancimin dhe ndikimin pozitiv të diasporës shqiptare në rajonet e origjinës. Këto praktika janë të bazuara në modele të cilat do të nxisin administratën e vendeve dërguese të origjinës në krijimin e strategjive të migrimit dhe ndërtimit të kapaciteteve për aplikimin e saj.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018 - 2024 synon një të ardhme ku Shqipëria do të konsiderohet vend i aftë të menaxhojë rrjedhat e migrimit. Ky qëllim strategjik lidhet me zhvillimin ekonomik e social të shoqërisë dhe me imazhin e vendit.

Në këtë kontekst vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani veprimi të veçantë për nxitjen e organizimit në nivel rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse është prioritet. Në këtë drejtim do të nxitet promovimi i idesë për mbajtjen e aktiviteteve që nxisin këtë nivel organizimi nëpërmjet informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.

Strategjia Kombëtare vlerëson krijimin e një Planit-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës për fushën e marrëdhënieve me diasporën në funksion dhe për pasurimin



e marrëveshjeve ekzistuese që ekzistojnë midis dy vendeve në këtë drejtim. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës metë gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe “prodhuese” të diasporave shqiptare në botë. Strategjia Kombëtare konsideron të dobishëm vendosjen e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e programeve për këtë qëllim (për shembull me PNUD-in për të zbatuar TOKTEN në Shqipëri). Aplikimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës do të rivlerësojë aktet ligjore ekzistuese në fushën e migracionit dhe zgjerimin e sferës së mbrojtjes së komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me qëllim përafrim in me Acquis Communautaire.

### **- SHËRBIMET KONSULLORE DHE DIPLOMACIA**

Strategjia do të mbështesë rritjen e cilësisë së shërbimeve në shtetet ku janë vendosur komunitetet më të mëdha të shqiptarëve në diasporë. Krijimi i një strukture konsullatash, në pajtim me burimet financiare e njerëzore, është ineqvojshëm dhe i natyrshëm.

Ambasadat shqiptare do të përgatisin raporte periodike në lidhje me gjendjen dhe organizimin e komunitetit shqiptar në shtetet pritëse. Diplomatat shqiptarë duhet të kenë njohjet e nevojshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe në politikat e migracionit, në veçanti në lidhje me konventat ndërkombëtare dhe ato dypalëshe për migracionin dhe të drejtat e migrantëve. Për të mbrojtur siç duhet të drejtat e qytetarëve shqiptarë, ambasadat dhe konsullatat shqiptare do të kenë në dispozicion të tyre ekspertë ligjorë të specializuar në të drejtat e njeriut dhe migrantëve, me njohje të plotë të rregullave e praktikave të imigracionit të vendeve pritëse.

Ambasadat, konsullatat dhe shërbimet qendrore të diplomacisë shqiptare do të disponojnë dhe ofrojnë listat e avokatëve të specializuar për të drejtën dhe çështjet e migracionit.

Informacioni bazë për komunitetin e shqiptarëve në vendin pritës do të bëhet i disponueshëm nëpërmjet faqes së internetit për çdo ambasadë dhe shërbim konsullor. Ai do të përmbajë informacionin mbi kontaktet e ambasadave e konsullatave, llojet e shërbimeve që ato ofrojnë për shtetasit shqiptarë dhe mënyrën se si të ankohen për cilësinë e dobët ose mungesën e shërbimeve.

Strategjia Kombëtare do të nxisë ndërgjegjësimin dhe orientimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare, nëpërmjet platformës konsullore online. Këtu do të përfshihet edhe dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.





## **- MARREDHENIA E SHTETIT ME DIASPOREN**

Strategjia Kombëtare mbështetet në një raport të ri cilësor të institucioneve shtetërore për diasporën sipas praktikave më të mira evropiane. Ajo do të nxisë transparençën e institucioneve në secilin aspekt të procesit të vendimarrjes dhe efektivitetin e politikave të cilat do të sigurojnë koherencë në fushat që do të aplikohen.

Diaspora është thesari i "fshehur" i shqiptarëve, icili duhet të tregohet dhe të shënohet. Pavarësisht dokumenteve të prodhuara nga politika shtetërore, pak veprime konkrete janë ndërmarrë për ta bërë diasporën të ndihet e mirëseardhur në zhvillimin e vendlindjes. Kur ata mundohen që të investojnë në të, shpesh, përballen me burokraci dhe korrupsion.

Strategjia vlerëson se roli i diasporës shqiptare në të ardhmen do të jetë më i fortë se sa në të kaluarën. Kjo i dedikohet edhe strukturës së saj e cila po ndryshon me një dinamikë cilësore. Nëse në të kaluarën, diaspora shqiptare ishte më pak e arsimuar dhe ka kryer punë të rëndomta, sot diaspora zotëron aftësi të cilat mungojnë në vendlindje.

Diaspora është arsimuar dhe pasuruar me kalimin e viteve dhe është e gatshme që t'u vijë në ndihmë familjeve të tyre që gjenden në vendin e prejardhjes.

Ndryshimet cilësore të diasporës do të kërkojnë vlerësimin e përfaqjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e plotë të politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

## **- KRIJIMI I REGJISTRIT TË ORGANIZATAVE TË DIASPORËS**

Regjistri i organizatave të diasporës do të jetë një informacion i rëndësishëm, icili do të krijojë një bazë të memories shtetërore për të tashmen dhe të ardhmen. Ai do të ketë role të shumëllojshme të cilat janë:

- mbështetja e të drejtës së votës;
- krijimi i rrjeteve të organizimeve profesionale jashtë vendit;
- funksionimi si një bazë të dhënash për grumbullimin e informacionit për potencialet dhe kapacitetet e diasporës sipas profesioneve.



Strategjia Kombëtare e Diasporës synon rivlerësimin dhe zgjerimin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Një rëndësi të veçantë merr përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur.

Strategjia Kombëtarë e Diasporës synon organizimin e aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit. Ajo do të vlerësojë evidentimin e shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim merr një rëndësi të veçantë.

#### **- NGRITJA E QENDRAVE KULTURORE SHQIPTARE**

Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës do të realizohet në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar, për të promovuar imazhin e vendlindjes e të shqiptarëve jashtë vendit dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë. Respektimi i parimit të “një diasporë” do të pasurohet nga bashkëpunimi edhe me shtete të tjera që janë prodhuese të diasporës shqiptare.

#### **- PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË DIASPORËS**

Promovimi i të drejtave të diasporës shqiptare fillon nga çështja themelore: riorganizimi i vetvetes. Ai do të bazohet në unitetin etnik dhe kombëtar shqiptar dhe nevojat e kombit në kushtet e reja ndërkombe të.

Strategjia Kombëtare do të nxisë një veprim të koordinuar të qeverisë dhe institucioneve shtetërore me organizatat e diasporës shqiptare. Ajo do të nxisë politika dialogu të qarta me shtetet mikpritëse për çështje të rëndësishme, përfshirë integrimin, mësimin e gjuhës, politikat për nënshtetësinë etj.

Në shtetet mikpritëse organizatat e diasporës do të ndihmohen për të mbështetur shqiptarët që punojnë e jetojnë jashtë vendit, nevojat dhe kërkesat për informacion dhe shërbime për migrantët e rinj, pjesëmarrjen politike, të drejtat e punës, procesin e natyralizimit, të drejtat fetare apo çështje të tjera.

Diaspora ka kapacitete të cilat mund ta shndërrojnë në një faktor për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, nëpërmjet ndërmjetësimit, përcjelljes së ideve, praktikave,



vlerave dhe qëndrimeve, normave të sjelljes dhe kapitalit social të tyre. Migrantët e vjetër dhe të rinj mund të luajnë një rol të rëndësishëm përmes sigurimit të ndihmës për zhvillim dhe financim it të partnerëve lokalë në këtë drejtim.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të fokusohet në mundësimin e informacioneve rreth diasporës shqiptare dhe zhvillimin e komuniteteve jashtë vendit. Në këtë kuadër do të realizohet një raport vjetor ku do të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën shqiptare.

Realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta për fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare do të jetë një prioritet. Do të organizohen trajnime periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Kjo do të shoqërohet me vlerësimin periodik të identifikimit të nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil do të marrë rëndësi të veçantë.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të nxis bashkëpunimin shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat janë me profile dhe trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Ajo do të nxisë krijimin e komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Vlerësim të veçantë do të kushtohet informimit publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

#### **- POLITIKA SHTETËRORE DHE DIASPORA**

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të strukturojë mekanizmat shtetërorë të politikës shtetërore për komunitetet shqiptare jashtë vendit. Kjo do të fillojë që me hartimin e manualeve praktike që lidhen me çështjet e diasporës dhe migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për Diasporën.

Strategjia Kombëtare do të identifikojë aktet ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Një rëndësi të veçantë do të ketë edhe trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.



Strukturat shtetërore përgjegjëse do të vendosin kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

Në këtë kuadër do të nxitet edhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende do të vlerësohet si mekanizëm në funksion të interesit të komuniteteve shqiptare.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të kryejë rivlerësimin periodik të politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre ndaj diasporës. Në bazë të informacioneve të marra do të realizohet një raport vjetor për gjendjen konkrete të komuniteteve shqiptare, me propozime masash respektive për përmirësimin e asistencës për ta.

Strategjia Kombëtare synon krijimin e regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Vlerësimi i informacionit periodik dhe konkluzioneve për këtë çështje do të diskutohen edhe në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

Strategjia Kombëtare do të konsiderojë rishikimin e kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse do të vlerësohet edhe me qëllimin për përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti.

Strategjia Kombëtare e Diasporës vlerëson dhe nxit migrimin qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë).

Rivlerësim të veçantë do të ketë në bashkëpunimin me vendet e BE e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfutur edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

#### **- ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE NË DIASPORË**

Organizimin e komuniteteve shqiptare në diasporë i cili ka si qëllim:

- Krijimin e strukturës koordinative shtetërore për regjistrimin e shtetasve jashtë vendit,



- Regjistrimin e organizatave dhe inventari i aftësive të veçanta në diasporë sipas profesioneve,
- Krijimin e Rrjetit të Grave të Diasporës,
- Krijimin e rrjeteve të “Ambasadorëve të Kombit” në diasporë,
- Funksionimin e një strukture mediatike të koordinuar ndërkombëtare për diasporën.

#### **- E DREJTA E VOTËS**

Strategjia Kombëtare parashikon ndërmarrjen e një vargu hapash për ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor të Shqipërisë, të cilat do të garantojë mirëpritje dhe respektim të rolit të diasporës me nënshtetësi shqiptare dhe migracionit të ligjshëm.

E drejta e votës dhe përfshirja në vendimmarrjet kombëtare do të krijojnë një hapësirë të re të protagonizmit të diasporës në shoqërinë shqiptare.

Përfshirja e diasporës në sistemin politik dhe zgjedhor është e rëndësishme pasi mundëson përfshirjen e kontributin dhe ekspertizën e saj në administrimin e shtetit. Gjeneratat e reja të diasporës kanë nivele arsimore të admirueshme për administrimin shtetëror. Ekspertiza e diasporës do të kërkohet edhe në fushat e tjera të shkencës, teknologjisë dhe zhvillimit të Shqipërisë.

#### **- NËNKOMISIONI PARLAMENTAR PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN**

Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin vepron në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe është përgjegjës për propozimin, shqyrtimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave shtetërore për diasporën dhe migracionin. Ai do të shërbejë edhe si krijues i kohezionit politik në Kuvend në çështjet të cilat kanë të bëjnë me diasporën.

#### **- DIPLOMACIA PUBLIKE E DIASPORËS**

Vlerësimi i arritjeve të diasporës do të inkurajojë pjesëtarët e saj më të njohur që të punojnë si “Diplomatë Publikë” të shtetit jashtë vendit. Diplomacia publike ka të bëjë me ndikimin e qëndrimeve dhe opinioneve në formimin dhe zbatimin e politikave të shteteve pritëse. Ajo përmban dimensione të marrëdhënieve ndërkombëtare përtej diplomacisë tradicionale dhe kultivim të opinionit publik në shtetet e tjera.



Protagonistët e shoqërive ku jetojnë anëtarët e diasporës, aktorët, këngëtarët, sportistët dhe biznesmenët, të cilët kanë influencë, njohje të drejtpërdrejtë me mediat, miq nëpër rrjetet sociale dhe që krijojnë influencë në publik do të bëhen natyrshëm “ambasadorët” më të mirë për kultivimin e imazhit pozitiv për kombin shqiptar.

Strategjia Kombëtare do të kërkojë angazhimin e institucioneve shtetërore i cili përfshin edhe përkrahjen e aktivitetit të diasporës kur ajo adreson një situatë të caktuar në shtetin pranues. Kjo do të përfshijë edhe aktivizimin e institucioneve politike në shtetin e prejardhjes që të vepohet në favor të migrantëve karshi autoriteteve në shtetin mikpritës.

Organizimet gjithëpërfshirëse të migrantëve do të kenë qendra të kulturës dhe informacioni, të cilat do të financohen nga autoritetet e shtetit ose në bashkëpunim me shtetin pritës dhe donatorë të interesuar. Qendrat e kulturës do të angazhohen në shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar në diasporë.

## **3.2 KRIJIMI I NJË INSTRUMENTI TË DOBISHËM NË NDIHMË TË QEVERISË DHE AKTORËVE TË TJERË PËR TË PËRMIRËSUAR DHE FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN ME DIASPORËN DHE MIGRACIONIN E LIGJSHËM**

### **1. PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË EKONOMINË KOMBËTARE**


#### **- REMITANCAT - NGA KONSUMI DREJT ZHVILLIMIT**

Dërgesat në para të migrantëve kanë ndihmuar kryesisht në konsumin e përditshëm dhe mbijetesën ekonomike të familjeve shqiptare. Ato kanë plotësuar nevojat themelore të jetesës për ushqim, veshmbathje, shpenzime për kujdes shëndetësor, arsimim të fëmijëve apo për ndërtimin dhe mobilimin e shtëpive. Studimet tregojnë se një vit qëndrim në emigracion injë pjesëtari të familjes, sjell një rritje prej 5 përqind të konsumit për familjen e tij. Por, këto dërgesa nuk kanë ndikuar sa duhet në zhvillimin ekonomik të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Varësia e ekonomisë shqiptare nga remitancat është e ndjeshme. Ato kanë përbërë 9-15 përqind të GDP-së dhe rreth 15 përqind të të ardhurave familjare. (Në një kohë që India, si pritësi më i madh i remitancave në botë, përfiton rreth 20 EUR për frymë dhe më pak 1 përqind të GDP-së.) Shqipëria renditet ndër vendet me shkallë varësie të lartë nga remitancat.



**Fig. 6 Dinamika e remitancave të migrantëve shqiptarë, 2002-2016**



Burimi: Open Data Albania, 2016 & Banka e Shqipërisë, 2016

Dinamika e remitancave në vend është zhvilluar në tri faza:

- 1- faza e rritjes, 1991-2007;
- 2- faza e rënies, 2008-2013;
- 3- faza e ringritjes, prej vitit 2014.

Remitancat erdhën duke u rritur nga viti 1991 në vitin 2007, kur arritën në maksimumin e tyre. Në këtë vit në Shqipëri hynë në formë remitancash 952 milionë EURO dhe ishte vendi me varësinë më të madhe nga remitancat në rajon, me mbi 300 EURO për frymë. Pas këtij viti remitancat erdhën në rënie, duke arritur pikën më të ulët në vitin 2013, në nivelin 500 milionë EURO. Pakësimi i remitancave shkaktoi rritje të varfërisë. Remitancat filluan të rriten në vitin 2014, duke arritur në 592 milionë EURO dhe në vitin 2016 arritën në 616 milion EURO.



Fig. 7 Ecuria e remitancave në vitet 1993-2016

Ecuria e remitancave në vite 1993-2016 (mln USD)



Burimi: Banka e Shqipërisë (shifrat janë të konvertuara në USD dhe për pasojë kanë edhe një impakt nga kursi i këmbimit të USD me valutat e tjera)

Rënia e remitancave drejt Shqipërisë ndodhi kryesisht për shkak të krizës ekonomike në vendet kryesore pritëse si Greqia dhe Italia. Por, vlen të shtohen shkaqe të tjera si maturimi i procesit migrator, mplakja e brezit të parë të migrantëve, rritja e shpenzimeve për brezin e dytë dhe të tretë të emigrantëve, kristalizimi i projekteve migratore, rritja e kostos së shërbimeve publike dhe jetesës në vendet pritëse, modifikimi i sjelljes dhe projekteve individuale e familjare për shkak të pasigurisë e ankthit që shkakton kriza financiare etj.

Strategjia Kombëtare vlerëson se varësia e lartë nga remitancat bën të nevojshme administrimin strategjik të tyre. Shmangia nga ky proces rrit rrezikun e pasojave të administrimit të dobët. Ky i fundit shfaqet sidomos në mungesën e bashkëveprimimit në ekonomi midis remitancave dhe burimeve të tjera të zhvillimit si investimet e huaja direkte dhe tregtia.

Kanalet kryesore të dërgimit të parave prej emigrantëve shqiptarë familjeve të tyre fillimisht kanë qënë informale. Ato janë sjellë pranë familjes nga të interesuarit ose dërgimit përmes të afërmeve e miqve. Në një fazë të mëvonshme filloi dërgimi i tyre i formalizuar nëpërmjet korrierëve të paguar dhe institucioneve jobankare. Në fazën e tretë ka nisur edhe dërgimi i tyre nëpërmjet sistemit bankar.





Sistemi bankar është shfrytëzuar fillimisht pak për dërgesat e emigrantëve. Kjo ka ndodhur për arsye historike, psikologjike e praktike. Ndër arsyet kryesore renditen kultura bankare e kufizuar, produktet bankare të pakta, kostot e larta të transfertave dhe besimi i ulët te bankat sidomos e zhvilluar kjo për banorët e zonave rurale në vend. Institucionet jobankare, si Western Union, i cili në vitin 2005 zotëronterreth 80% të tregut të remitancave, kanë mbizotëruar për shkak të besueshmërisë, shpejtësisë, mungesës së burokracisë dhe fleksibilitetit e orarit të zgjatur me të cilën ato punonin. Kanalizimi i remitancave drejt mekanizmave formalë rrit transparencën, dhe promovon sistemin bankar vendas duke rritur fuqinë e tregut të remitancave. Strategjia Kombëtare parashikon që në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve pritëse për remitancat të promovojë transfertat me kosto më të ulët përmes kanaleve formale.

Remitancat e migrantëve do të konsiderohen një prej instrumenteve të zhvillimit të vendit. Strategjia Kombëtare e Diasporës parashikon një koordinim kombëtar të institucioneve përgjegjëse shtetërore për të bashkëpunuar për të krijuar një plan veprimi për remitancat, i cili do të:

- Evidentojë praktika të mira për dërgesat e emigrantëve,
- Zgjerojë shërbimet bankare në Shqipëri dhe përmirësojë bashkëpunimit mes bankave shqiptare e të huaja në lidhje me remitancat,
- Zgjerojë kapacitetet e institucioneve të tjera financiare dhe të Postës Shqiptare për të përmirësuar shërbimin e transferimit të remitancave,
- Rrisë kapacitetet shtetërore dhe të organizatave të diasporës në vendet pritëse për të bashkëpunuar në zhvillimin e përbashkët të iniciativave mes këtyre vendeve.
- Nxisë kanalizimin e remitancave në rrugë bankare dhe ndërmarrjen e hapave praktik në përdorimin e remitancave për zhvillim të vendit.

Strategjia Kombëtare do të nxisë aftësimin e familjeve të migrantëve si pritës të remitancave për përdorimin më eficient të tyre dhe menaxhimin e bizneseve të vogla. Krijimi i shembujve të cilat itregojnë diasporës sesi familjarët e tyre do t'ua kthejnë paratë e marra do të jetë një nxitje për ajo që të risë dërgesat në para për familjet në Shqipëri.

#### **- DIASPORA - KONTRIBUESE E ZHVILLIMIT TË SHQIPËRISË**

Strategjia Kombëtare inkurajon pjesëmarrjen e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo nxit thithjen e investimeve nga diaspora, themelimin e ndërmarrjeve



të vogla e të mesme, përfshirë ato në fushën e bujqësisë, industrisë ushqimore dhe zhvillimin e zonave rurale.

Strategjia Kombëtare do të krijojë një ambient të favorshëm në vendlindje për diasporën siç janë incentivat fiskalë, shtimin e informacionit, shmangien e korrupsionit, reduktimin e riskut, shmangien nga tatimet e importimit për makineritë, pajisjet dhe lëndët e para për investime, heqjen e tatimit të korporatës, dhe zvogëlimin e numrit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit.

Strategjia Kombëtare nxit promovimin e produkteve specifike bankare për diasporën dhe përkrah krijimin e politikave bankare të veçanta (apo krijimin e Bankës për Diasporën). Ajo inkurajon sistemin bankar të ndërmarrë një reformë për sa i përket normave të interesit, të cilat do të nxisin diasporën të shkojë një hap më larg se sa transferimi i pagesave në vendin e origjinës. Fondet e depozituara nga migrantët mund të përdoren për dhënie të kredive lokale. Kursimet e diasporës mund të kthehen në kredi më të lira, të cilat do të përkrahin bizneset vendore.

Strategjia Kombëtare nxit krijimin e një platforme, e cila do të ofrojë fonde për mikro-kredi për diasporën dhe migrantët. Kjo mund të bëhet edhe përmes institucioneve ekzistuese mikro-financiare. Do të aplikohen edhe modelet e ofrimit të kredive për aktivitete të vogla gjeneruese të të ardhurave për individë dhe për zhvillimin e bizneseve në emër të grupeve të organizuara. Shoqatat lokale mund të transformohen në kooperativa ekonomike, përmes qasjes në kredi të financuara nga diaspora, si dhe ndihmës teknike që ofrohet nga projektet. Potenciali zhvillimor i ofertës qëndron në kapacitetin e saj për të ulur koston e kredive për të dobëtit që marrin mikro-kredi. Në këtë rast, aktivitetet fundore që përfitojnë nga kreditë mund të mos kenë parashikime për angazhimin direkt të diasporës. Brenda kontekstit, diaspora mund të preferojë kanalizimin e fondeve drejt bizneseve të një kreditori të panjohur e jo një të afërm i me lidhje familjare, pasi kjo rrit mundësinë e kthimit të kredisë. Pagesat për familjen apo miqtë mund t'i ekspozohen rrezikut që të kuptohen më shumë si "dhurata" e jo si hua-marrje.

Investimet e diasporës do të orientohen drejt bizneseve kolektive, të cilat do të vlerësohen me rëndësi për komunitetet e diasporës. Në këto raste, migrantët do të kenë pjesën e tyre të drejtpërdrejtë në biznese. Kjo do të bëhet përmes përkrahjes ndaj iniciativave kolektive apo bizneseve private, për shembull, duke zgjedhur një sektor të caktuar ekonomik me rëndësi më të madhe për komunitetet lokale. Për migrantët që dëshirojnë të kthehen në Shqipëri, fuqizimi i bizneseve të qëndrueshme e bën këtë mundësi më tërheqëse, ose jep mundësinë që gjenerata e dytë apo e tretë të kalojë më shumë kohë në vendin e origjinës.

Diaspora do të inkurajohet të marrë pjesë me përparësi në projekte të partneritetit



publik-privat dhe të investojnë në projekte infrastrukturore.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të nxisë në koordinimin dhe organizimin e takimeve apo “Ditëve të Shqipërisë” në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.

#### **- RRJETET E DIASPORËS**

Krijimi i rrjeteve funksionale të biznesit të diasporës do të rrisë interesimin e investuesve nga diaspora. Këto rrjete sipërmarrjeje do të kontribuojnë në politikat zhvillimore dhe planet strategjike për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Për të nxitur themelimin e rrjeteve të bizneseve, do të krijohet Regjistri i Bizneseve të Diasporës.

Strategjia parashikon krijimin e një forumi të pavarur të ekspertëve nga diaspora dhe ekspertëve në Shqipëri, për të nxitur dhe orientuar sipërmarrjet dhe investimet e diasporës në ekonominë e vendit. Mundësia e krijimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës do të profilizonte interesat dhe krijonte një mekanizëm bashkëpunimi në fushën e investimeve.

Strategjia Kombëtare parashikon rritjen e kapaciteteve profesionale për dhënien e shërbimeve mbështetëse lidhur me mundësitë e investimeve në Shqipëri (mjedisi i biznesit, ndryshimet ligjore etj.) duke shërbyer si ndërlidhje e investitorëve nga diaspora me komunitetin e biznesit në vendlindje.

Tërheqja e investimeve të diasporës do të ketë nevojë për një mentalitet të ndryshuar të administratës publike. Mekanizmat fillestarë të veprimit të Strategjisë konsiderohen vendimtarë për procesin që nxit ajo.

Strategjia Kombëtare e Diasporës në këtë drejtim do të nxisë edhe organizimin dhe administrimin e një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikat e Diasporës dhe Migracionit.

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikat kombëtare mbi diasporën do të jetë një prioritet. Në këtë kuadër do të konsiderohet krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekteve stimuluese dhe aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

Një synim i Strategjisë Kombëtare do të jetë organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të



drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të konsiderojë cilësinë e faqeve të internetit të institucioneve shtetërore për informacionin të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Në këtë kuadër pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare janë edhe realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me “kujdestarët” e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

Qëllim i rëndësishëm i Strategjisë Kombëtare është organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes geografike. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve “homologe” në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre do të jetë një prioritet i veçantë.

Në funksion të ndërtimit të rrjeteve funksionale të diasporës do të jetë edhe planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi:

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë
- Ekzistencën e burimeve informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend;

Qëllimi i procesit do të jetë që diaspora dhe migracionit të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

Në këtë drejtim rëndësi merr krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të Universiteteve shqiptare me Universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë. Rëndësi merr realizimi i një plani të veprimit mediatik për nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për të siguruar eksplorimin e gjithë potencialit të saj dhe shfrytëzimin e të gjithë avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi. Do të vlerësohet përgatitja nga institucionet përgjegjëse të Turizmit e një fushate promociionale, për të tërhequr vëmendjen e atij segmenti të diasporës që është në kërkim të rënjëve, kulturës dhe traditave të paraardhësve. Në bashkëpunim me sektorin privat do të përgatitet një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe. Siikona të kësaj



fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg. Një nga qëllimet e rëndësishme të veçantë të Strategjisë Kombëtare të Diasporës është nxitja e organizimeve të rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Në funksion të këtij qëllimi do të jetë organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës.

Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim është pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë.

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit (formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje) është një cilësi e organizimit të rrjeteve në diasporë. Protagonizmi dhe suksesi do të ndërliken në funksion të organizimit shqiptar në diasporë.

#### - INSTRUMENTA TË DOBISHËM

Strategjia Kombëtare e Diasporës ka qëllim mbështetjen e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.

Strategjia Kombëtare do të vlerësojë negociimin për të nënshkruar marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. Në këtë kuadër do të kryhet vlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të realizojë kryerjen e fushatave sensibilizuese e lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:

- Publikimi i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,
- Botimi në gazetat shqiptare jashtë vendit,
- Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,
- Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit.



Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë. (Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:

- Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve.
- Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.
- European Court in Human rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut.
- European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe - Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës.
- Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të Parlamentit Evropian.
- Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së.

### **3.3 PËRGATITJA E ADMINISTRATËS PËR NIVELIN E RI TË MARRËDHËNIES TË POLITIKËS SHTETËRORE ME DIASPORËN**

#### **3.3.1 KOMUNITETET SHQIPTARE JASHTË VENDIT DHE ZHVILLIMI EKONOMIK**

Përfshirjen e komuniteteve shqiptare në diasporë në zhvillimin ekonomik të vendit i cili do të fokusohet në:

- Krijimin e një skeme të koordinimit të rrjeteve profesionale të diasporës,
- Krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës,
- Organizimin e propozimeve motivuese ligjore për investimet e diasporës,

Plani i Veprimit do të fokusohet edhe në zbatimin e marrëveshjeve bilaterale të Shqipërisë me Kosovën për koordinimin midis dy shteteve në bashkëveprimin me diasporën shqiptare. Një vend të rëndësishëm merr edhe realizimi i një plan-veprimi të përbashkët institucional me zyrën e IOM në Tiranë.



### 3.3.2 MBROJTJA E IDENTITETIT DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

#### - KAPITALI HUMAN, SOCIAL DHE KULTUROR

Diaspora shqiptare ka të grumbulluar një kapital të konsiderueshëm jomonetar, në formën e kapitalit human, social dhe kulturor.

Kapitali human lidhet me njohuritë e shprehitë profesionale dhe kulturën e punës që kanë fituar migrantët gjatë punës, studimit dhe jetesës në vendet pritëse.

Kapitali social ka të bëjë me vlerat sociale që fitojnë migrantët gjatë qëndrimit në vendin pritës.

Kapitali kulturor vlerëson vlerat kulturore që fitojnë migrantët, të cilat shërbejnë për të forcuar bashkëjetesën kulturore midis vendeve pritëse dhe dërguese. Këto vlera janë në bashkëveprim me promovimin e kulturës shqiptare në vendet pritëse, nëpërmjet diplomacisë kulturore.

Diaspora mund të kontribuojë jo vetëm nëpërmjet kthimit fizik në Shqipëri ose dërgimit të kapitaleve financiare, por edhe nëpërmjet kapitaleve të përmendura më sipër si dhe njohuritë e aftësitë teknike, “dërgesat teknologjike” etj.

Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina kanë potencial të konsiderueshëm intelektualësh shqiptarë që jetojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri nën kujdesin shtetëror do të ofrojë më shumë informacion mbi profilet profesionale të diasporës në fusha të ndryshme, si biznesi, shkenca, teknologjia, shëndetësia, turizmi, etj. Strategjia Kombëtare do të nxisë praktikën e “ftesave të hapura” për projekte që duhen promovuar ndaj diasporës. Për këtë qëllim Fondi për Zhvillimin e Diasporës do të inkurajojë profesionistët nga diaspora që të aplikojnë në projekte të ndryshme, duke mundësuar kështu bartjen e njohurive dhe përvojave më të mira.

Strategjia rivlerëson bashkëpunimin me donatorët në këtë drejtim në programe të modelit *Brain Gain* (Kthimi i Trurit) në krijimin e strukturave institucionale që mundësojnë kthimin e profesionistëve të talentuar si dhe parandalimin e largimit të personave që janë diplomuar jashtë vendit.

Për këtë qëllim do të rivlerësohet programi i themeluar më 2008, i cili ofroi përkrahje financiare për të kualifikuarit që ifton të kthehen të punojnë në Shqipëri. Ai ndërtoi një bazë të dhënash me studentë dhe akademikë jashtë vendit, si dhe ka shtyrë mbi 150 profesionistë që të kthehen në vendlindje. Ai gjithashtu planifikon të themelojë rrjete kontaktesh me ata që ende janë jashtë. Ky program mbështet universitetet dhe



administratën publike në punësimin në pozicionet drejtuese dhe akademike individë të kualifikuar jashtë vendit, të përzgjedhur në baza konkurruese dhe transparente. Kthimi i individëve me një kualifikim të lartë është pjesë e Strategjisë Kombëtare në mënyrë që të përfshijë diasporën shqiptare në zhvillimin ekonomik, shkencor dhe administrativ të vendit. Kjo përfshin edhe analizën kritike të ligjeve e praktikave aktuale në administratën publike që promovojnë tërheqjen e atyre që janë diplomuar jashtë vendit.

### **- RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR**

Diaspora shqiptare ka një kontribut të padiskutueshëm në historinë dhe identitetin kombëtar.

Identiteti i diasporës është një konstrukt shoqëror që zhvillohet përgjatë kohës. Në rastin e diasporës shqiptare ky proces i ndërtimit të identitetit është i bazuar në një kuptim të përbashkët të historisë, kujtimeve të riproduhuara dhe të rikujtuara, padrejtësive lidhur me ndarjen e territoreve të banuara me shqiptarë, viktimizimin dhe valët e dhunshme të migrimit etj. Edhe sikur të gjithë migrantët shqiptarë të mos braktisnin vendlindjet e tyre për arsyt e lartpërmendura, këto trauma të përbashkëta historike i bashkojnë kur ata gjenden në vendet mikpritëse dhe kështu fitojnë ndjenjën që bashkërisht përbëjnë “një diasporë”.

Boshti kryesor i kombit shqiptar ka qenë dhe mbetet familja. Shumica e aktiviteteve të tij përkufizohen me këtë koncept. Diaspora shqiptare dhe organizimi i saj ka të bëjë shumë me “familjen”, marrëdhëniet familjare dhe lidhjet me vendlindjen. Ajo është një diasporë etno-nacionale. Historia dhe gjuha e përbashkët, mitet dhe legendat, ushqimi, kostumet dhe folklori krijojnë dhe ruajnë identitetin e diasporave etno-sociale shqiptare.

Kultura e lidhjeve të ngushta të familjeve shqiptare konsiderohet të jetë një ndër përparësitë kryesore të diasporës shqiptare.

Në vitet e hershme të pavarësisë së Shqipërisë roli i pjesëtarëve të mirë arsimuar të diasporës ishte i rëndësishëm si në administrimin e shtetit, ashtu edhe në negociatat ndërkombëtare për statusin e saj.

Shoqata të ndryshme në botë si “Vatra” shtypën tekstet shkollore, të cilat pastaj dërgoheshin në Shqipëri. Shqiptarët e Amerikës gjithashtu ishin protagonistë në





vendosjen e marrëdhënieve të veçanta politike dhe tregtare mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë. Nga komunitetet në diasporë u krijuan lobime pranë qeverive të vendeve pritëse në përkrahje të vendlindjes dhe mjaft figura të saj u bënë autoritete të politikës e përfaqësues të shtetit shqiptar.

Strategjia parashikon rritjen e kontributit të diasporës dhe bashkëpunimit të qeverisë dhe institucioneve të shtetit shqiptar me të për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Qendrat e Kulturës në Diasporë si produkt i marrëveshjes shtetërore midis Shqipërisë dhe Kosovës do të jenë “infrastruktura” e qëllimit të ruajtjes së identitetit kombëtar në Diasporë.

#### - ARSIMIMI, EDUKIMI DHE MEDIA

Diaspora shqiptare, me karakteristikat dhe traditat e përbashkëta kulturore, nxit brezat e rinj të ruajnë identitetin kombëtar dhe të mbesin si pjesëtarë të diasporës, edhe pse jetojnë në shoqëritë pritëse dhe kanë identitet të dyfishtë, ose shtetësi të dyfishtë.

Strategjia Kombëtare i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes së identitetit kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të diasporës. Kjo do të arrihet vetëm në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë mes diasporës dhe Shqipërisë si vend origjine. Angazhimi me projekte të veçanta të programeve edukative dhe kulturore do të pengojë asimilimin e mëtejshëm në aspektin gjuhësor, veçanërisht i brezave të dytë dhe të tretë në diasporë. Këtu do të përfshihen kurset e gjuhës shqipe dhe mësimdhënësit që punojnë në shkolla me orë plotësuese. Strategjia parashikon marrëveshje të veçanta me institucionet e shtetit të Kosovës në këtë drejtim. Administratat përgjegjëse të Shqipërisë dhe Kosovës do të bashkëpunojnë për të krijuar politika e programe edukuese që do të mirëpritën nga gjeneratat e reja. Krijimi i një tradite të modelit të “summer school” - shkollave verore do të jetë një mjet i cili do të kthehet në traditë edukuese për fëmijët e diasporës.

Strategjia Kombëtare vlerëson rolin e mediave audiovizive dhe medias sociale në ruajtjen e gjuhës. Transmetuesit publikë do të jenë ligjërisht të detyruar t’i dedikojnë 10 deri 15 përqind të programit (tokësor dhe satelitor) tematikës së diasporës dhe migracionit.

Strategjia Kombëtare i kushton vëmendje mediave sociale. Ato po kthehen në një revolucion i mjeteve të ndërveprimit mes njerëzve, me të cilat po krijojnë, shkëmbejnë



dhe ndajnë informacion e ide në komunitete dhe rrjete virtuale. Media sociale në diasporë ka krijuar një realitet të ri të një opinioni “publik” të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

#### IV. KOSTIMI DHE BUXHETIMI

Strategjia Kombëtare për Diasporën, do të zbatohet në periudhën 2018-2024.

Duke marr në konsideratë faktin e krijimit për herë të parë në një strukturë qeverie të Ministrit të Shtetit për Diasporën, për të mundur zbatimin e strategjisë janë parashikuar fillimisht vetëm kostot paraprake për vitin 2018.

Në Planin e veprimit për periudhën 2018-2024, janë evidentuar masat dhe kostot përkatëse, të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2018.

Financimet e këtyre masave multi-disiplinore do të mbulohen kryesisht nga programet buxhetore të institucioneve zbatuese të kësaj Strategjie Kombëtare. Kostot fillestare administrative e përlogaritura për vitin 2018 do të jetë në masën 130.000.000 lekë:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës 60 milion lekë;
- Fondi për Zhvillimin e Diasporës 50 milion lekë;
- Qendra e Botimeve për Diasporën 20 milion lekë.

Ato kanë të bëjnë kryesisht me vendosjen në funksionim administrativ të këtyre strukturave të reja shtetërore. Kjo përlogaritje është në përputhje me Ligjin nr.115, datë 28.12.2017, si edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kostot e tjera do të përballohen nga buxheti i shtetit të institucioneve përgjegjëse, si edhe nga donatorët.

Një grup pune i posaçëm specialistësh nën drejtimin e zyrës së Ministrit të Shtetit për Diasporën do të krijohet për përcaktimin dhe detajimin e kostove të planit të veprimit për periudhën 2019-2024. Ai do të përbëhet me përfaqësues nga të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit, të cilat implikohen për zbatimin e planit të veprimit. Afati për finalizimin e planit të veprimit për periudhën 2019-2024 do të jetë brenda një viti nga miratimi i kësaj strategjie. Grupi i punës do të ngrihet pas hyrjes në fuqi të vendimit për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 -2024 dhe Planit të Veprimit.

Për llogaritjen fillestare të shpenzimeve për aktivitetet kryesore të cilat do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe donatorët është vepruar, si më poshtë:



- Llogaritja e shpenzimeve për burime njerëzore bazohet në kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarive dhe një pagë mesatare ditore të një kategorie të caktuar të nëpunësve civilë.
- Llogaritja e shpenzimeve për shërbime është bërë duke mbajtur parasysh kostot e shërbimeve të institucioneve përkatëse, bazuar në standardet e miratuara.
- Llogaritja e shpenzimeve për aktivitete që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme, etj. Është bërë duke mbajtur parasysh shpenzimet e vazhdueshme që do të ndodhin, për shembull për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore, ekspertizë të huaj (kur është parashikuar në plan) dhe mjete konsumi.
- Llogaritja e shpenzimeve për “aktiviteteve specifike” ose i iniciativave specifike të ngjashme u bazua kryesisht në natyrën e aktiviteteve dhe kostot që ofron tregu për shërbime të tilla.

Në llogaritjen e shpenzimeve për trajnime është mbajtur në konsideratë kosto e trajnimit për një person. Sikosto për njësi janë përdorur kostot e ASPAs dhe/ose kostot e aplikuara për trajnime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk është i plotë është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji, ose janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme që kanë qenë përfshirë në strategjinë e viteve 2011-2015, ose produkte të ngjashme në PBA.

Konkluzionet edhe në fushën e buxhetimit për Strategjinë Kombëtare 2018-2024 dhe Planin e Veprimit, do të dalin nga Komiteti Shtetëror i Diasporës, i cili është ngritur me Vendimin Nr. 690, datë 27.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin dhe Funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën”.

## V. MONITORIMI DHE ZBATIMI

### 1. MONITORIMI

Strategjia Kombëtare është një dokument politik parashikues. Por publiku duhet të jetë në dijeni për pasiguritë dhe rreziqet e zbatimit të saj. Parashikimi mund të luajë rol në realizimin e sfidave të botës aktuale duke e ofruar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit si një mundësi ndryshimi.

Pjesëtarët ediasporës shqiptare janë të interesuar për gjendjen politike dhe ekonomike



të shtetit të tyre dhe me siguri do ta vazhdojnë këtë interesim edhe në të ardhmen. Një skenar negativ do të ishte që diaspora të ndjehej e neglizhuar dhe e ndarë prej zhvillimeve në shtetin e prejardhjes dhe kështu do të ishte më pak e interesuar lidhur me gjendjen dhe pak e gatshme që të bënte diçka për të. Kjo do ti hapte rrugën asimilimit të ngadalshëm të saj.

Një skenar pozitiv dhe i dëshirueshëm do t'i përfshinte pjesëtarët e diasporës që të ishin më afër zhvillimeve politike dhe ekonomike të shteteve të prejardhjes, ku ata do të ndiheshin të respektuar, të mirëpritur dhe do të shihnin përparësi të qarta nga përfshirja e tyre në zhvillimin e vendit të origjinës ndonëse jetojnë jashtë vendit. Struktura monitoruese për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën do të koordinohet nga Ministri i Shtetit për Diasporën.

Për raportin vjetor do të ngrihet një grup pune icili do të kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe do të ketë në përbërje përfaqësues të Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare për Diasporën. Raporti do të paraqitet për miratim tek Ministri i Shtetit për Diasporën.

Pas monitorimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, do të raportojnë, pranë:

- Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin i cili do funksionojë në përbërje të Komisionit të Politikës së Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë,
- Komiteti Shtetëror për Diasporën, i cili do të drejtohet nga Kryeministri.

Monitorimi i zbatimit të dokumentit të Strategjisë Kombëtare vlen edhe në shmangien e çdo skenari negativ. Ky proces do të ritheksojë të vërtetën e thjeshtë se shqiptarët kudoqofshin janë pjesë e kombit.

Një komb i cili të veçantën e tij e ngre në nivelin e virtytit, bën paqe me veten dhe të ardhmen. Koha punon për kombin që vepron.



## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS 2018 - 2024

Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës do të nxisë synimet e veprimtarisë së politikës shtetërore të Shqipërisë ndaj komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

Zhvillimin institucional dhe drejtues të strukturës shtetërore përgjegjëse për diasporën i cili përfaqësohet nga:

- Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.
- Komiteti Shtetëror për Diasporën.
- Ministri i Shtetit për Diasporën.
- Këshillit Koordinativ i Diasporës.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës.
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës.
- Qendra e Botimeve për Diasporën.

Strategjia Kombëtare e Diasporës është komplekse dhe shumë sektoriale, e cila çelësin e suksesit të ndërhyrjes së saj do ta jetë në koordinimin midis institucioneve të shtetit shqiptar dhe këtyre të fundit me strukturat organizative të diasporës dhe shoqërisë civile.

Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Diasporës parashikon masa konkrete, të cilat do të duhet të zbatohen kryesisht nga Qeveria Shqiptare por edhe nga aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Shumica e masave të parashikuara në Planin e Veprimit parashikojnë aktivitete dhe veprime, të cilat do të duhet të realizohen brenda afateve të përcaktuara. Për shumicën e tyre kërkohet ndërhyrja e koordinuar e më shumë se një institucioni shtetëror.

Plani i veprimit të Strategjisë Kombëtare do të jetë pjesë e veprimtarisë të institucioneve shtetërore të Shqipërisë me qëllim garantimin e zbatimit të saj. Dokumenti do të shoqërohet me masa të detajuara dhe elementët e nevojshëm për vënien në jetë të tyre. Ai do të jetë fryt i bashkëpunimit të një numri të madh ministrish dhe institucionesh, të cilët do të përfshihen në përpunimin e politikës së re në këtë fushë të veprimit shtetëror.

Diaspora dhe politika ndaj saj e ka një të ardhme ku vlerësimi lidhet me veprimin.



## KRIJIMI I NJË KUADRI TË PLOTË TË POLITIKËBËRJES MBI DIASPORËN

### SHTETI DHE DIASPORA

#### Masa 1

*Bërja funksionale e institucioneve që legjislacioni i ringarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me Diasporën siç janë Agjencia Kombëtare për Diasporën, Fondi për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën. Hartimi i një plani të detajuar për përthithjen e fondeve të nevojshme për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare. Ndarja e qartë e kompetencave midis strukturave që do të merren me trajtimin e diasporës. Krijimi i një njësie të specializuar për rishikimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.*

**INDIKATORET:** Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, Fondi për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën.

**AFATI KOHOR:** 6 muji parë 2018 (periodike)

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendës-Kryeministri

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

#### Masa 2

*Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin.*

**INDIKATORET:** Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën.

**AFATI KOHOR:** 6 muji dytë 2018 (periodike)

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Kulturës

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes



*Masa 3*

*Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2024.*

**INDIKATORET:** *Procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës).*

**AFATI KOHOR:** *6 majori dytë 2018 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Ministria e Kulturës*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Masa 4*

*Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të Diasporës si ngjarja e më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare, me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të shqyrtohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet në Shqipëri.*

**INDIKATORET:** *Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të dytë të Diasporës. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare.*

**AFATI KOHOR:** *6 majori parë 2018 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Masa 5*

*Krijimi i Këshillit Koordinativ të Diasporës si një strukturë koordinative për të punuar për forcimin organizativ të e komuniteteve shqiptare me qëllim përfshirjen dhe partneritetin në zhvillimin e Shqipërisë.*

**INDIKATORET:** *Krijimi i Këshillit Koordinativ të Diasporës si një strukturë koordinative.*

**AFATI KOHOR:** *6 majori dytë 2018*



**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën  
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

**Masa 6**

Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani veprimi të veçantë për nxitjen e organizimit në nivel rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse. Promovimi i idesë për mbajtjen e aktiviteteve që nxisin këtë nivel organizim i nëpërmjet informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.

**INDIKATORET:** Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë. Promovimi i idesë.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën  
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme  
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
Ministria e Kulturës

**Masa 7**

Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës për fushën e marrëdhënieve me diasporën në funksion dhe për pasurimin e marrëveshjeve ekzistuese që ekzistojnë midis dy vendeve në këtë drejtim. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe "prodhuese" të diasporave shqiptare në botë.

**INDIKATORET:** Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme  
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
Ministri i Shtetit për Diasporën

**Masa 8**

Vendosja e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e programeve për këtë qëllim (për shembull me PNUD-in për të zbatuar TOKTEN në Shqipëri).

**INDIKATORET:** Bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.





**AFATI KOHOR:** 6 maji parë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

**Masa 9**

Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit zgjerimin e sferës së mbrojtjes së komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me qëllim përafrimin me Acquis Communautaire.

Realizimi i procedurave për përfundimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare (nëse nuk janë realizuar ende) si më poshtë:

- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës Nr. 143 "Për punonjësit migrantë".
- Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës "Mbi Statusin Ligjor të Punonjësve Migrantë".
- Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punonjësve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre".

**INDIKATORET:** Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit. Realizimi i procedurave për ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Drejtësisë

**Masa 10**

Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor në vendet me një prezencë të qenësishme të komuniteteve shqiptare dhe të një rëndësie të veçantë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve diplomatike dhe ekonomike të vendit pritës me vendin e origjinës. Orientimi i planit të punës së trupës diplomatike dhe konsullore menjëherë fokus të veçantë drejt marrëdhënieve me komunitete shqiptare jashtë vendit.

**INDIKATORET:** Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2018

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën



### Masa 11

Ndërgjegjësimi dhe orientimi i qytetarëve shqiptare jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare, nëpërmjet platformës konsullore online. Dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

**INDIKATORET:** Orientimi i qytetarëve shqiptare jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online.

**AFATI KOHOR:** 6 muaji i parë i 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

### Masa 12

Vlerësimi i përjasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në tëardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

**INDIKATORET:** Përjasja e strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen.

**AFATI KOHOR:** 6 muaji i parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendës-Kryeministri

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

### Masa 13

Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes civile metëdhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur.

Organizimi i aktiviteteve publike dhe shoqërore civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit.



**INDIKATORET:** Zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët. Përcaktimi i përgjegjësive dhe organizimi i aktiviteteve jashtë vendit.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendës-Kryeministri

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme

Ministri i Brendshëm

Ministri i Shtetit për Diasporën

**Masa 14**

Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar, për të promovuar imazhin evendlindjes etë shqiptarëve jashtë vendit dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.

**INDIKATORET:** Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse në bashkëpunim me shtetin e Kosovës.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Ministria e Kulturës

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

**Masa 15**

Mundësimi i informacioneve rreth diasporës shqiptare dhe zhvillimin e komuniteteve jashtë vendit. Realizimi i një raporti vjetor ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën.

**INDIKATORET:** Mundësimi i informacioneve dhe realizimi i një raporti vjetor rreth diasporës shqiptare.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i dytë 2018 (periodik)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë



Instituti i Statistikave INSTAT

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

#### Masa 16

Realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta për fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil.

**INDIKATORET:** Trajnime të përgjithshme dhe të veçanta. Organizimi i trajnimeve periodike. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve. Hartimi i moduleve trajnuese.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i dytë i 2018 (periodike)

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendës-Kryeministri

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Drejtësisë

#### Masa 17

Nxitja e bashkëpunimit shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat janë me profile dhe trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Informimi publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

**INDIKATORET:** Bashkëpunim shtetëror me institucionet e vendeve pritëse. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative. Informimi publik për ecurinë.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i parë 2019 (periodike)

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Drejtësisë



*Masa 18*

*Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletëpalosje, faqe interneti etj.) që ju drejtohet komuniteteve shqiptare në diasporë, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre si edhe për shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si edhe nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.*

**INDIKATORET:** *Shpërndarja e informacionit në lidhje me statusin të drejtat si edhe shërbimet që ju ofrohen.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori i parë i 2019 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministria e Brendshme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Instituti i Statistikave INSTAT*

*Ministria e Drejtësisë*

*Masa 19*

*Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për Migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.*

**INDIKATORET:** *Hartimi i manualeve praktike. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori i dytë i 2018 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Zëvendëskryeministri*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministria e Brendshme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Drejtësisë*

*Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.*



#### Masa 20

Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

**INDIKATORET:** Kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2018

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën.

Ministria e Drejtësisë

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

#### Masa 21

Nxiti dhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende. Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës.

**INDIKATORET:** Kontakte të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase, ndërgjegjësim për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Drejtësisë

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

#### Masa 22

Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në baze të informacioneve të marra nga përfaqësitë hartimi nga ministria përgjegjëse për diasporën të një raporti vjetor për gjendjen konkrete të emigrantëve shqiptarë, me propozime masash respektive për përmirësimin e asistencës për ta.

**INDIKATORET:** Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve. Hartimi nga ministria përgjegjëse për diasporën të një raporti vjetor.



**AFATI KOHOR:** 6 maji i parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Drejtësisë

**Masa 23**

Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë).

**INDIKATORET:** Negocimi për marrëveshjet dypalëshe me vendet pritëse. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2018 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Drejtësisë

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

**Masa 24**

Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Vlerësimi i informacionit periodik dhe konkluzioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**INDIKATORET:** Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë. Vlerësimi i informacionit periodik.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme



Ministria e Drejtësisë  
Ministria e Diasporës

Masa 25

Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për të diskutohet në veçanti.

Rivlerësimi në bashkëpunim me vendet e BE e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfshirur edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

**INDIKATORET:** Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit. Bashkëpunim me vendet e BE për projekte të veçanta.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Masa 26

Vlerësimi dhe nxitja e migrimit qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë). Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t'i kalohet institucioneve përgjegjëse.

**INDIKATORET:** Masat favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale; Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për tregjet e huaja të punës.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i dytë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financave dhe Ekonomisë





*Masa 27*

*Organizimi i një programi të veçantë vjetor për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare duke organizuar aktivitete periodike në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjetit të bizneseve shqiptare në diasporë që tregojnë prodhime të natyrave të tilla.*

**INDIKATORET:** *Program vjetor për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori i parë 2019 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*

*Masa 28*

*Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm ("Jam Shqiptar") i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar.*

**INDIKATORET:** *Përgatitja e Certifikatës së Diasporës.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori parë 2020*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*



## **KRIJIMI I NJË INSTRUMENTI TË DOBISHËM NË NDIHMË TË QEVERISË DHE AKTORËVE TË TJERË PËR TË PËRMIRËSUAR DHE FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN ME DIASPORËN DHE MIGRACIONIN E LIGJSHËM**

### **PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË EKONOMINË KOMBËTARE**

#### *Masa 29*

*Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse.*

*Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre.*

**INDIKATORET:** *Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit; Mbledhja vullnetare e donacioneve nga anëtarët e shoqatave të migrantëve.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji parë 2019 (periodike çdo vit)*

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*

#### *Masa 30*

*Organizimi dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikën e Diasporës dhe Migracionit. (Plotësimi i rrjetit edhe me emrat dhe detajet e studiuesve dhe nëpunësve shtetërorë nga agjencitë administrative që dotë merren me politikën për diasporën).*

**INDIKATORET:** *Organizimi dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji i parë 2019 (periodike)*

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*



*Masa 31*

*Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit ( formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje).*

**INDIKATORET:** *Promovimi i personaliteteve. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori parë 2019 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Masa 32*

*Krijimi i Regjistrit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që nxisin investitorët që të punësojnë staf të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre programeve, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëprehen dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja nëpërmjet një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë.*

**INDIKATORET:** *Regjistri i Diasporës së Kualifikuar; Programet kombëtare; Vlerësimi i programeve; Koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori parë 2020 (periodike çdo vit)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministria e Ekonomisë dhe Financave*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Agjencia Kombëtare e Diasporës*

*Masa 33*

*Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e bizneseve në diasporë. Krijimi i Regjistrit të Bizneseve të Diasporës si bazë për krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si organizuese dhe ndihmuese në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore.*



**INDIKATORET:** Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës; Krijimi i Regjistrimit të Bizneseve të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 maji parë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 34

Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në koordinim me bizneset blerëse në diasporë (krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në diasporë) për të ndërlidhur bizneset shitëse dhe blerëse brenda dhe jashtë vendit.

**INDIKATORET:** Zhvillimi i aktiviteteve vjetore; Krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve.

**AFATI KOHOR:** 6 maji parë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 35

Rivlerësimi i festave kombëtare, fetare nëpërmjet një planifikimi të kujdesshëm aktiviteteve, në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jofitimprurëse, federatat sportive dhe promovimi nga institucionet përgjegjëse të Turizmit në tregje të rëndësishme, duke rritur ndjeshëm flukset turistike.

**INDIKATORET:** Planifikimi i aktiviteteve dhe promovimi për rritjen e flukseve turistike.

**AFATI KOHOR:** 6 maji dytë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Kulturës

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit



*Masa 36*

*Vlerësim vjetor për remitancat dhe politikat nxitëse bankare për diasporën shqiptare. Përpunimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të diasporës. Rivlerësim për marrjen e masave për të rritur flukset e dërgesave të migrantëve duke motivuar migrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri (si p.sh.: me anë të normave të favorshme të këmbimit, si dhe mundësia për t'i mbajtur ato në valutë të huaj).*

**INDIKATORET:** *Vlerësim vjetor për remitancat; Politika koherente dhe të plota për dërgesat; Rivlerësim për të rritur flukset e dërgesave.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori parë 2019 (periodike çdo vit)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Banka e Shqipërisë*

*Masa 37*

*Rivlerësimi në marrjen e masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale, dhe më pak të kushtueshme. Vendosija e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit për këtë çështje.*

*Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare (si p.sh.: letra me vlerë).*

**INDIKATORET:** *Masa për kalimin formal të dërgesave; Dialog me përfaqësuesit e sistemit bankar; Tërheqja e dërgesave nëpërmjet produkteve financiare.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori i parë 2019 (periodike çdo vit)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Banka e Shqipërisë*

*Masa 38*

*Krijimi i zyrave të posaçme administrative në institucionet përgjegjëse të ekonomisë për trajtimin e diasporës shqiptare sidomos në zbatimin e politikave të dërgesave të migrantëve dhe lehtësimin e tërheqjes së investimeve nga diaspora.*

**INDIKATORET:** *Krijimi i zyrave administrative.*



**AFATI KOHOR:** 6 majori parë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendëskryeministri

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 39

Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime “ad hoc” për emigrantët (brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit).

**INDIKATORET:** Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare; Përcaktimi i shërbimeve “ad hoc” për emigrantët.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 40

Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.

**INDIKATORET:** Evidentimi i shoqatave. Krijimi i një regjistri.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Kulturës

Ministri i Shtetit për Diasporën

Akademia e Shkencave



*Masa 41*

*Nxitja e organizimeve të Rrjetit të Gravenë Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim.*

**INDIKATORET:** *Organizime të Rrjetit të Grave në Diasporë; Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës; Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi me organizatat, institucionet dhe shoqërinë civile.*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori dytë 2019 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

*Masa 42*

*Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Krijimi i lehtësirave si p.sh.: botimi në gazeta, apo në faqe interneti e informacioneve që mundësojnë krijimin e grupeve profesionale dhe të interesave të përbashkëta. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve "homologe" në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre.*

**INDIKATORET:** *Organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të diasporës; Krijimi i lehtësirave; Vendosja e kontakteve midis grupeve "homologe".*

**AFATI KOHOR:** *6 mujori i parë 2019*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Masa 43*

*Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbibazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.*

**INDIKATORET:** *Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese.*



**AFATI KOHOR:** 6 majori i parë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën.

Ministria e Drejtësisë

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

**Masa 44**

Kryerja e fushatave sensibilizuese lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:

- Publikim i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,
- Botimi në gazetën shqiptare jashtë vendit,
- Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,
- Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit.

Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë. (Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:

- Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve.
- Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.
- European Court in Human rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut.
- European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe - Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës.
- Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të Parlamentit Evropian.
- Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së.

**INDIKATORET:** Kryerja e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Raportimi periodik të rasteve për shkelje të të drejtave të migrantëve shqiptarë.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i dytë i 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**





*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme  
Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën.  
Ministria e Drejtësisë*

*Masa 45*

*Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë" në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.*

**INDIKATORET:** *Koordinimi dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji i dytë 2018 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Kulturës*

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*

*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*

*Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.*

*Masa 46*

*Koordinimi me Institucionet Shëndetësore, publike dhe private, në përgatitjen e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor, lidhur kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka siguruar avantazhe (dentar, neurokirurgji, kardiokirurgji etj.).*

**INDIKATORET:** *Koordinimi me Institucionet Shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji i parë 2019 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*



## **PËRGATITJA E ADMINISTRATËS PËR NIVELIN E RITË MARRËDHËNIES TË POLITIKËS SHTETËRORE ME DIASPORËN.**

### *Masa 47*

*Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional për ta nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje.*

**INDIKATORET:** *Takime me rrjetet e biznesit dhe i shkëmbimit të informacionit.*

**AFATI KOHOR:** *6 majori dytë 2018 (periodike çdo vit)*

### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*

*Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*

*Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.*

### *Masa 48*

*MEPJ përmes strukturave të saj të diplomacisë ekonomike do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me diasporën shqiptare në botë për shfrytëzimin e potencialit ekonomik që kjo diasporë mbart në vetvete, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktiviteteve vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë me njëri-tjetrin dhe vendlindjen.*

**INDIKATORET:** *Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës; Përpilim i një programi aktiviteteve vjetore periodike.*

**AFATI KOHOR:** *6 majori dytë 2018 (periodike çdo vit)*

### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*

*Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.*



Masa 49

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikën kombëtare mbidiasporën. Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekteve stimuluese dhe aktivitetet vjetore për këtë qëllim.

**INDIKATORET:** Banka e të dhënave të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës; Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare, trajnimi i gazetarëve në diasporë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Masa 50

Organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare.

**INDIKATORET:** Rrjeti i informimit për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 51

Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërore për informacionin të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me "kujdestarët" e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

**INDIKATORET:** Cilësia e faqeve të internetit të institucioneve. Takime periodike me "kujdestarët" e faqeve të informacionit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2018 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**



Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Agjencia kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

Masa 52

Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi:

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë
- Ekzistencën e burimeve informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend;

Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

**INDIKATORET:** Çështje për migracionin dhe diasporën; regjistrimi i migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës; Ekzistencën e burimeve informative;

**AFATI KOHOR:** 6 muaji parë 2020

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Masa 53

Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Realizimi dhe strukturimi i një kanali televizionit publik (dhe radios) për temën e diasporës.

Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare.

**INDIKATORET:** Zonat e transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare; Programet televizive për diasporën; Kanali televizionit publik (dhe radios) për diasporën; Marrëveshje me mediat në vendet pritëse.



**AFATI KOHOR:** 6 maji parë 2019

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën  
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme  
Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Masa 54

Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të Universiteteve shqiptare me Universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

**INDIKATORET:** Krijimi i projekteve mediatike, promovimi i programeve të shkëmbimit dhe internship-it.

**AFATI KOHOR:** 6 maji parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën  
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme  
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)  
Akademia e Shkencave

Masa 55

Organizimi i një plan veprimi mediatik për nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për të siguruar eksplorimin e gjithë potencialit të saj dhe shfrytëzimin e të gjithë avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi.

Përgatitja nga institucionet përgjegjëse të Turizmit e një fushate promovionale, për të tërhequr vëmendjen e atij segmenti të diasporës që është në kërkim të rrënjëve, kulturës dhe traditave të paraardhësve. Në bashkëpunim me sektorin privat të përgatitet një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe. Siikona tëkësaj fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg.

**INDIKATORET:** Plan veprimi mediatik; Përgatitja e një fushate promovionale; Përgatitja e një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe.

**AFATI KOHOR:** 6 maji dytë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**



Ministri i Shtetit për Diasporën  
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme  
Ministria e Kulturës  
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH)

*Masa 56*

*Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit i aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.*

**INDIKATORET:** Komunitetet shqiptare të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës, me qëllim promovimin e tyre në Shqipëri.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë i 2018

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Kulturës  
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme  
Ministri i Shtetit për Diasporën  
Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

*Masa 57*

*Krijimi i mekanizmave administrativ në nivel qendror dhe lokal për ndihmën dhe transparencën, për të mbështetur investimet dhe kërkesat e të interesuarve në diasporë. Informimi i diasporës për mundësitë e investimeve në Shqipëri me anë të medias, bankave (internet, broshura), etj. dhe motivimi i migrantëve shqiptarë për të investuar të ardhurat e tyre në sektorë të veçante të ekonomisë.*

**INDIKATORET:** Mekanizma administrativ në nivel qendror dhe lokal; Informimi i diasporës për investimet me anë të medias, bankave (internet, broshura), etj. dhe motivimi për të investuar.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i dytë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Ministri i Shtetit për Diasporën  
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes  
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit



*Masa 58*

*Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën amtare. Identifikimi i nevojave për kursetë gjuhës shqipe në vendet pritëse. Rivlerësimi i hartimit të kurikulave standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe.*

*Identifikimi i vazhdueshëm i nevojave për mësim në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë.*

**INDIKATORET:** *Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin; Identifikimi i nevojave për kurse; Rivlerësimi i hartimit të kurikulave për mësimdhënien; Identifikimi i nevojave për fëmijët.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji 2019 (periodike)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Akademia e Shkencave*

*Masa 59*

*Vlerësimi i nevojave për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësimi i kurikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurikulave të përbashkëta.*

**INDIKATORET:** *Vlerësimi i nevojave; Përmirësim dhe zbatimi i kurikulave me Kosovën.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji 2018 (periodike çdo vit)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Masa 60*

*Krijimi i Regjistrit të mësuesve në diasporë dhe krijimi i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. Identifikimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. Promovimi i aktiviteteve arsimore me mësues e nxënës shqiptar në diasporë.*

**INDIKATORET:** *Regjistri i mësuesve dhe krijimi i programeve mbështetëse; Identifikimi i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve; Promovimi i aktiviteteve arsimore.*



**AFATI KOHOR:** 6 majori i parë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Akademia e Shkencave

**Masa 61**

Krijimi i një strukture permanente, që do të ndjekë vlerësimin dhe sigurimin e teksteve shkollore të nevojshme. Ajo do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin mësim në kurset, që do të krijohen për këtë qëllim.

Sigurimi i ivazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimeve mbi kurikulat e përbashkëta me Kosovën.

**INDIKATORET:** Krijimi i një strukture permanente, për tekstet shkollore dhe trajnimin e mësuesve; Sigurimi i teksteve shkollore dhe trajnimi i mësimeve.

**AFATI KOHOR:** 6 majori parë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

**Masa 62**

Zhvillimi i projektit "e-book" (shkarkimi online i teksteve shkollor të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e elehtësirave për të furnizuar të gjithë mematerialet e nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.

**INDIKATORET:** Projekti "e-book" për shpërndarjen e librave.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Akademia e Shkencave





*Masa 63*

*Rishikimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse).*

*Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende.*

**INDIKATORET:** *Marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe;*

**AFATI KOHOR:** *6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Masa 64*

*Rishikimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Vlerësimi i kryerjes së një studimi të thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen.*

*Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit në kuadër të programeve studimore të donatorëve të ndryshëm për Shqipërinë.*

**INDIKATORET:** *Orientimi i programeve/donatorëve për të cilat ka nevojë Shqipëria; Studim mbi numrin e studentëve shqiptarë dhe fushat ku specializohen; Rivlerësimi për kushtin e kthimit në Shqipëri.*

**AFATI KOHOR:** *6 maji dytë 2018 (periodike çdo vit)*

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

*Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme*

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

*Masa 65*

*Hartimi dhe miratimi i marrëveshjeve të nevojshme, të përbashkëta me Kosovën dhe të veçanta për mbështetjen e mesimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.*



Rivlerësim për kuadrin ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe për brezin e ri të komuniteteve shqiptare në diasporë.

**INDIKATORET:** Marrëveshjet me Kosovën; Rivlerësim i kuadrin ligjor.

**AFATI KOHOR:** 6 muhori parë 2019 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 66

Promovimi i programeve apo donatorëve të cilët ofrojnë bursa për studime jashtë vendit, për Shqipërinë. Organizimi i aktiviteteve për informimin në shkollat e mesme dhe të larta me qëllim njohjen e këtyre programeve dhe procedurave të aplikimit si nga pedagogët, studentët apo nxënësit.

**INDIKATORET:** Programe me bursa studimi; Organizimi i aktiviteteve për informim.

**AFATI KOHOR:** 6 muhori dytë 2018 (periodikë çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Kostofinanciare do të përballohet, brenda buxhetit të miratuar në Institucionet zbatuese.

Masa 67

Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë vendit dhe mbi faktorët që ndikojnë në këtë situatë. Organizimi në vendet pritëse për marrjen e masave për të mundësuar komunikimin dhe rrjetet funksionale në ndihmë të studentëve shqiptarë.

**INDIKATORET:** Raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve dhe faktorët ndikues; Organizimi në vendet pritëse për marrjen e masave.

**AFATI KOHOR:** 6 muhori parë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë



*Masa 68*

Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV e migrantëve të kualifikuar.

**INDIKATORET:** Nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar; Krijimi i një banke të dhënash elektronike me CV.

**AFATI KOHOR:** 6 majori dytë 2018 (periodikë çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Kosto financiare do të përballohet, nga PBA i miratuar për Institucionet zbatuese.

**MONITORIMI**

*Masa 69*

Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit mbi vlerësime 6 mujore dhe kryerja e raportimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën. Raportimi në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën në Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Nënkomisioni do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës Kuvendi çdo vit të miratojë një rezolutë për këtë çështje.

**AFATI KOHOR:** 6 majori i parë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

*Masa 70*

Vlerësimi nga Nënkomisioni për Migracionin dhe Diasporën dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën në mbledhje të veçanta i dokumenteve të:

- Raportimit me shkrim i Agjencisë kombëtare të Diasporës;
- Bankës së Shqipërisë për remitancat në Republikën e Shqipërisë;



- *INSTAT-it për të dhënat vjetore për migracionin dhe diasporën;*
- *Instituti Shtetëror të Sigurimeve për informacionin vjetor për gjendjen e pensioneve dhe statusin e shtetasve jashtë vendit;*
- *Nga Ministria e Brendshme për gjendjen e regjistrimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit.*

**AFATI KOHOR:** 6 maji dytë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendës-kryeministri

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Brendshme

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Banka e Shqipërisë

Masa 71

*Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit në Samitin e Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme.*

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2018 (periodik)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 72

*Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve vjetore të masave të marra duke përfshirë të dhëna sasore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar.*

**AFATI KOHOR:** 6 maji parë 2019 (periodike çdo vit)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Zëvendëskryeministri

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme



## GRUPI I PUNËS

1. Pandeli Majko,  
**Ministri i Shtetit për Diasporën - Kryetar**
2. Sonila Qato,  
**Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes - Anëtar**
3. Etjen Xhafaj,  
**Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme - Anëtar**
4. Elton Haxhi,  
**Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë - Anëtar**
5. Besa Shahini,  
**Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë - Anëtar**
6. Valbona Shujaku,  
**Zëvendësministri i Kulturës - Anëtar**
7. Hajrulla Çeku,  
**Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit - Anëtar**
8. Rovenà Voda,  
**Zëvendësministri i Brendshëm - Anëtar**
9. Teuta Vodo,  
**Zëvendësministri i Drejtësisë - Anëtar**
10. Ardiana Jaku,  
**Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Anëtar**
11. Ermira Gjeci Ruci,  
**Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Anëtar**

